



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në :

“ Koreografi ”

Universiteti i Arteve

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Sonia Jovic

2. Dr. Dorina Arapi

Tetor / 2025

Tabela e përgjithshme për programin e studimit Bachelor në:
“Koreografi”

1	IAL aplikues:	Universiteti i Arteve
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti Skenografi-Koreografi
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bsc Koreografi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM 328 datë30.07.1992
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër Nr 76 datë12.02.2011
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	
8	Cikli i studimit:	Bachelor
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite/6 simestra
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 i Kornizës së Kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	Viti akademik 2022–2023 <ul style="list-style-type: none"> • Totali: 16 pedagogë <ul style="list-style-type: none"> ○ PAE: 11 ○ PAK: 5 Viti akademik 2023–2024 <ul style="list-style-type: none"> • Totali: 21 pedagogë <ul style="list-style-type: none"> ○ PAE: 11 ○ PAK: 10 Viti akademik 2024–2025 <ul style="list-style-type: none"> • Totali: 16 pedagogë <ul style="list-style-type: none"> ○ PAE: 11 ○ PAK: 5
18	Numri i studentëve:	Viti 2022-2023: 10 studentë Viti 2023-2024: 10 studentë Viti 2024-2025: 10 studentë
19	Komente te tjera	




PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Vendimi Nr. 145, datë 10.3.2021, PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË UNIVERSITETIT TË ARTEVE SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E ARTEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, të Universitetit të Arteve (UART) vlerësohet si një hap pozitiv në mbështetje të arsimit dhe kulturës artistike në Shqipëri. Ky status paraqet disa aspekte pozitive, por gjithashtu reflekton kufizime dhe sfida në vlerësimin e arsimit të lartë me formim artistik.

Ky vendim reflekton faktin se mësimdhënia dhe kërkimi në art nuk ndjekin të njëjtat kritere si shkencat tradicionale. Specifikisht, Paragrafi i nenit nr. 2 përmban një njohje zyrtare të natyrës së veçantë të arsimit artistik. Dhënia e një statusi të veçantë për veprimtarinë e UART-it e dallon këtë universitet nga institucionet e tjera të arsimit të lartë, duke e legjitimuar specifikën e prodhimit artistik si një formë e vlefshme e kërkimit dhe e performancës akademike.

Termi “aktivitet kërkimor artistik-shkencor” është i gjerë, i paqartë dhe evaziv, gjë që sjell pasiguri dhe mund të çojë në interpretime të ndryshme. Kjo e vështirëson më tej zbatimin, për shkak të mungesës së standardeve kombëtare për vlerësimin e artit si kërkim shkencor.

Paragrafi 2. ku cilësohet: “*Statusi i veçantë i jepet UART-it për trajtimin e veçantë për efekt mësimdhënieje, veprimtarie akademike, të organizimit akademik dhe administrativ, të organizimit të programeve të studimit, të organizimit të aktivitetit kërkimor artistik-shkencor, të njohjes së aktivitetit artistik si pjesë e aktivitetit shkencor, që shërben për të vlerësuar performancën akademike vjetore, sipas përcaktimeve në statutin e UART-it e të legjislacionit në fuqi*”, njeh me të drejtë natyrën hibride të mësimdhënies dhe kërkimit në fushën e arteve dhe përpiqet të përshtasë strukturën ligjore ndaj fushave të artit. Megjithatë, ai mbetet shumë i përgjithshëm dhe pa mekanizma të qarta kontrolli dhe vlerësimi, gjë që krijon probleme nëse nuk shoqërohet me standarde të qarta dhe mekanizma vlerësimi objektiv.

Paragrafi 8. Pika.a, cilëson: “*UART-i gëzon status të veçantë lidhur me: a) organizimin e programeve të studimeve në tri cikle të njëpasnjëshme që përfundojnë me marrjen e diplomave ose të certifikatave përkatëse. Programet e studimeve në UART hartohen nga njësitë bazë dhe paraqiten për miratim në Senatin Akademik*”, përforcon autonominë dhe fleksibilitetin e Universitetit të Arteve në strukturimin e ofertës së tij akademike, duke i dhënë një autonomi akademike institucionit mbi hartimin e programeve nga njësitë bazë, çka i jep mundësi vetë komunitetit akademik të përcaktojë përmbajtjen e studimeve, në përputhje me zhvillimet artistike dhe kërkesat e tregut.

Por, pavarësisht këtij statusi të veçantë, që i përket Vendimit Nr. 145, datë 10.3.2021, PËR DHËNIEN E STATUSIT TË VEÇANTË UNIVERSITETIT TË ARTEVE SI INSTITUCIONI I VETËM PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË NË FUSHËN E ARTEVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË, si edhe duke u bazuar në vendimin e mëparshëm VENDIM Nr. 41, datë 24.1.2018 PËR ELEMENTET E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË OFRUARA NGA INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË, UART, për vete natyrën specifike që ka si institucion i lartë arsimor, paraqet vështirësi për tju përshtatur kërkesave specifike që kanë universitetet e tjera me orientim shkencor. Si rrjedhim, pa një kuadër të unifikuar kombëtar për arsimin artistik, të zgjeruar edhe të detajuar, të konceptuar specifikisht për këto programe studimi, vështirëson vlerësimin e tyre nga ekspertët e jashtëm, nga ASCAL, si edhe nga vetë institucioni për tju përshtatur një qasje apo metodologjie që nuk është pjesë e kërkimit artistik.

Ky status i veçantë është një hap pozitiv, por do të ishte e dobishme që të përfshiheshin edhe udhëzime për harmonizimin e programve në UART, duke i bërë këto programe më të integrueshme globalisht, por edhe në mënyrë që kërkimi artistik të afrohet dhe të bashkëjetojë me atë shkencor. Mungesa e një kuadri të qartë për sigurimin e cilësisë dhe harmonizimin ndërinstitucional e bën këtë status të veçantë jo të qëndrueshëm, nëse nuk shoqërohet me disa mekanizma vlerësimi të standardizuar specifik për arsimin e lartë artistik të nivelit 6 të kualifikimit.

Programi Bachelor në Koreografi ofrohet nga Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë në Universitetin e Arteve, i vetmi institucion publik i arsimit të lartë artistik në Shqipëri. Programi synon përgatitjen e skenografëve, kostumografëve dhe interdizajnerëve të aftë për të krijuar në teatër, opera, balet, film, televizion, modë e industri. Me një traditë që nis në vitin 1973, programi bazohet në konkurrim, ofron formim teorik e praktik bashkëkohor dhe vendos studentin në qendër të procesit mësimor. Qëllimi është zhvillimi i aftësive krijuese, profesionale dhe udhëheqëse në artin skenik dhe vizual.



**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;
Përshkrim përmbledhës; (200-400 fjalë)**

Vizita e Grupit të Vlerësimit të Jashtëm në Fakultetin e Arteve Skenike u zhvillua gjatë dy ditëve, më 29 dhe 30 prill 2025. Aktivitetet nisën me një takim të brendshëm të grupit të vlerësimit, ku u diskutua mbi ecurinë dhe organizimin e vizitës, së bashku me Koordinatorin Teknik të ASCAL-it dhe Koordinatorin Institucional.

Më pas u zhvillua një takim me Dekanin e Fakultetit të Arteve Skenike dhe Përgjegjës të Departamentit të Skenografi-Kostumografi, ku u trajtuan çështje që lidhen me strukturën, funksionimin dhe zhvillimet në departament. Vijoi takimi me përfaqësuesit e Grupeve të Vlerësimit të Brendshëm për të dy programet e studimit që ishin objekt i vlerësimit. Më tej, u mbajt një takim me stafin akademik të angazhuar në këto programe, si me ata me status efektiv, ashtu edhe me të angazhuarit me kontratë.

Pas një pushimi të shkurtër për drekë pune, grupi u takua me studentët e të dy programeve të studimit, për të dëgjuar opinionet dhe përvojat e tyre lidhur me procesin mësimor dhe përmbajtjen e programeve. Më vonë, u realizua një takim me përfaqësues të sektorëve përgjegjës për çështjet mësimore dhe kurrikulare, informimin dhe këshillimin e studentëve, si dhe me përfaqësues të rrjetit të ish-studentëve (Alumni). Dita e parë u përmbyll me një vizitë në sekretarinë mësimore dhe një takim përmbyllës të shkurtër mes palëve pjesëmarrëse.

Në ditën e dytë, aktivitetet nisën me një tjetër takim të brendshëm të grupit të vlerësimit, për të përgatitur vijimin e punës. Më pas u zhvillua një takim me përfaqësuesit e Zyrës së Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ku u diskutua mbi mekanizmat dhe dokumentacionin e brendshëm të cilësisë në institucion. Vizita vijoi me një takim me përfaqësues të Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Informacionit, si dhe me Zyrën e Projekteve Artistike dhe Shkencore, ku u diskutua mbi përfshirjen e stafit dhe studentëve në projekte të ndryshme. Në pjesën e dytë të ditës u realizua një vëzhgim i mjediseve të fakultetit, duke përfshirë auditorët, laboratorët, bibliotekën dhe shërbimet mbështetëse për studentët. Vizita u përmbyll me një takim me Përgjegjës të Departamentit, ku u ndanë përshtypjet, u prezantuan gjetjet dhe u përmbyll procesi i vlerësimit për këtë fazë.

Universiteti i Arteve është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm në datë 03.09.2025, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr Prot 23/24, datë 03.09.2025. Institucioni njofton për komentet në ASCAL më datë 09.09.2025, nëpërmjet shkresës me Nr Prot 1392, datë 09.09.2025. GJVJ dërgon përgjigjen per komentet.



GVJ, pasi u njoh me komentet e institucionit mbi draft-raportin, sqaron si vijon:

Lidhur me komentet në **Fushën III, Standardi III.1, Kriteri 6**, të paraqitura nga Universiteti i Arteve të Tiranës (UART), GVJ rithekson se, ashtu siç është sqaruar edhe në hartimin e raportit, statusi i veçantë i këtij universiteti, i parashikuar në VKM nr. 145, datë 10.03.2021, përbën një element me rëndësi për funksionimin dhe ecurinë e UART.

Në bazë të raportit të vlerësimit të brendshëm dhe dokumentacionit të paraqitur nga UART, vërehet se, megjithëse institucioni ka nënshkruar disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare, në nivel fakulteti dhe departamenti nuk janë realizuar mobilitete të stafit dhe studentëve gjatë tre viteve të fundit akademikë. Mobilitetet akademike, si për stafin ashtu edhe për studentët, përbëjnë një mundësi të vlefshme për shkëmbim njohurish, zhvillim të aftësive profesionale dhe përmirësim të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në këtë kuadër, GVJ vëren përpjekjet e vazhdueshme të institucionit për realizimin e mobiliteteve akademike dhe i vlerëson këto iniciativa. GVJ inkurajon që këto përpjekje të intensivikohen më tej, duke shfrytëzuar mundësitë e ofruara nga programet ndërkombëtare të bashkëpunimit, pasi mobilitetet përbëjnë një instrument të rëndësishëm për zhvillimin profesional të stafit dhe pasurimin e përvojës studimore të studentëve.

Në lidhje me **Fushën III, Standardi III.1**, GVJ dakordëson ndryshimin e pikëvlerësimit për këtë standard, por rekomandon që në vijim të vijohen përpjekjet për nxitjen e mobiliteteve ndërkombëtare.

Në lidhje me **Fushën III, Standardi III.4, Kriteri 1**, GVJ vlerëson përpjekjet e institucionit për përmirësimin e laboratorëve dhe atelieve artistike në Universitetin e Arteve të Tiranës (UART). GVJ sugjeron që të vijohen kontaktet me institucionet dhe palët e tjera të interesuara, me qëllim ndjekjen e ecurisë dhe përmirësimin e mëtejshëm të ambienteve laboratorike.

Në lidhje me **Fushën III, Standardi III.4, Kriteri 1**, GVJ dakordëson ndryshimin e pikëvlerësimit për këtë standard.

Në lidhje me **Fushën III, Standardi III.5, Kriteri 5**, si edhe në përfundimet përkatëse, GVJ dakordëson ndryshimin e pikëvlerësimit për këtë standard.

Në lidhje me **Fushën IV, Standardi IV.1**, mbi konkluzionet e këtij kriteri, GVJ shprehet se GVJ, vlerëson përpjekjet e fakultetit dhe departamentit për arritjen standarteve, sipas kritereve ligjore.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Koreografi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programet e studimit Bachelor që ofron Fakulteti i Arteve Skenike (FAS), janë të orientuara për të mbështetur interesat kombëtare. Program Bsc. Koreografi ofrohet në gjuhën shqipe dhe ofron mundësi unike edukimi në fushën e Koreografisë, duke synuar ruajtjen dhe promovimin e vlerave akademike, artistike dhe kulturore kombëtare. Programet janë të miratuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe janë në përputhje me prioritetet zhvillimore të vendit. <i>1.1 Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”</i> <i>1.5 Statutit të UART të Miratuar me Urdhër të MASR Nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Për t'u përafuar me tregun e punës, programi i studimit në Koreografi ofron mundësi konkurruese dhe mbështeten në një traditë të gjatë formuese prej rreth 45 vitesh. Në këtë kuadër, UART është institucioni unik në Shqipëri që përgatit talente të reja në koreografi. <i>1.5 Statutit të UART të Miratuar me Urdhër të MASR Nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij.	Misioni i Programit të Studimit Bachelor në Koreografi përputhet me misionin e Universitetit të Arteve, duke synuar ofrimin e një arsimit të lartë cilësor dhe zhvillimin e veprimtarive krijuese e kërkimore në fushën e artit dhe kulturës. Programi ka si qëllim formimin profesional dhe krijues të studentëve në fushën e koreografisë, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, përmes ndërthurjes së njohurive teorike dhe praktike. Ai përgatit specialistë të aftë të kontribuojnë në jetën artistike dhe kulturore të vendit, duke ruajtur e zhvilluar trashëgiminë kulturore dhe duke mbështetur zhvillimin e një shoqërie demokratike dhe të qytetëruar. Programi bazohet në kërkesat bashkëkohore për mësimdhënie cilësore dhe në zbatimin e Kartës së Bolonjës, duke synuar një formim të krahasueshëm me programet evropiane dhe promovimin e kreativitetit, kualifikimit dhe angazhimit të studentëve në art dhe kulturë. <i>1.5 Statutit të UART të Miratuar me Urdhër të MASR Nr. 319, datë 13.09.2021 “Për miratimin e Statutit të UART”</i> <i>1.19 Mbi miratimin e planit të zhvillimit strategjik të UART për vitet akademike 2018-2025</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike	Programi i Studimit Bachelor në Koreografi mbështetet në Strategjinë e Zhvillimit të UART dhe ka për qëllim ofrimin e arsimit të lartë profesional dhe zhvillimin e veprimtarisë krijuese në fushën e artit dhe kulturës, në përputhje me misionin e FAS/UART për zhvillimin dhe

<p>specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>mbrojtjen e dijeve përmes mësimdhënies dhe aktiviteteve artistike brenda dhe jashtë vendit, formimin e studiuesve të rinj në fushat teorike të vlerësimit të artit dhe krijimin e bazave për kualifikimin profesional, artistik dhe shkencor të specialistëve të lartë. FAS/UART ka ndërtuar marrëdhënie bashkëpunimi me universitete dhe institucione evropiane, duke i përdorur këto marrëveshje si mjete për mbështetjen e mësimdhënies, krijimtarisë dhe kërkimit shkencor. Në kuadër të ndërkombëtarizimit të arsimit të lartë, FAS/UART promovon një perspektivë të gjerë globale dhe ndërkulturore, duke afirmuar individualitetin e saj në fushën e krijimtarisë, gjuhës dhe kulturës.</p> <p>1.26 Organigrama e UART e miratuar nga MASR së bashku me Statutin e UART</p> <p>1.5 Statutit të UART të Miratuar me Urdhër të MASR Nr. 319, datë</p> <p>13.09.2021 "Për miratimin e Statutit të UART"</p>			
<p>Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Koreografi ofrohet nga Fakulteti i Arteve Skenike dhe është në përputhje me fushën akademike të arteve të performuara. Ky program është i akredituar dhe i kodifikuar sipas udhëzimeve kombëtare dhe evropiane, duke respektuar standardet për cilësinë e arsimit të lartë.</p> <p>Njësia përgjegjëse për këtë program është departamenti Skenografi dhe Koreografi, e cila siguron ekspertizën dhe burimet e nevojshme për mbështetje akademike dhe praktike. Programi është në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë (KCAL), Manualin për Vlerësimin e Cilësisë dhe Standardet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë (ESG 2015).</p> <p>1.23 Specifikimet dhe permbajtjet e kodifikimit të programeve të studimit</p> <p>1.24 European Standards and Guidelines-ESG 2015</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti i Arteve i Tiranës (UART) ofron programe studimi të cilat janë hartuar dhe zhvilluar në përputhje të plotë me misionin dhe vizionin institucional, duke reflektuar angazhimin e tij për të promovuar arsimin e lartë cilësor në fushat e artit dhe kulturës. Këto programe janë të lidhura ngushtë me fushën akademike dhe shkencore të njësisë bazë përgjegjëse përkatëse, çka garanton përputhshmërinë mes ekspertizës disiplinore të stafit akademik dhe përmbajtjes kurrikulare.</i></p> <p><i>Në themel të filozofisë akademike të UART qëndron ruajtja dhe zhvillimi i identitetit kombëtar përmes artit, duke i dhënë përparësi trashëgimisë kulturore shqiptare, promovimit të vlerave artistike kombëtare dhe krijimtarisë bashkëkohore që ndërvepron me kontekstin global. Programet synojnë të edukojnë artistë, pedagogë dhe profesionistë të artit që jo vetëm zotërojnë njohuritë dhe aftësitë profesionale në fushat përkatëse, por edhe janë të përkushtuar ndaj promovimit dhe mbrojtjes së vlerave të trashëgimisë kulturore dhe interesave kombëtare</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>





Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësisimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njërive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>Departamenti i Skenografi dhe Koreografi në Fakultetin e Artit Skenik (FAS) është përgjegjës për ofrimin e programit të studimit në Koreografi dhe operon në përputhje me aktet ligjore dhe rregulloret kombëtare dhe evropiane. Ai bashkëpunon me struktura të tjera mbështetëse të universitetit, si sekretaria mësimore dhe biblioteka, për zhvillimin e procesit mësimor dhe administrativ. Në fillim të çdo viti akademik, diskutohet për prioritetet dhe ngarkesat e stafit akademik</p> <p>1.26 Organigrama e UART e miratuar nga MASR së bashku me Statutin e UART</p>
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendas dhe/ose të huaj.</p>	<p>UART ka zhvilluar dhe vazhdon të zhvillojë marrëdhënie bashkëpunimi ndërkombëtare në fushën e edukimit dhe kërkimit artistik-shkencor me shumë universitete dhe institucione në Evropë dhe jashtë saj.</p> <p>Disa nga marrëveshjet e rëndësishme përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Memorandum Mirëkuptimi me Conservatoire National Supérieur de Musique et de Dance de Paris, • Ministrinë e Kulturës • festival ndërkombëtare si CINEDAYS në Shkup • Zhejiang Normal University në Kinë. <p>UART vlerëson pjesëmarrjen në projekte ndërkombëtare dhe mundëson mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik për të gjithë ciklet e studimeve.</p> <p>1.21 Marrëveshjet me partnerët UART 1.25 Raportet e vlerësimit të performancës vjetore 1.29 Marrëveshje bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit</p>
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.</p>	<p>FAS/UART ka dhënë një rëndësi të madhe bashkëpunimit me institucione të tjera për të ofruar shërbime studentëve të tij. Në këtë kuadër, janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Radio Televizioni Shqiptar, • Teatri Kombëtar, • Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, • Universiteti i Tiranës, • Universiteti "Aleksandër Moisiu" në Durrës, • Universiteti "Luigj Gurakuqi" në Shkodër, • Shkolla Kombëtare Artistike "Jordan Misja", • Shkolla Kombëtare Koreografike,




	<ul style="list-style-type: none"> • Teatri i Metropolit, • Teatri Eksperimental. <p>Përveç kësaj, UART ka lidhur marrëveshje në kuadër të "Paktit për Universitetin," që çuar në krijimin e marrëveshjeve me institucione të tjera shtetërore si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Instituti Kombëtar i Regjistrimit të Trashëgimisë Kulturore, • Ministria e Kulturës, • Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore, • Teatri i Operas dhe Baletit. <p>Këto marrëveshje kanë ndihmuar në plotësimin e nevojave të studentëve për funksionimin dhe realizimin e programeve të tyre në fushat përkatëse të studimit.</p> <p>1.28 UART në marrëveshjet e bashkëpunimit në kuadër të projektit Erasmus dhe Erasmus +</p> <p>1.29 Marrëveshje bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit</p> <p>1.30 Aktivitetet e realizuara në institucionet partnere tre vitet e fundit</p>
<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë, në përgjegjësinë e programit të studimit Bachelor në Koreografi, bashkëpunon ngushtë me Dekanatin e FAS për të shqyrtuar dhe analizuar gjendjen aktuale të bashkëpunimeve dhe përfitimet që vijnë nga marrëveshjet e realizuara. Këto bashkëpunime analizohen periodikisht për të vlerësuar ndikimin e tyre në realizimin e objektivave të programit të studimit dhe për të përfituar maksimalisht nga mundësitë që ofrojnë.</p> <p>Njësia e Departamentit synon që të shfrytëzojë çdo mundësi për të forcuar lidhjet akademike dhe praktikat profesionale për studentët. Bashkëpunimi me institucione si:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Teatri i Operas dhe Baletit, • Ansambli Kombëtar i Këngëve dhe Valleve Popullore, • Teatri Eksperimental "Kujtim Spahivogli", • Teatri i Metropolit <p>është i rëndësishëm për zhvillimin praktik dhe profesional të studentëve, duke ofruar mundësi për ekspozim dhe zhvillim të aftësive të tyre artistike.</p> <p>1.25 Raportet e vlerësimit të performancës vjetore</p> <p>1.29 Marrëveshje bashkëpunimi të UART me Institucione homologe brenda dhe jashtë vendit</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>Universiteti i Arteve i Tiranës (UART) ndërton dhe kultivon marrëdhënie bashkëpunimi me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit, kërkimit dhe kulturës, me institucione publike dhe private, kompani dhe organizata të sektorit të industrisë kreative, si dhe me aktorë të rëndësishëm të jetës artistike dhe</p>




	<p>kulturore, brenda dhe jashtë vendit. Këto marrëdhënie vendosen dhe zhvillohen në funksion të përmbushjes së objektivave të programeve të studimit dhe të përforcimit të misionit të universitetit në edukimin artistik, në kërkimin shkencor e krijues dhe në përgatitjen e studentëve për tregun profesional.</p> <p>Bashkëpunimet synojnë krijimin e hapësirave për praktika profesionale dhe angazhime reale të studentëve në institucione të artit dhe kulturës, përfshirjen e profesionistëve të njohur të fushës në procesin mësimor, si dhe nxitjen e projekteve të përbashkëta kërkimore, prodhime artistike, festivale, ekspozita, botime dhe veprimtari të tjera kulturore. Nëpërmjet marrëveshjeve të mobilitetit, UART angazhohet gjithashtu në shkëmbime akademike me universitete partnere, duke ndihmuar studentët dhe stafin të zhvillojnë përvoja ndërkombëtare që thellojnë kompetencat e tyre dhe rrisin konkurrueshmërinë në kontekste më të gjera.</p> <p>Këto bashkëpunime përfaqësojnë një komponent strategjik në zhvillimin institucional të UART dhe dëshmojnë për përkushtimin e tij në integrimin e arsimit të lartë artistik me zhvillimet kulturore, ekonomike dhe shoqërore në nivel kombëtar dhe global.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1

Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i Studimit <i>Bachelor në Koreografi</i> ka për qëllim të ofrojë arsimim cilësor për studentët, duke u përshtatur me nevojat e tyre, kërkesat e shoqërisë dhe të tregut të punës. Synimi është që studentët të pajisen me njohuri të thelluara dhe aftësi profesionale që u mundësojnë të përballen me sfida komplekse dhe të paparashikueshme në fushën e artit koreografik. Programi është i organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe përputhet me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe legjislacionin vendas në fuqi. Ai përfshin gjithsej 180 ECTS, të shpërndara në tri vite studimi.</p> <p>Lëndët janë të strukturuar në këto kategori:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A. Lëndë Bazë: Përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme. • B. Lëndë Karakterizuese: Përgatitje në disiplinën shkencore-artistike të fushës së koreografisë. • C. Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese: Lëndë të lidhura me profile dhe nën-disiplina.

	<ul style="list-style-type: none"> • D. Lëndë Plotësuese: Zgjedhje, gjuhë e huaj, dhe praktikë profesionale. • E. Detyrime Përmbyllëse: Përfshin punimin e diplomës, temën teorike dhe projektin artistik. <p>2.1 Planit Mësimor Koreografi</p> <p>2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale dhe specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Koreografi ofron një formim të integruar teorik, praktik dhe krijues, duke përgatitur profesionistë të aftë të përgjigjen ndaj kërkesave të tregut të arteve performuese. Ai synon zhvillimin e mendimit kritik, pavarësisht krijuese dhe kompetencës teknike përmes një qasjeje pedagogjike me studentin në qendër dhe metodave interaktive të mësimdhënies. Programi është ndërtuar mbi parime të qarta akademike, përfshin praktikën profesionale si pjesë thelbësore dhe synon formimin e koreografëve që veprojnë me ekspertizë artistike dhe ndërdisiplinare.</p> <p>2.1 Planit Mësimor Koreografi</p> <p>2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi</p>
<p>Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Koreografi është i strukturuar në përputhje me kornizën ligjore kombëtare dhe me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, duke ndjekur gjithashtu parimet e Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Organizimi i lëndëve në kategori të diferencuara reflekton një qasje të balancuar dhe të shumëdimensionale ndaj formimit akademik dhe profesional të studentëve, duke synuar zhvillimin e kompetencave teorike, teknike, metodologjike dhe krijuese në fushën e koreografisë.</p> <p>Lëndët janë të ndara në pesë kategori kryesore:</p> <ul style="list-style-type: none"> • A. Lëndë Bazë: • B. Lëndë Karakterizuese: • C. Lëndë Ndërdisiplinore/Integruese: • D. Lëndë Plotësuese: • E. Detyrime Përmbyllëse: <p>Struktura është ndërtuar në mënyrë që të sigurojë plotësimin e 180 krediteve ECTS në një cikël trevjeçar, duke garantuar transparencë në vlerësim dhe lehtësi në mobilitetin akademik brenda hapësirës evropiane të arsimit të lartë. Në terma analitike, kjo organizim ndihmon në sigurimin e koherencës vertikale dhe horizontale të kurrikulës, duke mundësuar një progres të qëndrueshëm të studentëve drejt objektivave të kompetencës profesionale dhe krijimtarisë artistike.</p> <p>2.1 Planit Mësimor Koreografi</p> <p>2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi</p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e</p>	<p>Struktura e kurrikulës së programit të studimit Bachelor në Koreografi është ndërtuar në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe udhëzimet specifike të përcaktuara në VKM nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga IAL", e ndryshuar. Organizimi</p>




praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.

i lëndëve sipas kategorive A-E siguron një shpërndarje të balancuar të përgatitjes teorike, metodologjike, artistike dhe praktike të studentit, duke ndërtuar një profil të plotë dhe të integruar profesional.

1. Struktura sipas kategorive të lëndëve dhe raporti i krediteve:

- **Kategoria A (Lëndë Bazë):** 20 ECTS
Fokusohe në ndërtimin e themeleve metodologjike dhe të kulturës së përgjithshme akademike.
- **Kategoria B (Lëndë Karakterizuese):** 107 ECTS
Përbëjnë bërthamën profesionale të programit me fokus në përgatitjen specifike shkencore dhe artistike në fushën e koreografisë.
- **Kategoria C (Lëndë Ndërdisciplinore/Integruese):** 20 ECTS
Promovojnë ndërveprimin me disiplina të tjera që kontribuojnë në zgjerimin e perspektivës së studentit dhe në ndërtimin e aftësive për integrim të njohurive.
- **Kategoria D (Lëndë Plotësuese):** 23 ECTS
Përfshijnë lëndë me zgjedhje, mësimin e gjuhëve të huaja dhe praktikën profesionale, duke ndihmuar studentin të personalizojë formimin e tij.
- **Kategoria E (Detyrime Përmbyllëse):** 10 ECTS
I referohen diplomës ose projektit përfundimtar artistik, që kërkon integrimin e njohurive të fituara në formën e një produkti përfaqësues dhe vlerësues.

Në total, studenti duhet të përmbushë 180 ECTS në tre vite, përkatësisht 60 ECTS në vit akademik, ku një kredit përfaqëson 25 orë pune studentore, përfshirë leksionet, seminarët dhe punën individuale jashtë auditorit.

Një element qendror i programit është praktika profesionale, e strukturuar në mënyrë të vazhdueshme gjatë tre viteve të studimit, me nga 180 orë çdo vit në auditor dhe në ambiente partnerësh, ku studentët performojnë për publikun. Praktika vlerësohet nga pedagogë me profil profesional dhe përkon me fundin e çdo viti akademik, duke përbërë gjithsej 6 kredite.

2.1 Planit Mësimor Koreografi

2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi

Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Universiteti i Arteve i Shqipërisë (UART) është institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë në fushën e arteve në vend, sipas VKM nr. 145, datë 10.03.2021. Fakulteti i Artit Skenik (FAS) ofron programe studimi me kohë të plotë, të ndërtuara sipas misionit institucional dhe standardeve kombëtare e evropiane. Pranimi bëhet me konkurse dhe kuota të miratuara nga MAS, ndërsa tarifrat dhe bursat përcaktohen me vendim qeverie. Megjithëse UART mbështet studentët me aftësi të kufizuara sipas legjislacionit, në programet e skenografisë dhe koreografisë nuk parashikohen kuota për ta për shkak të kërkesave specifike fizike.

1.15 Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit UART

1.16 Rregullorja e Njesisë Kryesore FAS

1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi

1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi

<p>Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>Universiteti i Arteve i Shqipërisë (UART), Fakulteti i Artit Skenik (FAS), dhe konkretisht Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë nuk ofrojnë programe studimi të Ciklit të Parë (Bachelor) në të njëjtën fushë studimi dhe me të njëjtën emërtesë.</p>			
<p>Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Koreografi është i kodifikuar dhe ndjek rregullat e përcaktuara në VKM Nr. 310, datë 11/05/2022, që lidhen me specifikimet dhe kodifikimin e programeve të studimit në institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri. Ky program ka kodin 63BA dhe është një program të ciklit të parë (Bachelor), që përfshin të paktën 180 ECTS.</p> <p>1.24 European Standards and Guidelines-ESG 2015</p>			
<p>Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>	<p>Programi i studimit në Koreografi i ofruar nga ky departament është i vetmi në Shqipëri në këtë fushë.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit është konceptuar dhe organizuar në përputhje të plotë me kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë.</i></p> <p><i>Struktura, përmbajtja, kurrikula, ngarkesa mësimore dhe rezultatet e të nxënit janë të ndërtuara në përputhje me Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve (KSHK), duke garantuar transparencë, krahasueshmëri dhe transferueshmëri të krediteve sipas sistemit ECTS.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
<p>Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.</p>				
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>			
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</p>	<p>Universiteti i Arteve (UART) është një institucion i integruar që përbëhet nga njësi kryesore akademike dhe struktura ndihmëse, administrative dhe akademike, që vepron në përputhje me Ligjin Nr. 80/2014 për Arsimin e Lartë, legjislacionin në fuqi dhe statutin e vet. Këto struktura sigurojnë përmbushjen e misionit dhe objektivave të universitetit.</p> <p>Fakulteti i Artit Skenik (FAS) FAS ofron programe studimi në të tri ciklet, në përputhje me objektivat akademikë dhe Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve. Stafi i Departamentit të Skenografisë dhe Koreografisë (S&K), për vitin 2024-2025 Stafi efektiv (11 pedagogë):</p>			

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-13423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<ul style="list-style-type: none"> • 1 Profesor Doktor • 1 Profesor • 4 Profesorë të Asociuar • 2 Profesorë të Asociuar Doktor • 3 Asistent Lektorë (prej të cilëve 2 janë doktorantë) • Staf i me kontratë (6 pedagogë): • 1 Profesor i Asociuar/Doktor • 5 Asistent Lektorë <p>Stafi përgjegjës për programin Bsc. Koreografi sipas viteve akademike është:</p> <p>Viti 2022-2023:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Totali staf: 20 • PAE (staf efektiv): 11 që përbën 55% • PAK (staf me kontratë): 9, që përbën 45% <p>Viti 2023-2024:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Totali staf: 24 • PAE (staf efektiv): 11, që përbën 45.83% të totalit • PAK (staf me kontratë): 13, që përbën 54.17% të totalit <p>Viti 2024-2025:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Totali staf: 17 • PAE (staf efektiv): 11, që përbën 64.71% të totalit • PAK (staf me kontratë): 6, që përbën 35.29% të totalit <p><i>Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, vihet re një përqindje jo e balancuar e stafit PAE dhe PAK gjatë dy viteve të para akademike. Kjo situatë është përmirësuar në vitin e fundit akademik, ku raporti është 70% staf PAE dhe 30% staf PAK. GVJ rekomandon që kjo balancë të ruhet edhe në vijim, në mënyrë që të jetë në përputhje me kriteret ligjore për strukturën e stafit akademik.</i></p> <p>1.27 Tabelat e stafit akademik FAS</p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Në Universitetin e Arteve (UART), pranë çdo njësie kryesore funksionojnë struktura ndihmëse me karakter akademik dhe administrativ, të cilat mbështesin procesin mësimor, veprimtaritë artistike dhe kërkimin shkencor.</p> <p>Në Fakultetin e Artit Skenik (FAS), këto struktura janë të organizuara si më poshtë:</p> <p>Personeli Ndihmës Akademik- Me karakter mësimor/artistik/shkencor: mbështet mësimdhënien dhe projektet.</p> <p>Me karakter administrative që ndihmon në funksionimin e brendshëm të fakultetit.</p> <p>Struktura e FAS</p> <ul style="list-style-type: none"> • Administrative: • Kryetari i Degës • Punonjësit e shërbimit • Ndihmë akademike administrative: • Sekretaria e FAS • Kryesekretarja • Specialisti për kurrikulën dhe informimin e studentëve <p>Ndihmë akademike mësimore: Specialistët (laborantët) e FAS</p>




	Këto struktura sigurojnë funksionimin efektiv të fakultetit dhe realizimin me cilësi të programeve të studimit.			
	1.26 Organigrama e UART e miratuar nga MASR së bashku me Statutin e UART			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Në Departamentin e Skenografisë dhe Koreografisë janë krijuar dy grupe mësimore: ai i Skenografisë dhe Kostumografisë dhe ai i Koreografisë, i cili është i përbashkët për ciklin e parë dhe të dytë të studimeve. Përgjegjësit e grupeve janë përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programeve në përputhje me objektivat. Për programin e studimit Bachelor në Koreografi është emëruar një koordinatör nga Dekani i FAS, i cili është përgjegjës për drejtimin e programit dhe praktikave profesionale, dhe zakonisht ky rol kryesohet nga pedagogu që është edhe kryetar i grupit mësimor përkatës. Ky sistem siguron organizim dhe cilësi në realizimin e programeve akademike dhe praktike.			
	1.26 Organigrama e UART e miratuar nga MASR së bashku me Statutin e UART			
Konkluzione	Njësia bazë, përgjegjëse për programin e studimit, përmbush në mënyrë të plotë kërkesat e përcaktuara në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi për institucionet e arsimit të lartë, si dhe standardet e cilësisë të përcaktuara nga autoritetet përkatëse. Njësia përgjegjëse garanton zhvillimin, zbatimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit, duke siguruar përputhshmëri me fushën akademike përkatëse, përmbajtjen e kurrikulës, kompetencat e nevojshme të stafit akademik dhe cilësinë e procesit mësimor, në funksion të përmbushjes së objektivave të programit dhe përgatitjes së studentëve në përputhje me kërkesat e tregut të punës dhe zhvillimet bashkëkohore në fushën e artit dhe kulturës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Departamenti i Skenografi dhe Koreografi është një njësi bazë dhe pjesë përgjegjëse për programet e studimit që përbëjnë Fakultetin e Artit Skenik (FAS). Programet e studimit hartohen dhe standardizohen duke respektuar udhëzimet e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit (MAS) dhe VKM Nr. 145, datë 10/03/2021, që i jep statusin e vecantë Universitetit të Arteve si institucioni publik i vetëm për arsimin e lartë në fushën e arteve në Shqipëri. Plani Mësimor përmban: <ul style="list-style-type: none"> • Emërtimin e programit dhe objektivat formuese, • Kohëzgjatjen normale të studimeve,

	<ul style="list-style-type: none"> • Veprimtaritë formuese (disiplinat) të ndara në semestre dhe renditur sipas tyre, • Kreditet për çdo veprimtari formuese dhe shpërndarjen e tyre brenda disiplinës sipas llojeve të aktiviteteve (artistike, leksione, ushtrime, seminare, laboratorë, detyra, projekte, etj.), • Ngarkesën në auditor dhe ngarkesën javore, • Karakteristikat e tezës së diplomës. <p>Departamenti ka kapacitetet pedagogjike dhe strukturore të nevojshme për të ofruar programin e studimit në Koreografi dhe kjo është vlerësuar edhe nga Vendimi i Bordit të Akreditimit ASCAL për Akreditimin Institucional të UART.</p> <p>2.1 Planit Mësimor Koreografi 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi është i strukturuar në lëndë të vlerësuara me kredite, në përputhje me VKM Nr. 41, dt. 24/01/2018, udhëzimet e MAS, legjislacionin vendas dhe Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Kuadri formues i programit përcaktohet në planin mësimor, i ndarë në vite dhe i propozuar nga Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë, dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit të Artit Skenik (FAS) dhe Senati Akademik i UART. Kompetencat dhe objektivat e moduleve dhe lëndëve janë të përcaktuara në syllabuset përkatëse.</p> <p>Lëndët e programit grupohen në kategori nga A në E:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Lëndë bazë:. ○ Lëndë karakterizuese. ○ Lëndë ndërdisiplinore/integruese:. ○ Grup-lëndë me zgjedhje: ○ Detyrime përmbyllëse: <p>2.1 Planit Mësimor Koreografi 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi</p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Pranimi bëhet me konkurs dhe jo sipas listave të mesatareve, duke u bazuar kryesisht në parimin e aftësive dhe meritave të kandidatëve. Kriteret e pranimit përcaktohen nga Departamenti i Skenografi dhe Koreografisë dhe bëhen publike nga Dekani i FAS, pas miratimit nga Senati Akademik i UART. Përzgjedhja e studentëve fitues bëhet nga një Komision i ngritur në Departament dhe miratohet nga Dekani i FAS sipas kritereve të përcaktuara. Proceset dhe kriteret e transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve janë të përcaktuara në dokumentet rregullatore të universitetit dhe programit. UART mundëson njohjen dhe transferimin e krediteve midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda vetë institucioneve të tij ose me institucione të tjera të arsimit të lartë. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve merret nga komisioni përkatës i departamentit sipas rregullave të brendshme. Vendimi final për kërkesën për transferim i takon Dekanit të Fakultetit të Artit Skenik (FAS).</p> <p>1.15 Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit UART 1.16 Rregullorja e Njesisë Kryesore FAS 1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi</p>




	<p>2.1 Planit Mësimor Koreografi</p> <p>2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi</p>								
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Të gjitha komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit, në përputhje me formatet e miratuara sipas VKM 41, dt. 24/01/2018, i ndryshuar.</p> <p>Ky informacion është pasqyruar në Planin Mësimor të Programit të Studimit.</p> <p>Në planin mësimor dhe syllabuset për çdo vit paraqiten të gjitha informacionet e nevojshme për seminarët dhe orët e laboratorit, si dhe komponentët e tjerë formues të programit, brenda dhe jashtë auditorit. Syllabuset rishikohen nga pedagogët përkatës dhe miratohen para fillimit të vitit akademik nga përgjegjësi i departamentit.</p> <p>Hartimi i syllabuseve bëhet në përputhje me udhëzimet përkatëse.</p> <p>1.15 Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit UART</p> <p>1.16 Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS</p> <p>1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi</p> <p>1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi</p> <p>2.1 Planit Mësimor Koreografi</p> <p>2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi</p>								
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>Përmirësimi dhe përditësimi i programit të studimit realizohet në mënyrë të vazhdueshme, në përputhje me rregulloren e programit, rregulloren e Departamentit të Skenografisë dhe Koreografisë, si dhe rregulloren e përgjithshme të institucionit. Ky proces zhvillohet përmes kontributit të drejtpërdrejtë të personelit akademik, rifreskimit të literaturës në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe diskutimeve të rregullta në mbledhjet e departamentit, ku shqyrtohen nevojat për përmirësim dhe përshtatje të programit. Përditësimi bëhet gjithashtu duke marrë parasysh zhvillimet bashkëkohore në fushën e koreografisë dhe nevojat reale të tregut të punës. Çdo ndryshim në planin mësimor miratohet me vendim të Senatit Akademik të IAL dhe, sipas praktikës së konsoliduar në UART, arkivohet në dosjen përkatëse të programit në fillim të çdo viti akademik.</p> <p>1.15 Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit UART</p> <p>1.16 Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS</p> <p>1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi</p> <p>1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Programi i studimit është i hartuar në mënyrë të detajuar, informuese dhe të strukturuar, duke qenë në përputhje me objektivat formues dhe kërkesat e përcaktuara për programet e ciklit të parë.</i></p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Nuk përmbushet</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.4

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Lëndët dhe praktikat janë të strukturuar për të përmbushur kërkesat ligjore dhe për të lehtësuar avancimin akademik dhe profesional. Departamenti dhe Fakulteti i Artit Skenik ofrojnë mbështetje dhe mundësi punësimi, ndërsa orët mësimore përfshijnë punë konkrete artistike dhe teorike përgatitëse për karrierë në koreografi.</p> <p>1.15 Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit UART 1.16 Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS 1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi 2.1 Planit Mësimor Koreografi 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi</p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.</p>	<p>Programi Bachelor në Koreografi përgatit studentët me njohuri dhe aftësi teorike e praktike për t'u punësuar si koreografë. Ai zhvillon gradualisht kompetencat që i bëjnë konkurrues në tregun e punës dhe i mundëson studime të avancuara dhe kërkime artistike.</p> <p>Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A–E) (Tabela 9) 2.1 Planit Mësimor Koreografi 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi</p>
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p>	<p>Lëndët dhe modulet e Programit Bachelor në Koreografi janë ndërtuar për të siguruar vazhdimësinë dhe thellimin e njohurive nga cikli i parë në ciklin e dytë dhe të tretë të studimeve. Struktura e programit është në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe Kartën e Bolonjës, duke ofruar 180 ECTS të shpërndara në tre vite me dy semestre secili. Ngarkesa mësimore është e balancuar dhe përfshin një raport të drejtë teori-praktikë, që siguron zhvillimin e aftësive profesionale dhe artistike në fushën e koreografisë.</p> <p>Në bazë të strukturës së programit rezulton se: 107 kredite – Lëndë karakterizuese shkencore (B):</p> <ul style="list-style-type: none"> • Baza komp. në Dans • Dans Performance • Kompozim në Dans • Teknika & Prod. Skenik • Repertor • Histori Kërcimi <p>Në këtë program, lëndët karakterizuese kanë ngarkesën më të madhe, pasi i jepet prioritet fushës artistike-praktike, ashtu siç e kërkon vetë natyra dhe metodologjia e programit.</p> <p>Plani mësimor i ndarë sipas Veprimtarive Formuese (A–E) (Tabela 9) 2.1 Planit Mësimor Koreografi 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi</p>
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë</p>	<p>Në programin Bachelor në Koreografi, disiplinat dhe veprimtaritë formuese janë organizuar në 5 kategori (A deri në E) sipas VKM-së Nr. 41/2018. Kjo ndarje lejon një raport të balancuar midis formimit teorik</p>

<p>arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>dhe praktik, brenda secilës lëndë, duke përfshirë veprimtari praktike dhe teorike që përgatitin studentët për tregun e punës. Struktura e programit favorizon transferimin dhe mobilitetin e studentëve, dhe duke harmonizuar programin me standardet dhe programet e BE-së. Prioritetet e fakultetit përfshijnë rritjen e mobiliteteve, aktivitetet artistike kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe konsolidimin e partneriteteve me vende të BE-së.</p> <p>1.15 Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit UART 1.16 Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS 1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi 2.1 Planit Mësimor Koreografi 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi</p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Programet e lëndëve rishikohen çdo fillim viti akademik nga titullari/pedagogu i lëndës, në konsultim me anëtarët e departamentit dhe miratohen nga përgjegjësi i departamentit. Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë analizon performancën e programeve duke marrë parasysh opinionet e pedagogëve dhe studentëve për përmbajtjen e lëndëve. Në bazë të këtyre opinionëve, bëhen përmirësime të mëtejshme në syllabus, duke përfshirë pasqyrën informative të lëndës, rezultatet e nxënit, temat e detajuara, format e kontrollit të dijes, frekuentimin, kontrollin e vazhdueshëm, literaturën dhe vërejtjet përfundimtare nga pedagogu nëse ka. Ky proces është në përputhje me VKM Nr. 41, datë 24.01.2018.</p> <p>2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi</p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e Programit Bachelor në Koreografi është plotësisht në përputhje me qëllimet dhe objektivat e çdo lënde, duke siguruar fitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. Programi fokusohet në dhënien e njohurive bazë, koncepteve dhe aftësive teorike e praktike në koreografinë skenike, si dhe në zhvillimin e kompetencave për kryerjen e kërkimit shkencor në fushën e artit skenik dhe koreografisë.</p> <p>1.15 Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit UART 1.16 Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS 1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi</p>
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e Programit Bachelor në Koreografi lejon vazhdimin e studimeve në ciklin e dytë dhe të tretë, si brenda Universitetit të Arteve (UART/FAS), ashtu edhe në institucione artistike në rajon dhe në Europë. Programi ndihmon studentët të aftësohen dhe të jenë konkurrues në tregun e punës, brenda dhe jashtë vendit, duke i pajisur me njohuri të përshtatura për kërkesat e tregut. Studentët e Departamentit të Skenografisë dhe Koreografisë (S&K/FAS) kontribuojnë me energji dhe frymë të re në shumë institucione artistike dhe kulturore lokale dhe kombëtare, duke punuar në institucione si Teatri Kombëtar, Opera dhe Baleti, Teatri Metropolitan, Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore dhe ansamblet lokale.</p> <p>1.15 Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit UART 1.16 Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS</p>

	1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi			
Konkluzione	<i>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit janë konceptuar dhe zhvilluar në përputhje me objektivat formues të përcaktuara për secilin program, duke garantuar përputhshmëri me nivelin përkatës të kualifikimit, sipas Kuadrit Kombëtar të Kualifikimeve (KKK) dhe Kuadrit Evropian të Kualifikimeve (EQF). Këto programe synojnë të sigurojnë arritjen e rezultateve të të nxëniet të përcaktuara për nivelin e studimeve, të mundësojnë vijimin e studimeve në ciklet pasardhëse dhe të zhvillojnë kompetenca të aplikueshme në praktikë, në përputhje me nevojat dhe dinamikën e tregut të punës. Kjo qasje siguron që studentët të pajisen me njohuri, aftësi dhe qëndrime profesionale të cilat janë të nevojshme për suksesin në karrierë dhe për zhvillim të vazhdueshëm personal dhe profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	<p>Fakulteti i Artit Skenik dhe Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë në Universitetin e Arteve kanë ndërmarrë një proces të vazhdueshëm reformimi të kurrikulave, me synim përafrimin e tyre me kërkesat dinamike të tregut të punës dhe standardet bashkëkohore të arsimit artistik. Përfshirja e pedagogëve me kohë të pjesshme nga institucione artistike të kryeqytetit ka krijuar një lidhje funksionale ndërmjet formimit akademik dhe praktikave profesionale, duke garantuar një përditësim të vazhdueshëm të përmbajtjes mësimore.</p> <p>Strukturimi i studimeve në tre cikle dhe harmonizimi i tyre me kornizën ligjore për profesionet e rregulluara, veçanërisht në fushën e mësuesisë, pasqyron përpjekjet për integrim të plotë në sistemin evropian të arsimit të lartë. Gjithashtu, vlerësimet periodike të studentëve nga NJSPC janë kthyer në një mjet thelbësor për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, literaturës dhe këshillimit akademik.</p> <p>Në Njesinë e sigurimit të brendshëm të cilësisë, bëjnë pjesë anëtarë si nga njësia, ashtu edhe nga stafi akademik, por edhe studentët, ku rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 2 Prof. Asoc. • 1 Dr. • 1 Përfaqësues nga NJSBC • 1 Student <p><i>Të dhëna për anëtarët e NJSBC (Tabela 24)</i></p>
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet	Fakulteti i Artit Skenik (FAS), në kuadër të Universitetit të Arteve (UART), ruan kontakte të rregullta dhe të strukturuar me ish-studentët e diplomuar (ALUMNI), në bashkëpunim me Sektorin Mësimor. Ky bashkëpunim përfshin ndjekjen e ecurisë së tyre profesionale,

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>promovimin e punësimit, si dhe organizimin e aktiviteteve të dedikuara për rrjetin ALUMNI.</p> <p>Gjatë viteve, FAS është krenuar me suksesin e brezave të diplomuar, të cilët kanë shkëlqyer në skenat kombëtare dhe ndërkombëtare, duke nderuar jo vetëm institucionin, por edhe kulturën shqiptare në tërësi. ALUMNI përfaqëson një strukturë të konsoliduar pranë UART, e cila synon forcimin e marrëdhënieve të qëndrueshme me ish-studentët. Këto kontakte mbahen jo vetëm në nivel institucional, por edhe përmes lidhjeve të drejtpërdrejta që krijohen nga stafi akademik me kohë të plotë dhe i ftuar me kohë të pjesshme. Eksperienca dhe kontributi i ish-studentëve vlerësohen si një burim i çmuar për rishikimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kurrikulës. Sugjerimet e tyre janë mirëpritur dhe janë marrë në konsideratë nga drejtuesit e Departamentit të Skenografisë dhe Koreografisë, si dhe nga strukturat përkatëse të FAS, në rastet kur janë parë të realizueshme dhe me vlerë për përmbajtjen akademike dhe për brezat e ardhshëm të studentëve.</p> <p>1.16 Rregullorja e Njesisë Kryesore FAS 1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi</p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Universiteti i Arteve, përmes Fakultetit të Artit Skenik, ka vendosur bashkëpunime strategjike me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare për të përmirësuar shërbimet ndaj studentëve dhe zbatimin e programeve të studimit. Marrëveshje me aktorë kyç si RTSH, Teatri Kombëtar dhe universitete të tjera janë pjesë e kësaj qasjeje, ndërsa disa prej tyre janë zhvilluar në kuadër të “Paktit për Universitetin”. Këto partneritete kanë ndihmuar në fuqizimin e komponentit praktik dhe profesional të arsimit artistik.</p> <p>1.16 Rregullorja e Njesisë Kryesore FAS 1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Institucioni i arsimit të lartë nxit dhe siguron përfshirjen aktive të studentëve, partnerëve socialë dhe institucionalë, rrjeteve akademike dhe organizmave të tjerë përkatës në procesin e hartimit, zhvillimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit. Kjo përfshirje realizohet përmes konsultimeve të rregullta, komisioneve këshillimore, mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë si dhe vlerësimeve periodike. Qëllimi është garantimi i realizimit me sukses të objektivave formuese të programeve, rritja e përputhshmërisë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë, si dhe përgjigjja efektive ndaj kërkesave të tregut të punës dhe zhvillimeve shoqërore</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------------




III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Procesi mësimor në Programin e Studimit "Bachelor në Koreografi" zhvillohet në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore përkatëse.</p> <p>Metodat e mësimdhënies përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • leksione, • seminare, • detyra kursi, • kolokiume, • punë individuale, • detyra praktike, • projekte artistike, • provime, • praktikë profesionale • përgatitja e tezës së diplomës. <p>Mësimdhënia ndjek një qasje ndërvepruese dhe të diferencuar, të orientuar drejt nevojave individuale të studentit. Ajo synon zhvillimin e të menduarit kritik, analitik dhe krijues, përmes integritit të njohurive teorike dhe përvojës praktike, në funksion të përgatitjes për tregun e punës në fushën e artit dhe koreografisë.</p> <p>1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi 2.1 Planit Mësimor Koreografi 2.2 Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi</p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Personeli akademik është përgjegjës për zhvillimin e procesit mësimor dhe vlerësimin e njohurive të studentëve, duke punuar në mënyrë të drejtpërdrejtë me ta sipas metodave bashkëkohore të mësimdhënies. Ata përdorin një shumëllojshmëri teknikash interaktive brenda dhe jashtë auditorit, përfshirë artistë të ftuar dhe ish-studentë që punojnë në institucione artistike. Studentët udhëzohen qartë mbi objektivat dhe kriteret e vlerësimit dhe inkurajohen të zhvillojnë mendim kritik, punë të pavarur dhe të angazhohen në veprimtari krijuese. Staf i akademik përshtat procesin mësimor me nevojat individuale të studentëve dhe orienton ata për rëndësinë e lëndëve dhe lidhjen e tyre me formimin profesional.</p> <p>Vizita në intitucion</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Për të rritur cilësinë e mësimdhënies, institucioni dhe departamenti nxisin pjesëmarrjen e stafit akademik në trajnime, masterclass-e, shkëmbime dhe aktivitete artistike që synojnë përmirësimin e metodave pedagogjike dhe të vlerësimit. Staf i udhëzohet vazhdimisht të zhvillojë kompetencat didaktike në përputhje me objektivat e programit dhe rezultatet e të nxënit. Përmbajtja e mësimin fokusohet në rishikimin e koncepteve themelore, autorëve klasikë, qasjeve të reja dhe analizën e temave të avancuara. Theksohet ndërtimi i leksioneve mbi teori dhe</p>




praktika bashkëkohore, inkurajohet të nxënit i pavarur përmes literaturës shtesë dhe materiale studimore.

Universiteti i Arteve i ofron mbështetje stafit akademik nëpërmjet aplikimit të projekteve të ndryshme, ku përmes këtyre të fundit stafi mund të adresojë, të hulumtojë dhe zhvillojë karrierën artistike, përmes përfitimit të projekteve të aplikuara.

Thirrjet për projekte shpallen gjithashtu në faqen zyrtare të universitetit, duke siguruar transparencë dhe akses të barabartë për të gjithë stafin akademik të interesuar.

Gjithashtu, sipas dokumentacioni të paraqitur dhe diskutimeve me stafin, stafi akademik ka zhvilluar aktivitete artistike si në aspektin personal, po ashtu edhe në bashkëpunim me ish-studentë, si:

- “Fletët e pashkruara të një ditari” me studentët e Koreografisë të Universitetit të Arteve. Viti 2022 v
- “Qark e përqark me vallëzimin” me studentët e Koreografisë të Universitetit të Arteve. Viti 2022 v
- “Hapësira ndërmjet vetes dhe të tjerëve” me studentët e Koreografisë të Universitetit të Arteve. Viti 2022 v
- “Mund të më ktheni kohën që ma rrëmbyet?” me studentët e Koreografisë të Universitetit të Arteve. Viti 2023 v
- “Prespektivë e trefishtë” me studentët e Koreografisë të Universitetit të Arteve. Viti 2024 v
- “Sot do të flas në vetë të parë ” me studentët e Koreografisë të Universitetit të Arteve. Viti 2024 v
- Koreograf në veprën teatrale “Macbeth” në Teatrin Kombëtar të Kosovës, viti 2024. v
- Koreograf në veprën teatrale “Dhelprat e vogla” në Teatrin e Metropolit, viti 2024.

Bazuar në dokumentacionin e paraqitur dhe nga vizita në institucion me stafin akademik, rezulton se:

- Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i departamentit: **1**
- Numri i projekteve kërkimore të fituara në shkallë departamenti/fakulteti: **1**
- Numri i projekteve të zbatuara në shkallë departamenti/fakulteti: **35**
- Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga departamenti/fakulteti dhe IAL, në programin e studimit: **36**
- Numri i pjesëmarrësve në aktivitetet shkencore: **6**
- Numri i çmimeve kombëtare të fituara në rang IAL: -

Rekomandohet që departamenti të intensifikojë aktivitetet kërkimore duke nxitur rritjen e numrit të botimeve shkencore dhe angazhimin në konkurrimin për çmime kombëtare. Për më tepër, duhet të vazhdojë organizimi dhe realizimi i projekteve dhe aktiviteteve shkencore, duke zgjeruar pjesëmarrjen e stafit akademik dhe studentëve, me qëllim forcimin e kulturës kërkimore dhe avancimin e cilësisë akademike të programit të studimit.

	<p><i>Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik, përgjegjës për programin e studimit (Tabela 19)</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i përfshirë në programin Bachelor në Koreografi ka tituj shkencorë, eksperiencë dhe kualifikime të fituara nga aktivitetet artistike kombëtare e ndërkombëtare. Falë këtij formimi dhe angazhimit të vazhdueshëm, ata përdorin në mënyrë efektive si metodat tradicionale, ashtu edhe ato bashkëkohore të mësimdhënies. Stafit është kompetent në transmetimin e njohurive dhe përshtat metodologjinë sipas tematikave të programit. Departamenti S&K ka angazhuar një staf me kohë të plotë dhe me veprimtari të spikatur jashtë auditorit, duke vendosur në qendër të procesit studentët dhe nxitur te ata mendimin kritik, krijues, autonominë dhe përgjegjshmërinë – elementë thelbësorë në krijimtarinë artistike. <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.</p>	<p>Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në Universitetin e Arteve mbështetet në veprimin e njësive bazë akademike, të cilat monitorojnë dhe analizojnë ecurinë e procesit mësimor. Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë përdor sugjerimet e stafit, anketat e studentëve dhe të dhënat administrative për të identifikuar problematikat dhe për të ndërmarrë përmirësime në programet mësimore. Vëmendje e veçantë i kushtohet praktikave profesionale, cilësisë së materialeve studimore dhe provimeve. Gjithashtu, përfshirja e personelit ndihmës dhe administrativ siguron mbështetje teknike dhe logjistike për realizimin e projekteve, regjistrimin e provimeve dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës. Kjo qasje e integruar synon rritjen e standardeve akademike dhe përgatitjen profesionale të studentëve në fushën artistike. <i>1.16 Rregullorja e Njesisë Kryesore FAS</i> <i>1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi</i> <i>1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht</p>	<p>Në Universitetin e Arteve, cilësia e mësimdhënies sigurohet nga departamentet dhe strukturat mbështetëse si Zyra e Kurrikulës, Zyra e Studentëve dhe Zyra e Karrierës. Këto bashkëpunojnë për një mësimdhënie efektive dhe të orientuar drejt studentit. Në Departamentin e Skenografisë dhe Koreografisë përdoren metoda bashkëkohore, përfshi projekte të përbashkëta student-pedagog. Stafit akademik mbështetet për zhvillim profesional përmes trajnimeve, kërkimit artistik dhe pjesëmarrjes në programe ndërkombëtare si Erasmus+. Gjithashtu, përmes projektit GRADUA, monitorohet suksesi i të diplomuarve dhe forcohet lidhja me tregun e punës. <i>Pavarësisht se institucioni ka disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione ndërkombëtare, është evident se në nivel fakulteti dhe departamenti nuk janë zhvilluar mobilitete të stafit dhe studentëve gjatë këtyre tre viteve akademike. Ky është një aspekt që ka ndikuar në mundësitë për përfitimin e përvojave ndërkombëtare dhe ndarjen e njohurive dhe praktikave më të mira nga institucione të tjera të njohura</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p>ndërkombëtarisht. Mobilitetet akademike, si për stafin ashtu edhe për studentët, janë një mundësi e rëndësishme për shkëmbimin e dijes, zhvillimin e aftësive profesionale dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Në këtë kontekst, mungesa e mobiliteteve mund të përbëjë një pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të programit dhe për rritjen e angazhimit të komunitetit akademik me zhvillimet globale në fushën e koreografisë.</p> <p>1.15 Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit UART 1.16 Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Rekomandohet që institucioni të intensifikojë përpjekjet për nxitjen dhe realizimin e mobiliteteve ndërkombëtare për stafin akademik dhe studentët, në nivel fakulteti dhe departamenti. Pavarësisht ekzistencës së marrëveshjeve bashkëpunimi me institucione të huaja, mungesa e mobiliteteve gjatë tre viteve të fundit akademike ka kufizuar përfitimin e përvojave ndërkombëtare dhe shkëmbimin e praktikave më të mira. Përfshirja aktive në programe të mobilitetit do të kontribuonte ndjeshëm në zhvillimin profesional të stafit, përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, si dhe në rritjen e ndërkombëtarizimit të programit të studimit në fushën e koreografisë.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht X</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

<p>Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në programin Bachelor në Koreografi në UART, vlerësimi i studentëve bëhet sipas sistemit shqiptar nga nota 1 deri në 10, ku 5 është nota kaluese. Vlerësimi zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme dhe synon të nxisë studimin gjatë vitit, të ofrojë objektivitet dhe të monitorojë përvetësimin e njohurive. Format e provimeve përcaktohen sipas natyrës së lëndës dhe përfshijnë: provime me shkrim, me gojë, të kombinuara, ose në grup për veprat artistike. Titullari i lëndës, në bashkëpunim me njësinë bazë dhe Dekanin, përcakton mënyrën e organizimit dhe elementët e vlerësimit, të cilat bëhen të ditura studentëve në fillim të semestrit.</p> <p>http://ëëë.uart.edu.al/media/Plani%20M%C3%ABsimor%20Bsc%20Koreografi.pdf</p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Programi i studimit dhe shpërndarja e lëndëve sipas viteve dhe semestreve janë të publikuara në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve. Studentët pajisen me syllabuset në fillim të çdo semestri, të cilat përmbajnë informacion mbi përmbajtjen e lëndës, literaturën, mënyrat e vlerësimit dhe format e kontrollit të dijeve. Ky informacion është gjithashtu i aksesueshëm online dhe pranë Departamentit të Skenografisë dhe Koreografisë. Udhëzime shtesë për ndjekjen e programit, vlerësimin dhe diplomimin jepen gjatë Javës së Orientimit dhe përmes manualit të mësimdhënies.</p> <p>1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi</p>


Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi</p> <p>Procesi mësimor në programin Bachelor në Koreografi, ashtu si në të gjitha programet e tjera të studimit në Universitetin e Arteve, organizohet përmes një shumëllojshmërie formash mësimore dhe mënyrash të kontrollit të njohurive. Këto forma harmonizohen në përputhje me planin mësimor dhe programet përkatëse të lëndëve.</p> <p>Format kryesore të mësimdhënies përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Leksione teorike, seminare dhe ushtrime, • Mësime praktike individuale dhe në grup, • Praktika profesionale, • Projekte artistike, • Konsultime me pedagogët. <p>Kontrolli i njohurive realizohet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Bashkëbisedimeve dhe kontrolleve teknike, • Mbrojtjes së detyrave, projekteve dhe praktikave, • Provimeve ndërmjetëse, përfundimtare dhe të formimit, • Aktiviteteve artistike dhe mbrojtjes së diplomës. <p>Provimet e formimit artistik, që lidhen me lëndët e specializimit, konsistojnë në realizimin profesional të një fragmenti apo shfaqjeje, në mënyrë individuale ose kolektive. Procesi mësimor vlerësohet dhe përmirësohet periodikisht nga njësitë përkatëse dhe stafi akademik, duke përfshirë edhe mendimet e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë.</p> <p>1.16 Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS 1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi</p>
<p>Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Përmirësimi i cilësisë së mësimdhënies në UART realizohet nëpërmjet monitorimit dhe analizës së rregullt nga njësitë bazë dhe Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë. Procesi bazohet në komentet e stafit, anketimet e studentëve dhe të dhënat administrative. Stafi akademik kontribuon me propozime për përmirësimin e lëndëve dhe metodave të mësimdhënies. Mbështetja teknike dhe administrative përfshin aspekte praktike të procesit mësimor, ndërsa përdorimi i metodave fleksibile synon zhvillimin e autonomisë së studentit dhe përgatitjen për tregun e punës.</p> <p><i>Në Universitetin e Arteve, Këshillat Studentore luajnë një rol kyç në përfaqësimin dhe angazhimin e studentëve në jetën akademike dhe institucionale. Ato kanë për qëllim të promovojnë pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe të sigurojnë zërin e tyre në organet drejtuese, në strukturat mësimore-kërkimore dhe në ato të shërbimeve studentore. Përmes tyre, studentët kanë mundësi të shprehin mendimet dhe propozimet e tyre mbi çështje të rëndësishme që lidhen me funksionimin e institucionit – nga planet dhe programet e studimit, rregulloret e veprimtarisë mësimore, e deri te të drejtat studentore, cilësia e shërbimeve dhe organizimi i aktiviteteve kulturore, artistike e sportive. Këshillat Studentore janë një urë komunikimi midis studentëve dhe strukturave drejtuese, duke kontribuar në përmirësimin e vazhdueshëm të jetës universitare.</i></p> <p>http://uart.edu.al/index.php?page=faqe&id=136&niveli=92</p>




<p>Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Institucioni përdor një qasje pedagogjike të avancuar, fleksibile dhe shumëllojshme, të përshtatur me nevojat e studentëve dhe kërkesat e tregut. Stafi akademik zhvillon vazhdimisht kompetenca përmes trajnimeve dhe programeve ndërkombëtare, duke u fokusuar te metodat inovative të mësimdhënies dhe vlerësimit. Mësimdhënia në grupe të vogla nxit pavarësinë, mendimin kritik dhe krijon një ambient bashkëpunues me respekt të ndërsjellë mes studentëve dhe mësimdhënësve. Përmbajtja akademike përfshin teorinë, praktikën. Studentët qëndrojnë në qendër të procesit mësimor, duke zhvilluar aftësi autonome dhe përgjegjësi për krijim profesional dhe artistik.</p> <p><i>Vizita ne institucion</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UART harton dhe zbaton rregullore dhe procedura të posaçme për testimin dhe vlerësimin e njohurive teorike, aftësive praktike dhe kompetencave profesionale të studentëve. Këto instrumente janë ndërtuar në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë dhe synojnë të garantojnë një proces vlerësimi të drejtë, transparent dhe objektiv. Institucioni ndërmerr masa për zbatimin konsekuent të këtyre procedurave përmes monitorimit të vazhdueshëm, trajnimit të stafit akademik dhe forcimit të integritetit akademik.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

<p>Standardi III.3 Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Vlerësimi i studentëve në programin e studimit është një proces gjithëpërfshirës që përfshin pjesëmarrjen në orë (10%), punën krijuese dhe detyrat e kursit (40%), projektet (20%) dhe provimin përfundimtar (30%). Provimet zhvillohen tri herë në vit (dimër, verë, vjeshtë), me datat e caktuara nga Njësitë Bazë dhe miratuar nga Dekani, të shpallura dy javë para se të fillojë secili sezon. Përpara provimeve, studentët duhet të kenë përmbushur të gjitha detyrimet paraprake, duke siguruar kështu barazinë dhe cilësinë akademike të procesit të vlerësimit.</p> <p><i>1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi</i> <i>1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat</p>	<p>Në Fakultetin e Arteve Skenike të Universitetit të Arteve, për shkak të specifikës së programeve, provimet zhvillohen kryesisht në auditor dhe për lëndët profesionale përmes shfaqjeve praktike që vlerësojnë</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	elementë fizikë dhe vizualë. Lëndët teorike testohen në mënyrë të fshehtë për të shmangur paragjykimet. Institucioni përdor gjithashtu platformën Microsoft Teams për komunikim dhe bashkëpunim, të administruar nga Sektori i Teknologjisë dhe Informacionit. 1.15 Rregullorja e ciklit të 1-rë të studimit UART 1.16 Rregullorja e Njësisë Kryesore FAS
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi përfundimtar në programin Bachelor në Koreografi realizohet nga titullari i lëndës ose pedagogu përgjegjës, sipas planit mësimor. Praktikat profesionale dhe diplomimi organizohen nga komisione të posaçme dhe diploma jepet pas përfundimit të të gjitha detyrimeve akademike. Provimi i diplomës përfshin një mbrojtje artistike dhe një punim teorik. Sistemi i vlerësimit, format e provimeve dhe kriteret për kalimin ose përmirësimin e notave përcaktohen nga rregulloret e UART dhe programit specifik. Vlerësimi bazohet në syllabus, ndërsa provimet teorike me shkrim zhvillohen të sekretuara dhe me sistem pikësh. 1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënies për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Aftësitë teorike dhe praktike të studentëve në Fakultetin e Arteve të Skenës (FAS) vlerësohen gjatë gjithë vitit akademik përmes programeve mësimore, provimeve, praktikës profesionale dhe mbrojtjes së diplomës. Për shkak të natyrës praktike të lëndëve, veçanërisht në Koreografi, studentët marrin këshilla individuale pas çdo ore. Në fund të çdo semestri, rezultatet analizohen nga pedagogët për të identifikuar përmirësime të mundshme. Institucioni garanton integritetin akademik përmes luftës kundër plagjiaturës dhe kopjimit, ndërsa vlerësimet janë të bazuara në meritë dhe dorëzohen në kohë, duke ruajtur cilësinë e procesit mësimor. 1.17 Rregullorja e Departamentit Skenografi-Koreografi 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Programi Bachelor në Koreografi ka një natyrë thellësisht praktike dhe krijuese, që e minimizon mundësinë e plagjiaturës falë ndjekjes së vazhdueshme nga pedagogët gjatë vitit akademik. Provimet zhvillohen në prani të komisionit dhe studentëve, në ambiente të kontrolluara, ku respektohet rreptësisht integriteti akademik. Çdo rast kopjimi apo plagjiature ndëshkohet me përjashtim nga provimi dhe vlerësim negativ. Cilësia dhe origjinaliteti i punimeve mbikëqyren edhe përmes platformës zyrtare anti-plagjiaturë të universitetit, duke garantuar transparencë dhe standarde të larta akademike. 1.18 Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Rezultatet e vlerësimit të studentëve jepen në kohë dhe bazohen në meritë. Studentët mund t'i ndjekin vlerësimet në sistemin elektronik PITAGORA, i cili menaxhon të gjitha të dhënat akademike. Çdo kërkesë për rishikim shqyrtohet nga komisione përkatëse në mënyrë transparente, duke garantuar të drejtat e studentëve. 4.19 Manuali PITAGORA




<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p> <p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>Studenti merr rezultatin e provimit nga komisioni brenda 3-5 ditëve nga data e provimit, përveç rasteve të jashtëzakonshme që vendos Dekani. Komisioni duhet të shpallë rezultatet para plotësimit të dokumentacionit dhe të sqarojë studentin për çdo paqartësi. Në rast kontestimi të rezultatit, komisioni bashkëpunon me përgjegjësën e Departamentit për të garantuar transparencë, dhe vendimi përfundimtar është i pakthyeshëm. Kërkesa për rishikim duhet të dorëzohet me shkrim brenda 24 orëve nga shpallja e rezultatit.</p> <p>Kritere 8</p> <p>Sipas rregullores së programi dhe të departamentit, studenti ka të drejtë të ankohen me shkrim brenda 24 orëve nga shpallja e rezultatit nëse janë shkelur rregullat gjatë provimit ose në rast vlerësimi të pamertuar. Ankesa shqyrtohet nga Dekani, i cili mund të thërrasë për sqarime komisionin dhe studentin. Brenda 3 ditëve Dekani merr vendim nëse ankesa është e drejtë ose jo. Nëse ankesa pranohet, rezultati i mëparshëm shpallet i pavlefshëm dhe studenti jep përsëri provimin me të njëjtin komision ose një komision të ri, nën monitorimin e përfaqësuesit të caktuar nga Dekani, brenda sezonit të provimeve ose jo më vonë se 5 ditë pas përfundimit të sezonit.</p> <p><i>Gjatë diskutimeve me studentët, u konstatua se ata ishin të njohur me të gjithë procedurën e ankimit sipas rregullores së programit dhe departamentit. Sipas të dhënave të raportuara, gjatë viteve akademike nuk janë paraqitur ankesa nga studentët lidhur me procesin e vlerësimit apo me shkelje të mundshme të procedurave gjatë provimeve.</i></p> <p>Vizita në institucion</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>UART garanton një proces vlerësimi të drejtë, transparent dhe të standardizuar, i cili bazohet në meritën individuale të çdo studenti dhe siguron trajtim të barabartë për të gjithë. Institucioni ka vendosur mekanizma efektivë për shqyrtimin dhe trajtimin e ankesave, duke siguruar kështu drejtësi procedurale dhe integritet akademik. Përmes monitorimit të vazhdueshëm, trajnimit të stafit akademik dhe përmirësimit të rregulloreve për vlerësimin, UART synon të mbajë standarde të larta cilësie në procesin arsimor dhe të krijojë një ambient të besueshëm dhe motivues për studentët.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi III.4


Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>Programi i Studimit Bachelor në Koreografi synon të thellojë njohuritë artistike dhe teorike të studentëve, duke zhvilluar aftësitë profesionale dhe praktike në fushën e koreografisë si art skenik. Ai përgatit studentët për punësim në nivele të ndryshme profesionalizmi në koreografinë e operës, spektakleve skenike dhe televizive, si dhe i trajnon për kërkim të pavarur artistik, shkencor dhe kritik koreografik.</p> <p><i>Gjatë vizitës në institucion, GVJ inspektoi laboratorët që shërbejnë për zhvillimin e lëndëve praktike dhe profesionale të programit. Në programin e Koreografisë, një nga faktorët kyç që ndihmon në</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>përgatitjen e studentëve për tregun e punës dhe kërkesat profesionale është infrastruktura e specializuar. Megjithëse për zhvillimin e lëndëve praktike departamenti dispononte dy hapësira funksionale, nga diskutimet me studentët u identifikua nevoja për përmirësimin e sallave të dedikuara për këto lëndë. GVJ sugjeron përmirësimin e kushteve të infrastrukturës, pasi ky aspekt është thelbësor për ofrimin e një eksperience të plotë mësimore dhe për realizimin e suksesshëm të praktikës profesionale.</p> <p>Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</p>	<p>Në kuadër të lëndëve me zgjedhje, ofrohet lënda "Aftësim dhe Informacion" që i fut studentët në botën e informacionit elektronik, dhe ata mund të zgjedhin ta ndjekin këtë lëndë në vitin e parë, të dytë ose të tretë.</p> <p>Sa i përket aftësive humane, sociale, të komunikimit dhe ndërveprimit, vetë specifika e programit dhe forma e vlerësimit (provimi, shfaqja) ndihmojnë në zhvillimin e këtyre aftësive, duke nxitur tek studentët mendimin kritik dhe përgjegjësinë shoqërore.</p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton student, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lëndë, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>GVJ vlerëson pozitivisht përpjekjet për kontrollin e vazhdueshëm të kompetencave dhe aftësive të studentëve, të realizuar përmes formave të ndryshme të vlerësimit gjatë vitit akademik, përfshirë provimet dhe mbrojtjen e diplomave. Gjatë vizitës në institucion, studentët shprehën vlerësime pozitive për cilësinë e programit të Koreografisë dhe për procesin mësimor në tërësi. Mësimdhënia bazohet në një qasje të balancuar midis njohurive teorike dhe atyre praktike, duke përfshirë punën individuale dhe atë në grup.</p> <p>Vizita në institucion</p>
<p>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuar kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të</p>	<p>Ky program studimi zhvillon tek studentët kompetenca të përgjithshme, të transferueshme në art dhe edukim artistik, të nevojshme për punë krijuese dhe performancë efektive. Praktika profesionale mundëson përdorimin e këtyre kompetencave në institucione arsimore, kulturore dhe artistike, sipas marrëveshjeve. Puna në grupe bashkëpunuese, brenda dhe jashtë institucionit, ndihmon zhvillimin e aftësive intelektuale (arsyetim, zgjidhje problemi) dhe aftësive ndërpersonale (komunikim, bashkëbisedim, përgjegjësi sociale). Pedagogët krijojnë mjedis për zhvillim të ideve inovative dhe artistike, duke inkurajuar studentët të realizojnë projekte dhe të bashkëpunojnë me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare.</p>




mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	
<p>Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>Personeli akademik i FAS, me kontratë dhe aktiv, organizon vazhdimisht shfaqje, premiera, biseda dhe bashkëpunime me trupa vendase dhe të huaja. Kjo sjell një diversitet programesh, stileve dhe epokash të ndryshme artistike. Këto veprimtari jashtë programit të studimit janë të pasura dhe shërbejnë si një mënyrë efektive për studentët dhe artistët e tjerë për të prezantuar zhvillimet dhe arritjet më të fundit në fushën e Koreografisë dhe artit në përgjithësi.</p> <p><i>Pavaresisht kësaj, institucioni është duke u angazhuar me organizimin e konferencës ndërkombëtare shkencore, që është planifikuar në muajin qershor.</i></p> <p><i>Konferenca ndërkombëtare që do të zhvillohet në muajin qershor nga UART përbën një mundësi të shkëlqyer për Universitetin e Arteve (UART) për të forcuar pozitën e tij në fushën e kërkimit artistik dhe shkencor. Kjo ngjarje ka potencialin të shërbejë si një urë e rëndësishme për përfshirjen e stafit akademik në një rrugëtim më të thelluar drejt zhvillimit të kërkimit, duke nxitur dialog dhe bashkëpunim ndërkombëtar në fushat e arteve dhe shkencës. Konferenca do të ofrojë mundësi për të ndarë përvoja dhe për të krijuar rrjete profesionale me individë dhe institucione ndërkombëtare. Ky shkëmbim mund të sjellë mundësi për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta si punëtori, projekte kërkimore, dhe organizimin e aktiviteteve artistike që mund të kontribuojnë në rritjen e pranisë ndërkombëtare të UART.</i></p> <p>Duke pasur parasysh që ky program ka në bazë fushën profesionale të studimit dhe kërkimin artistik, stafi pedagogjik ka realizuar gjatë vitit akademik 2023–2024 një sërë veprimtarish artistike të ndryshme, të cilat dëshmojnë angazhimin aktiv në praktikën skenike dhe kontribuojnë drejtpërdrejt në përmbushjen e objektivave të programit të studimit. Këto veprimtari përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Pjesëmarrje në festivale kombëtare dhe ndërkombëtare, si Skampa International Theatre Festival dhe Albanian Dance Competition, në cilësinë e koreografëve apo drejtuesve artistikë; • Realizimi i veprave koreografike origjinale, si <i>Hapësira ndërmjet vetes dhe të tjerëve</i>, <i>Prespektivë e trefishtë</i>, dhe <i>Copëza emocioni</i>, të cilat janë prezantuar në skena të ndryshme si në Shqipëri ashtu edhe jashtë saj; • Bashkëpunime me institucione ndërkombëtare, si Xcel International Dance (Atlanta, SHBA) dhe Shkolla Superiore në Sevilje; • Organizimi dhe drejtimi i punëtorive praktike (Workshop) dhe projekteve artistike në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës dhe Bashkinë e Vlorës; • Kontribut në evente artistike televizive dhe kulturore, përfshirë spektaklet <i>Dancing ëith the Stars</i>, <i>Portokalli</i>, <i>Në të Klipit Shqiptar</i> dhe koncerte të artistëve të njohur si Elvana Gjata në Shqipëri dhe në Gjermani.
	<p>1.30 <i>Aktivitetet e realizuara në institucionet partnere tre vitet e fundit</i></p> <p>3.3 <i>Aktivitete të workshopeve masterklaseve</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Gjatë vizitës në institucion, GJVJ inspektoi laboratorët që shërbejnë për zhvillimin e lëndëve praktike dhe profesionale të programit. Në</i></p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





	<p>programin e Koreografisë, një nga faktorët kyç që ndihmon në përgatitjen e studentëve për tregun e punës dhe kërkesat profesionale është infrastruktura e specializuar. Megjithëse për zhvillimin e lëndëve praktike departamenti dispononte dy hapësira funksionale, nga diskutimet me studentët u identifikua nevoja për përmirësimin e sallave të dedikuara për këto lëndë. GVJ sugjeron përmirësimin e kushteve të infrastrukturës, pasi ky aspekt është thelbësor për ofrimin e një eksperience të plotë mësimore dhe për realizimin e suksesshëm të praktikës profesionale.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.</p>	<p>UART/FAS dhe Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë kanë status të veçantë për shkak të kërkesave dhe mënyrës krejtësisht të ndryshme të zhvillimit të lëndëve profesionale, si në auditor ashtu edhe jashtë tij. Për këtë arsye, kriteri i përmendur më lart nuk mund të aplikohet për këtë program studimi.</p> <p>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO http://ëëë.uart.edu.al/index.php?pg=fqage&id=208&niveli=76</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në Universitetin e Arteve (UART), studentët marrin informacion dhe udhëzime nga sekretaritet e fakulteteve dhe Sektori i Studentëve, që i orienton për detyrimet akademike. Informimi bëhet përmes faqes zyrtare dhe komunikimit me pedagogët. Mbrojtja e diplomës përfshin një projekt artistik dhe një punim teorik, të cilat kërkojnë miratimin e udhëheqësit dhe përmbushjen e të gjitha detyrimeve. Temat e diplomës njoftohen në fillim të vitit të fundit. UART ofron një manual studentor, që përmban informacion mbi të drejtat, detyrimet, përdorimin e krediteve, transferimet, frekuentimin, ndërrimin apo pezullimin e programit të studimit dhe rregullat për përmirësimin e notave.</p> <p>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Përgatitja dhe paraqitja e punimit/programit të diplomës në FAS bëhet sipas rregullave të përcaktuara në "Rregulloren e veprimtarisë së përgjithshme dhe asaj mësimore të FAS" dhe në rregulloren e departamentit.</p> <p>Punimi i diplomës është një punë e pavarur dhe krijuese e studentit në formën e një programi artistik në fushën e Koreografisë. Ai përmban detyra dhe kërkesa që i lejojnë studentit të tregojë aftësitë profesionale dhe artistike të fituara gjatë studimeve dhe të demonstrojë kompetencën për realizime artistike në fushën përkatëse.</p>

	<p>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Diploma përfaqëson fazën përfundimtare të formimit artistik dhe akademik të studentit. Pedagogu udhëheqës, njëkohësisht mësues i lëndës speciale, bashkëpunon me studentin për të përcaktuar temën, strukturën dhe afatet e punës. Konsultimet zhvillohen gjatë vitit akademik përmes takimeve individuale. Pedagogu vlerëson progresin, përkushtimin dhe nivelin artistik të studentit dhe merr vendimin për paraqitjen e punës përpara komisionit. Në rast mosmarrëveshjeje, studenti ka të drejtë ankimi sipas rregulloreve të Fakultetit dhe Departamentit. Programi i diplomës miratohet nga pedagogu dhe pasohet nga një grafik konsultimesh të detyrueshme deri në mbrojtjen përfundimtare.</p> <p>6.5_Foto nga procesi i mesimdhënieve ne auditor,provim,diploma.</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë në FAS organizon dhe mbështet veprimtaritë e studentëve, duke përdorur burimet materiale dhe financiare në dispozicion. Ndryshe nga institucionet shkencore, ku kryhen matje dhe analiza të ndryshme, në UART/FAS, për shkak të natyrës artistike dhe kërkimore, fokusi është në mbështetjen e projekteve artistike individuale të studentëve.</p> <p><i>Kërkimi artistik në fushën e koreografisë është një proces krijues dhe reflektues që synon të gjenerojë njohuri të reja, të zhvillojë praktika inovative dhe të zgjerojë kufijtë e shprehjes trupore në koreografi. Ai përfshin ndërthurjen e praktikës koreografike me eksplorimin teorik. Në kontekstin e kërkimit artistik, koreografia nuk trajtohet thjesht si një teknikë për ndërtimin e lëvizjes, por si një metodologji për të reflektuar mbi përvojën njerëzore, politikën e trupit, hapësirën dhe kohën. Kjo qasje vendos në qendër të vëmendjes procesin e krijimit si formë prodhimi njohurie, që flet me gjuhën e trupit dhe ndjeshmërinë artistike. Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, vërehet se në tre vitet e fundit nuk ka pasur aktivizim të studentëve në aktivitete shkencore brenda njësisë, përkatësisht:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Punime shkencore individuale të pedagogëve: 0 • Projekte shkencore në nivel departamenti: 0 • Projekte shkencore në nivel fakulteti: 0 • Projekte shkencore në bashkëpunim me institucione të tjera: 0 <p><i>Në këtë kontekst, rekomandohet që të stimulohet ndërveprimi i studentëve në projekte shkencore. Kjo do të ndikonte pozitivisht në cilësinë dhe dinamikën e procesit mësimor, duke forcuar angazhimin e studentëve dhe duke kontribuar në zhvillimin e tyre akademik dhe profesional.</i></p> <p><i>Gjithashtu, sipas dokumentacionit dhe bazuar në diskutimet me stafin dhe studentët, rezulton se asnjë student nuk ka zhvilluar mobilitet akademik deri më tani. Në rastet kur është realizuar mobiliteti, institucioni ka pasur rol pritës, siç është rasti i studentit nga ESAD Sevilla në kuadër të projekteve Erasmus.</i></p> <p><i>Duke marrë parasysh këtë situatë, rekomandohet që institucioni dhe departamenti të intensifikojnë përpjekjet për promovimin dhe lehtësimin e mobilitetit studentor, në mënyrë që të rritet përvoja</i></p>




	<p><i>ndërkombëtare e studentëve dhe të përmirësohet cilësia e procesit mësimor.</i></p> <p><i>Te dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar të Fakultetit (Tabela 20)</i></p> <p><i>. Aktivizimi i studentëve në aktivitetet e njësisë, në tre vitet e fundit (Tabela 22)</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>Në përfundim të procesit të provimit të diplomës, Kryetari i Komisionit mbledh anëtarët e komisionit për vlerësimin e punimit të diplomantit. Çdo anëtar i komisionit bën vlerësimin për secilin diplomant duke e nënshkruar atë. Pasi bëhet mesatarizimi i vlerësimit që ka dhënë secili anëtar i komisionit, komisioni i komunikon çdo diplomanti notën me të cilën është vlerësuar. Vlerësimi i anëtarëve të komisionit dokumentohet dhe i bashkëngjitet procesverbalit të mbrojtjes së diplomave, në të cilin regjistrohet nota përfundimtare. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative në mbrojtjen e diplomës ose nuk paraqitet për mbrojtjen e diplomës në sezonin e parë pas përfundimit të studimeve, ai mund të mbrojë punimin e diplomës në tre sezonet pasardhëse.</p> <p><i>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</i></p> <p><i>5.15_Rregullorja e Sektorit Mësimor UART.</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, studenti që ka plotësuar të gjitha kërkesat e Planit mësimor dhe ka mbrojtur diplomën, pajiset me diplomën përkatëse, të shoqëruar me suplementin e diplomës. Diploma plotësohet në zbatim të Udhëzimit nr. 25, datë 10.11.2017 "Për regjistrimin e formave të diplomave dhe certifikatave në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor".</p> <p><i>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</i></p> <p><i>5.15_Rregullorja e Sektorit Mësimor UART.</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Në Universitetin e Arteve (UART), informacioni i veprimtarisë akademike për Fakultetin e Arteve Skenike (FAS) ruhet në dy forma: kopje fizike dhe elektronike. Dokumentacioni akademik, duke përfshirë programet dhe planet mësimore me kreditë përkatëse, përpunohet dhe menaxhohet sipas legjislacionit dhe rregulloreve të institucionit. Ruajtja fizike e dokumenteve kryhet nga Arkivi-Protokolli qendror i UART, përgjegjës për dokumentacionin dhe korrespondencën institucionale.</p> <p>Në nivel elektronik, informacioni arkivohet në një server qendror dhe ruhet gjithashtu në CD dhe DVD, sipas udhëzimeve të përdorimit të teknologjisë së informacionit në institucion.</p> <p><i>1.17_RREGULLORE E VEPRIMTARISE SE PERGJITHSHME E DEP. SKENO_KOREO</i></p> <p><i>5.15_Rregullorja e Sektorit Mësimor UART.</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Rekomandohet që institucioni të stimulojë në mënyrë të vazhdueshme përfshirjen e studentëve në projekte kërkimore dhe zhvillimore, me qëllim rritjen e cilësisë dhe dinamikës së procesit mësimor. Kjo do të</i></p>




	<i>forcojë angazhimin akademik të studentëve dhe do të kontribuojë në zhvillimin e tyre profesional dhe shkencor. Gjithashtu, rekomandohet që institucioni dhe departamenti përkatës të intensifikojnë përpjekjet për promovimin, nxitjen dhe lehtësimin e mobilitetit ndërkombëtar të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1

Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Gjatë vizitës së zhvilluar nga GVJ dhe sipas raportit përkatës, u konstatua se stafi akademik i angazhuar në procesin e mësimdhënies në programin “Bachelor në Koreografi” i përmbahet kërkesave të Ligjit nr. 80/2015 dhe akteve nënligjore: VKM nr. 29, datë 10.09.2018; VKM nr. 329, datë 12.04.2017; VKM nr. 145, datë 10.03.2021, si dhe Kodit të Punës.</p> <p>Në raport theksohet gjithashtu se, për shkak të natyrës së veçantë të programit, departamenti vlerëson përvojën artistike dhe shkencore të stafit në përputhje me lëndët që mbulojnë. Pedagogët e lëndëve kryesore “Koreografi” kanë një karrierë të konsoliduar në artin skenik. Pjesa më e madhe e stafit është alumni i FAS/UART, me përvojë të spikatur dhe të rikthyer në auditore si kontribuues në formimin profesional të studentëve.</p> <p>Struktura e stafit akademik të Departamentit të Skenografisë dhe Kostumografisë (S&K): Nga tabela e dhënë për stafin akademik të programit “Koreografi”, për vitin akademik 2024–2025, rezulton si më poshtë: Numri total i pedagogëve: <ul style="list-style-type: none"> • Gjithsej pedagogë: 17 <ul style="list-style-type: none"> ○ Personel Akademik Efektiv (PAE): 11 65% ○ Personel Akademik me Kontratë (PAK): 35% Numri i pedagogëve sipas titujve: <ul style="list-style-type: none"> • Prof. Dr. – i • Prof. – 1 • Prof. Asoc. Dr. – 2 • Prof. Asoc. – 4 • As. Lektor – 9 </p>

Kjo strukturë tregon një kombinim të balancuar midis stafit të përhershëm dhe atij me kontratë, dhe përfaqësim të mirë në nivele të ndryshme akademike, duke krijuar bazën për ofrimin e një programi të besueshëm dhe të mbështetur akademikisht.

Viti akademik 2023–2024

- Totali: 24 pedagogë
 - PAE: 11 – 45.8%
 - PAK: 13 – 54.2 %

Viti akademik 2022–2023

- Totali: 20 pedagogë
 - PAE: 11 - 55%
 - PAK: 9 – 45%

Duke analizuar të dhënat e tre viteve të fundit mbi përbërjen e stafit akademik në programin e studimit “Koreografi”, vërehet se Universiteti i Arteve ka ruajtur një numër të qëndrueshëm të personelit akademik efektiv (PAE), ndërkohë që raporti ndërmjet stafit PAE dhe PAK nuk ka qenë në përputhje të plotë me kërkesën standarde prej 70% PAE dhe 30% PAK.

Për vitin akademik 2024–2025, raporti PAE është 65%, shumë pranë standardit të kërkuar, çka tregon një përmirësim të ndjeshëm krahasuar me vitet e mëparshme. Në vitin 2023–2024, përqindja e PAE ishte 45.8%, dhe në vitin 2022–2023 – 55%. Ky progres tregon se institucioni është i angazhuar drejt forcimit të bazës së vet akademike me staf të përhershëm.

Viti akademik 2022–2023

- Totali: 16 pedagogë
 - PAE: 11
 - PAK: 5

Viti akademik 2023–2024

- Totali: 21 pedagogë
 - PAE: 11
 - PAK: 10

Viti akademik 2024–2025

- Totali: 16 pedagogë
 - PAE: 11
 - PAK: 5

Numri i stafit sipas titujve:

PAE

3 Prof/As /Dr

1 Prof /As

1 Dr

1 Doc/Dr

1 Doc


4 As/ Lector

PAK

1 Prof/As/Dr

4 As/Lektor

	<p>Struktura e titujve akademikë është gjithashtu e larmishme dhe përfshin grada të ndryshme që kontribuojnë në cilësinë dhe besueshmërinë e programit. Megjithatë, për të përmbushur plotësisht kërkesat standarde të personelit akademik, sugjerohet që universiteti të vijojë me politika të konsolidimit të stafit efektiv, në mënyrë që raporti PAE të arrijë nivelin e kërkuar prej 70%.</p> <p>Ky drejtim do të garantonte më tej stabilitetin institucional dhe rritjen e cilësisë në ofrimin e programit në “Koreografi”.</p> <p>Raporti i Vlerësimit të Brendshëm i programit të studimit Bachelor në Koreografi Tabelat 2 Departamenti i Skenografi - Kostumografi dhe Koreografi.</p>																				
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>Gjithashtu nga tabela 4 rezulton që ngarkesa mësimore për PAE në disa raste shkon deri 405 orë mësimore, çfarë mund të rishikohet në një balancim më të mirë të ngarkesës mesimore të personelit të angazhuar me këtë program studimi.</p> <p>Në lidhje me planin mësimor të lidhur me personelin akademik përkatës me ngarkesën mësimore (orë), të dhënat vijnë si:</p> <table border="1" data-bbox="627 887 1445 1191"> <thead> <tr> <th>Viti</th> <th>Total orësh</th> <th>PAE</th> <th>PAK</th> <th>PAE/PAK (%)</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>2360</td> <td>2030</td> <td>330</td> <td>86% / 14%</td> </tr> <tr> <td>2023-2024</td> <td>2390</td> <td>1790</td> <td>600</td> <td>75% / 25%</td> </tr> <tr> <td>2024-2025</td> <td>2300</td> <td>1850</td> <td>450</td> <td>80% / 20%</td> </tr> </tbody> </table> <p>Programi i studimit “Koreografi” në UART paraqet një strukturë të qëndrueshme të mbulimit të ngarkesës mësimore nga stafi akademik me marrëdhënie të qëndrueshme pune (PAE), me përqindje që varion nga 82.11% në 84.71% përgjatë tre viteve të fundit, duke tejkaluar kërkesën minimale ligjore prej 70%. Pjesëmarrja e stafit me kontratë të përkohshme (PAK) mbetet në kufijtë 15–18%, duke mundësuar përfshirjen e ekspertizës specifike nga fusha praktike. Kjo shpërndarje reflekton përputhshmëri të plotë me kuadrin ligjor dhe angazhim për cilësi të lartë në procesin mësimor.</p> <p>Referenca RVB / Tabela 12.1; 12.2; 12.3</p>	Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)	2022-2023	2360	2030	330	86% / 14%	2023-2024	2390	1790	600	75% / 25%	2024-2025	2300	1850	450	80% / 20%
Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)																	
2022-2023	2360	2030	330	86% / 14%																	
2023-2024	2390	1790	600	75% / 25%																	
2024-2025	2300	1850	450	80% / 20%																	
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me</p>	<p>Referuar RVB-së dhe gjithashtu vizitës në institucion, GVJ konstatoi qëndrueshmëri të personelit akademik efektiv të angazhuar në programin Bachelor në “Koreografi”. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Koreografi” ka nënshkruar kontratat me UA sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi. Gjithashtu, edhe stafi akademik me kontratë, për vetë specifikën e këtij programi, përtej zbatimit të kontratave për staf akademik me kohë të pjesshme, i kushtohet vëmendje për të pasur një bashkëpunim sa më të gjatë. Duke</p>																				




<p>sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>qenë se është një entitet shtetëror, UART është i detyruar të paguajë dhe të deklarojë kërkesat ligjore.</p> <p>Referenca Evidenca 4.1 “Koha e fillimit të bashkëpunimit me personelin” Evidenca 4.2 “Kontratat e punës së stafit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme” Evidenca 4.3 “Listë-pagesat e detyrimeve të stafit akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme”</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Pas takimit në institucion, GVJ u njoh me procedurat e ndjekura për punësimin e stafit akademik në Universitetin e Arteve, të cilat zhvillohen nëpërmjet konkursit të hapur dhe transparent, siç përcaktohet në Nenin 92 të Rregullores së Brendshme. Nevojat për staf lindin në nivel departamenti dhe kriteret shtesë miratohen nga Rektori. Për programin “Koreografi”, vlerësohet edhe veprimtaria artistike e kandidatëve. Rektori miraton listën vjetore të stafit me kohë të përkohshme, bazuar në propozimet e departamenteve dhe planet mësimore. Në bazë të VKM nr. 145, UART ka të drejtë të ftojë artistë dhe studiues vendas apo të huaj për angazhime afatshkurtra akademike dhe kërkimore.</p> <p>Referanca: RVB Takimi ne Institucion 4.4 Dosja e praktikave të punësimit</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ u njoh me strukturën organizative të Universitetit të Arteve, përfshirë funksionimin e njësive ndihmëse akademike dhe administrative që mbështesin procesin mësimor dhe veprimtaritë kërkimore e artistike. Këto njësi kontribuojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin e praktikave, menaxhimin e pajisjeve laboratorike dhe mbështetjen e diplomave. Institucioni ruan dhe përditëson çdo vit të dhënat për personelin akademik, ndihmës dhe administrativ, në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale. Gjithashtu, bashkëpunimi me institucione të tjera dhe aktorë të tregut siguron mbështetje të mjaftueshme për komponentët praktikë të programeve të studimit.</p> <p>Referenca: RVB Evidenca 4.5 – Lista e stafit ndihmës akademik në Departamentin S&K</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit</p>	<p>Në bazë të dokumentacionit të paraqitur dhe vizitës në institucion, GVJ vëren se jo të gjitha dosjet e stafit pedagogjik, të përhershëm dhe të jashtëm, janë të përditësuara dhe të kompletuara me dokumentacionin përkatës. Vërehet gjithashtu se CV-të e disa anëtarëve të stafit nuk pasqyrojnë në mënyrë të plotë aktivitetet e tyre artistike dhe kërkimore.</p> <p>Për këtë arsye, GVJ sygjeron që njësia përgjegjëse dhe departamenti përkatës të marrin masat e nevojshme për përditësimin e CV-ve të stafit akademik dhe plotësimin e dosjeve individuale për çdo pedagog.</p>

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafan», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al




<p>akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>Referenca: Shënime nga Vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për këtë kriter, GVJ u njoh gjatë vizitës në institucion me mënyrën se si praktika profesionale është e integruar në programin e studimit “Koreografi” dhe me rëndësinë që i jepet këtij komponenti formues. Praktika përbën një element thelbësor dhe të pandarë të procesit mësimor, duke u konceptuar jo thjesht si një fazë aplikative, por si një hap i domosdoshëm drejt formimit të plotë artistik dhe profesional të studentëve. Ajo mundëson ndërthurjen e natyrshme të njohurive teorike me përvojën konkrete në skenë, duke zhvilluar kompetenca krijuese dhe performuese në mjedise reale artistike.</p> <p>Ky organizim i kujdesshëm i praktikave, i mbështetur nga stafi akademik me kohë të plotë dhe rrjeti i partnerëve institucionalë, u vlerësua si një prej pikave të forta të programit, që i jep atij autenticitet dhe vlerë të shtuar në përgatitjen e studentëve për tregun e punës në fushën e arteve performative.</p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Praktikat profesionale organizohen dhe mbikëqyren nga stafi akademik i Departamentit të Skenografisë dhe Koreografisë.</p> <p>Këto praktika realizohen si në ambientet e brendshme të Fakultetit të Artit Skenik (FAS), ashtu edhe në institucione të rëndësishme artistike të vendit si Teatri Kombëtar i Operës dhe Baletit, Teatri Eksperimental, Teatri Skampa Elbasan, Teatri “Bylis” Fier, Ansambli i Këngëve dhe Valleve Popullore dhe Shkolla Kombëtare Koreografike.</p> <p>Pedagogë si E. N., Gj. P., A. I. dhe K. B. janë aktivisht të përfshirë në udhëheqjen e këtyre praktikave, duke ofruar mbështetje profesionale, vlerësim të progresit dhe orientim në përputhje me qëllimet e programit.</p> <p>Një pjesë e marrëveshjeve me institucionet partnere është realizuar në kuadër të iniciativës “Pakti për Universitetin”, duke ofruar mundësi për studentët që të përfitojnë nga eksperiencia dhe udhëzimet e artistëve profesionistë. Ky bashkëpunim ndërinstitutional promovon shkëmbimin e përvojave dhe harmonizimin e praktikave, duke përforcuar strategjinë e departamentit dhe stafit pedagogjik për të garantuar një program studimi të integruar dhe me cilësi të lartë.</p>
	<p>Referenca: – <i>Shënime nga vizita në institucion</i> – <i>Evidenca 2.1 “Plani Mësimor Bachelor në Koreografi”</i> – <i>Evidenca 3.11 “Pasqyrat e Ngarkesave të Departamentit”</i></p>





Konkluzione	Në përfundim të analizës dhe vizitës në institucion, GVJ vlerëson se programi "Bachelor në Koreografi" në Universitetin e Arteve paraqet një strukturë funksionale dhe në përputhje me kërkesat ligjore. Raporti i PAE-ve ka shënuar rritje të vazhdueshme, duke arritur në 65% për vitin aktual, shumë pranë standardit të kërkuar prej 70%, ndërsa mbulimi i ngarkesës mësimore nga stafi i përhershëm tejkalon 80%. Praktikant profesional, të organizuara në bashkëpunim me institucionet kryesore artistike të vendit dhe të mbikëqyrura nga stafi me kohë të plotë, përbëjnë një pikë të fortë të programit, duke siguruar përgatitje cilësore dhe të lidhur me realitetin artistik. GVJ sugjeron që institucioni të vijojë me konsolidimin e stafit efektiv, përditësimin e dokumentacionit dhe forcimin e bashkëpunimit me tregun e punës dhe partnerët artistikë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës në Universitetin e Arteve, u vërejt se institucioni disponon një infrastrukturë të dedikuar për zhvillimin e proceseve mësimore dhe veprimtarive artistike, e cila mbështet ndjeshëm cilësinë e mësimdhënies, veçanërisht në programet me natyrë skenike. Hapësirat si salla "BlackBox" (me dy ambiente të pajisura për performanca teatrore), Galeria, Lektoriumi "Tonin Harapi" dhe Salla e Madhe e Koncerteve me 600 vende ofrojnë kushte të mira për zhvillimin e leksioneve dhe prezantimeve artistike.</p> <p>Në lidhje me programin e studimit "Koreografi", hapësirat e vëna në dispozicion janë të bollshme dhe krijojnë mundësi të përshtatshme për punën praktike të studentëve. Megjithatë, u evidentua se këto ambiente kanë nevojë për mirëmbajtje të vazhdueshme dhe përditësim të pajisjeve teknike, në mënyrë që të garantojnë një përvojë të qëndrueshme mësimore dhe artistike, në përputhje me natyrën dinamike të këtij programi.</p> <p>Referenca: – RVB – Takimi në institucion – Evidenca 4.8 – "Dosja e infrastrukturës së FAS dhe ambienteve të përbashkëta"</p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ u njoh me mjediset që shërbejnë për zhvillimin e programit të studimit në Koreografi. Disa nga auditorët janë të pajisur me teknologji të informacionit të përshtatshme për lëndët teorike, ndërsa për lëndët praktike, që përbëjnë thelbin e këtij programi, përdoren ambiente të posaçme që marrin parasysh natyrën skenike dhe fizike të disiplinës.</p>

<p>procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Megjithatë, GVJ vlerëson se, ndonëse këto ambiente janë në funksion të procesit mësimor dhe aktiviteteve artistike, ato kërkojnë investime të mëtejshme për mirëmbajtje dhe përmirësim, në mënyrë që të përmbushin më mirë nevojat specifike të zhvillimit praktik të lëndëve të koreografisë. Përmirësimi i infrastrukturës do të ndikonte pozitivisht në cilësinë e formimit profesional të studentëve dhe në realizimin e një procesi mësimor më të plotë dhe bashkëkohor.</p> <p>Referanca: Takimi ne Institucion Evidences 4.8 Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve të përbashkëta Evidenca 4.9 Lista e pajisjeve në shërbim të S&K</p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Për programin e studimit në Koreografi, GVJ u njoh gjatë vizitës me ambientet dhe mjetet që janë vënë në dispozicion për realizimin e komponentëve teorikë dhe praktikë të formimit artistik. Studiot e Fakultetit të Artit Skenik ofrojnë hapësira të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve të lëvizjes dhe interpretimit skenik, që përbëjnë bërthamën e programit në Koreografi. Në këto ambiente zhvillohen ushtrimet praktike, provat skenike dhe orët e teknikës së vallëzimit, duke u përshtatur në mënyrë të natyrshme me nevojat e veçanta të këtij profili.</p> <p>Megjithatë, duke pasur parasysh karakterin fizik, vizual dhe dinamik të këtij programi, GVJ vlerëson se mjediset aktuale, ndonëse funksionale, kanë nevojë për përmirësime të vazhdueshme dhe investime të reja në pajisje ndihmëse dhe teknologji moderne. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për të ruajtur ritmin me zhvillimet bashkëkohore të praktikës koreografike dhe për të garantuar një përvojë formuese sa më cilësore për studentët.</p> <p>Referanca: Takimi ne Institucion Evidences 4.8 Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve të përbashkëta</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me faktin se Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë përfiton nga përdorimi i ambienteve të Bibliotekës Shkencore të UART-it, e cila është e pajisur me kompjuterë dhe programe bazë të teknologjisë së informacionit. Këto mjete janë të dobishme kryesisht për funksione të përgjithshme, si përgatitja e dokumenteve apo zhvillimi i njohurive bazike në fushën e TI.</p> <p>Megjithatë, për shkak të natyrës specifike dhe praktike të programit të studimit në Koreografi, këto pajisje nuk e mbulojnë tërësisht nevojën për teknologji të avancuar që lidhen drejtpërdrejt me objektivat formues të programit, si softuerë për analizën e lëvizjes apo aplikacione për zhvillimin e komponentëve skenikë dhe vizualë. Në këtë kontekst, nevojitet një qasje më e specializuar në pajisjen teknologjike që do të mbështeste më mirë komponentët praktikë të programit.</p>




	Referanca: <i>Takimi ne Institucion</i> <i>Evidences 4.8 Dosja e infrastrukturës FAS dhe ambienteve të përbashkëta</i>			
Konkluzione	<i>Bazuar në vëzhgimet gjatë vizitës dhe dokumentacionin e shqyrtuar, GVJ vlerëson se Universiteti i Arteve ofron ambiente të dedikuara dhe të përshtatshme për zhvillimin e programit në Koreografi, duke përfshirë salla të specializuara për lëndët praktike dhe pajisje për komponentët teorikë. Këto ambiente krijojnë një bazë funksionale për realizimin e programit, por për shkak të natyrës dinamike dhe praktike të kësaj fushe, mbetet e nevojshme mirëmbajtja e vazhdueshme dhe investimi në pajisje teknologjike më të specializuara. Kjo do të siguronte kushte më bashkëkohore për zhvillimin e plotë të komponentëve praktikë dhe përmirësimin e përvojës mësimore të studentëve në këtë drejtim.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Në shqyrtimin e dokumentacionit të dorëzuar nga Universiteti i Arteve për programin e studimit në “Koreografi”, si dhe në analizën e katalogut online të bibliotekës universitare, vërehet se janë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të vënë në dispozicion të studentëve literaturë të përshtatshme me natyrën e programit. Katalogu elektronik ofron akses në disa tituj të lidhur me koreografinë dhe fushat përkatëse, çka ndihmon në mbështetjen akademike të studentëve dhe tregon përpjekje për të siguruar burime të nevojshme në formë si fizike, ashtu edhe digjitale. Kjo është veçanërisht e rëndësishme duke marrë parasysh karakterin praktik të programit dhe nevojën për literaturë të specializuar në teknika të vallëzimit, teori të koreografisë dhe praktikë skenike.</p> <p>Megjithatë, fondi ekzistues i literaturës duket ende i kufizuar në përmbajtje dhe sasi, veçanërisht për sa i përket titujve më të rinj, në gjuhë të huaja dhe të përditësuar me zhvillimet bashkëkohore të fushës. Për më tepër, nga analiza e planit mësimor rezultoi se për disa lëndë literatura është përmendur, por mungon një ndarje më e detajuar sipas javëve të semestrit. Në këtë kuptim, do të ishte e dobishme që për çdo lëndë të hartohet një syllabus i strukturuar, ku të pasqyrohen qartë temat javore, objektivat mësimore dhe literatura përkatëse (bazë dhe ndihmëse).</p> <p>Këto përmirësime do të ndihmonin jo vetëm në lehtësimin e përvetësimit të njohurive nga ana e studentëve, duke garantuar cilësi</p>


Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>dhe organizim më të mirë në procesin mësimor. Në tërësi, vlerësohet se janë hedhur bazat për mbështetjen me literaturë të programit të “Koreografisë”, por ekziston hapësirë për përmirësim të mëtejshëm.</p> <p>Referenca: – RVB – Shënime nga vizita në institucion Evidenca 2.2 – “Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi” Evidenca 4.10 – “Lista e literaturës së Departamentit të Skenës dhe Koreografisë në Bibliotekën e UART” http://37.139.117.42:8800/cgi-bin/koha/opac-search.pl?idx=kw&q=Koreografia&offset=100</p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.</p>	<p>UART – tregon se institucioni ka hedhur hapa pozitivë për të siguruar literaturë të përshtatshme dhe të aksesueshme për studentët.</p> <p>Lista e literaturës përfshin tituj themelorë për fushën e koreografisë, si dhe materiale të dobishme për zhvillimin profesional dhe artistik të studentëve. Këto përpjekje reflektojnë vëmendjen e institucionit për të krijuar një bazë të mirë akademike dhe për të mbështetur përmbajtjen mësimore të programit. Megjithatë, për të reflektuar plotësisht kërkesat e këtij kriteri, do të ishte e dobishme që literatura të pasurohet më tej me botime të përditësuara të viteve të fundit, veçanërisht në gjuhë të huaja dhe në fusha që pasqyrojnë zhvillimet aktuale të koreografisë bashkëkohore.</p> <p>Përmes një procesi të vazhdueshëm të përmirësimit, UART ka mundësi të konsolidojë më tej këtë aspekt, duke forcuar mbështetjen akademike për studentët dhe duke rritur përputhjen me standardet e cilësisë në arsimin e lartë.</p> <p>Gjithashtu, në përputhje me natyrën praktike dhe vizuale të programit në Koreografi, sugjerohet që literatura ekzistuese të plotësohet me materiale audio-vizuale, si video trajnime, regjistrime të performancave, dokumentarë apo materiale didaktike që trajtojnë teknikat e vallëzimit dhe procesin krijues koreografik. Këto burime do të ofronin një mbështetje të vlefshme për përvetësimin e njohurive dhe aftësive praktike, duke e bërë përvojën mësimore më dinamike dhe të përshtatur me specifikat e këtij programi studimi.</p> <p>Referenca: – RVB – Shënime nga vizita në institucion Evidenca 2.2 – “Kurrikula e Programit të Studimit Bachelor në Koreografi” Evidenca 4.10 – “Lista e literaturës së Departamentit të Skenës dhe Koreografisë në Bibliotekën e UART” http://37.139.117.42:8800/cgi-bin/koha/opac-search.pl?idx=kw&q=Koreografia&offset=100</p>





<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës, GVJ u njoh me proceset, hapësirat dhe fondet e ndryshme të Bibliotekës së UART-it. Biblioteka ofron ambiente moderne me pajisje kompjuterike dhe akses në burime shkencore dhe artistike, duke siguruar mundësi të barabarta për studentët e programit Bachelor në Koreografi. Gjithashtu, janë prezantuar sistemet elektronike të menaxhimit dhe katalogimit të fondeve që mbështesin kërkimin dhe përdorimin efikas të literaturës.</p> <p>Referanca: Takimi ne Institucion RVB Evidenca 4.12 Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale</p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Universiteti i Arteve ka ndërmarrë hapa të vlerësueshëm për të pajisur bibliotekën me literaturë bazë dhe ndihmëse në mbështetje të programeve të studimit, përfshirë edhe programin në Koreografi. Literatura është e disponueshme si në format fizik ashtu edhe përmes katalogut online uart.edu.al/katalog_biblio, i cili përmban mbi 28,000 rekorde bibliografike. Po ashtu, arkiva digjitale e institucionit (arkiv.uart.edu.al) ofron mbi 5500 materiale në formate të ndryshme, përfshirë edhe video, audio dhe imazhe. Këto burime përbëjnë një bazë të dobishme për akses në literaturë dhe materiale referuese, duke përbushur pjesërisht kërkesat e specifikuara në standard. Megjithatë, duke marrë parasysh natyrën praktike dhe vizuale të programit të Koreografisë, është e nevojshme që fondi të pasurohet më tej me materiale audio-vizuale të specializuara dhe botime bashkëkohore në gjuhë të huaj. Kjo do të përmirësonte ndjeshëm përputhshmërinë e ofertës bibliotekare me nevojat mësimore të studentëve dhe do të sillte më shumë burime në funksion të zhvillimit artistik dhe profesional të tyre.</p> <p>Referanca: Takimi ne Institucion RVB WEB Evidenca 4.12 Lista e burimeve elektronike në të cilat ka akses UART në rrugë digjitale</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Ky kriter përmbushet nëpërmjet abonimeve që institucioni ka realizuar në bibliotekat digjitale. Të gjithë studentët dhe stafi akademik kanë akses në këto burime përmes bibliotekës online të UART. Këto platforma shërbejnë si një burim i rëndësishëm për përgatitjen e leksioneve, materialeve ndihmëse dhe për zhvillimin e aktivitetit kërkimor-shkencor.</p> <p>Referanca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=344&niveli=74</p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstaton që biblioteka është e pajisur me programe kompjuterike dhe teknologji të tjera, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët që e frekuentojnë atë.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423


E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion</p>			
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Në Universitetin e Arteve biblioteka qëndron e hapur prej orës 8:00 - 19:00. Gjatë takimit me studentët ata pohuan për GVJ se ishin të kënaqur me shërbimet e bibliotekës.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion</p>			
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Gjatë vizitës në ambientet e UART – Bibliotekës dhe shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ u njoh me mënyrën se si Biblioteka e Universitetit të Arteve bashkëpunon me njësitë bazë për përditësimin dhe pasurimin e fondit letrar. Ajo informon rregullisht departamentet mbi mundësitë dhe burimet në dispozicion, dhe në këtë kuadër, Departamenti i Skenografisë dhe Kostumografisë paraqet periodikisht kërkesa për literaturën e nevojshme për programin Bachelor në këtë fushë. Përveç kësaj, biblioteka dokumenton dhe raporton për fondin fizik ekzistues – përfshirë tituj librash, drama, revista dhe materiale të tjera – si dhe për përdorimin që i bëhet këtyre burimeve, si fizikisht ashtu edhe përmes aksesit online.</p> <p>Evidenca 4.10 “Lista e literaturës së S&K në Bibliotekën e UART”, Evidenca 4.12 “Lista e burimeve elektronike të aksesueshme në mënyrë digjitale”, Evidenca 4.15 “Statistika të aksesit të bibliotekës”</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Bazuar në shqyrtimin e dokumentacionit dhe të dhënave të ofruara nga Universiteti i Arteve, GVJ vlerëson se janë ndërmarrë hapa të vlerësueshëm për të mbështetur programin e studimit në Koreografi me literaturë të përshtatshme dhe burime bibliotekare të aksesueshme. Katalogu online i bibliotekës dhe informacionet e siguruara tregojnë për ekzistencën e materialeve bazë dhe ndihmëse që lidhen me fushën e koreografisë. Gjithashtu, janë vënë në dispozicion burime digjitale dhe një arkivë elektronike e pasur me materiale audio-vizuale, që shërbejnë si mbështetje për natyrën praktike të programit. Për të përmirësuar më tej mbështetjen akademike të studentëve, do të ishte e vlefshme të konsiderohej pasurimi i literaturës me botime më të reja, veçanërisht në gjuhë të huaj, si dhe përfshirja e më shumë materialeve audio-vizuale e trajnimeve praktike që lidhen me natyrën e fushës.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi IV.4




Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>Universiteti i Arteve disponon një sistem të dedikuar menaxhimi akademik në platformën elektronike “Pitagora”, e cila shërben si mjet kryesor për administrimin e të gjithë informacionit që lidhet me studentët dhe ciklin e tyre të studimeve. Ky sistem mbulon proceset që nga momenti i regjistrimit të studentëve, ndjekjen e përparimit të tyre akademik, administrimin e notave, lëndëve, përzgjedhjen e moduleve dhe deri në përfundimin e studimeve dhe diplomim. Çdo student pajiset me një llogari personale brenda sistemit, përmes së cilës ai/ajo mund të ketë akses të vazhdueshëm në të dhënat e veta akademike dhe administrative.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u informua nga vetë studentët se platforma funksionon në mënyrë të pandërprerë dhe është mjaft e qëndrueshme. Studentët shprehën se sistemi i plotëson në mënyrë të kënaqshme nevojat e tyre, duke mundësuar akses të lehtë në shërbime si pasqyrimi i notave, oraret, lënda e ngarkesës mësimore, si dhe informacione të tjera që lidhen me ecurinë e tyre akademike. Përdorimi i “Pitagora” ndihmon në rritjen e transparencës, lehtësimin e komunikimit midis studentëve dhe administratës akademike, si dhe në organizimin më efikas të të dhënave institucionale.</p> <p>Ky sistem përbën një komponent të rëndësishëm të infrastrukturës dixhitale të Universitetit të Arteve dhe është një shembull pozitiv i përfshirjes së teknologjisë në menaxhimin e arsimit të lartë.</p> <p>Referenca: – <i>RVB</i> – <i>Shënime nga vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p> <p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Çdo vit akademik, Departamenti, në përputhje me udhëzimet dhe aktet ligjore në fuqi, përgatit dokumentacionin mbi ngarkesën mësimore dhe angazhimet e stafit akademik, përfshirë edhe veprimtari artistike apo shkencore. Këto dokumente integrohen në sistemin e brendshëm të menaxhimit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore, së bashku me CV-të dhe materialet mbështetëse të stafit.</p> <p><i>Gjatë takimeve të zhvilluara me zyrën e burimeve njerëzore, GVJ vërejt se disa nga dosjet e stafit PAK paraqisnin mungesa në dokumentacionin përkatës.</i></p> <p>Informacioni për stafin dhe studentët ofrohet përmes sistemit PITAGORA, i cili mundëson akses në njoftime mbi provimet, notat, vërtetime dhe rezultate në kohë reale. Për më tepër, informacioni publikohet edhe në faqen zyrtare të universitetit.</p>

<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit "Pitagora" është i instaluar në platformën "Microsoft Office 365" dhe arrihet nëpërmjet adresës së dedikuar për çdo individ. Ai përmban module insertimi, leximi dhe editimi, të cilat mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Sistemi mundëson shkëmbim e materialeve didaktike, komunikim, realizimin e konsultimeve audio-vizuale online, përdorim të paketës office, akses në email-in universitar, etj.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidenca 4.19 Manuali Pitagora</p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Universiteti i Arteve përdor platformën "Pitagora" si sistem të menaxhimit akademik dhe administrativ, në përputhje me kërkesat e Kriterit 5. Ky sistem mundëson monitorim në kohë reale të aktivitetit të studentëve dhe stafit, si dhe raportime të menjëhershme për organet drejtuese. Përmes domenit zyrtar https://uart.pitagora.rash.al/login, informacionet paraqiten në rubrika të strukturuar dhe të aksesueshme. Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se sistemi funksionon në mënyrë të qëndrueshme dhe përdoret gjerësisht për administrimin e ciklit të plotë akademik, duke kontribuar në transparencë dhe vendimmarrje të informuar.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion - https://uart.pitagora.rash.al/login</p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Universiteti i Arteve ka domenin e tij në internet, platforma google, i cili arrihet në adresën</p> <p>http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=121&niveli=19.</p> <p>Në këtë adresë gjenden të gjitha informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në rang institucioni, njësisht kryesore, njësisht përgjegjëse, programesh studimi, partnerët strategjikë etj. GVJ e vizitoi këtë faqe dhe konstatoi plotësimin e kriterit.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion -https://uart.pitagora.rash.al/login -http://uart.edu.al/index.php</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Në përfundim të shqyrtimit të dokumentacionit dhe të evidencave të marra gjatë vizitës në institucion, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) vlerëson se Universiteti i Arteve ka ngritur dhe përdor në mënyrë funksionale sistemin e brendshëm të menaxhimit institucional "Pitagora". Ky sistem përmbush një rol të rëndësishëm në administrimin, informimin dhe monitorimin e aktivitetit akademik, financiar dhe administrativ në të gjithë institucionin. Platforma është e aksesueshme nga studentët, stafi dhe strukturat drejtuese dhe siguron</i></p>

	<p><i>një pasqyrë të qartë dhe në kohë reale të të dhënave të nevojshme për ndjekjen e proceseve universitare.</i></p> <p><i>Gjithashtu, GVJ vëren se ky sistem përfshin dhe mbështet edhe programin e studimit në Bachelor në "Koreografi", duke garantuar përfshirjen e tij në rrjetin institucional të menaxhimit dhe monitorimit. Kjo kontribuon në standardizimin dhe mbikëqyrjen e vazhdueshme të zhvillimit të këtij programi në përputhje me kërkesat për cilësi dhe transparencë institucionale.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5

Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.</p>	<p>Në dokumentet e paraqitura nga institucioni, GVJ konstaton se Universiteti i Arteve ka ndërmarrë hapa pozitivë në drejtim të planifikimit dhe raportimit financiar, përfshirë hartimin e buxhetit afatmesëm dhe paraqitjen e kërkesave të detajuara nga njësitë bazë akademike. Në veçanti, relacionet e Fakultetit të Artit Skenik pasqyrojnë analizë të qartë të nevojave financiare për zhvillimin e programeve të studimit. Janë të pasqyruara qartë të dhënat mbi të ardhurat dhe shpenzimet, të ndara sipas zërave si paga, sigurime, investime, mirëmbajtje, shërbime dhe grante. Gjithashtu, është hartuar dhe miratuar projekt-buxheti afatmesëm për vitet 2024–2026, duke dëshmuar një angazhim të qartë për planifikim financiar të qëndrueshëm në përputhje me objektivat institucionale.</p> <p>Megjithatë, GVJ sygjeron se nevoitet një raport i konsoliduar financiar i strukturuar sipas programeve të studimit, që të përfshijë kostot dhe mbështetjen e nevojshme për të paktën një cikël të plotë akademik. Të dhënat janë të fragmentuara dhe përgjithësisht të raportuara në nivel fakulteti ose institucional.</p> <p>Referanca <i>Evidenca 4.24 – Paraqitja e buxhetit nga administratori, Fakulteti i Artit Skenik</i> <i>Evidenca 4.25 – VSA nr. 24, datë 18.07.2019 – Miratimi i Projekt-Buxhetit Afatmesëm 2020–2022, UART</i> <i>Evidenca 4.26 – VSA nr. 32, datë 20.07.2022 – Miratimi i Buxhetit Afatmesëm 2023–2025</i> <i>Evidenca 4.27 – VSA nr. 33, datë 20.07.2023 – Projekt-Buxheti Afatmesëm 2024–2026</i> <i>Evidenca 4.28 – VBA nr. 28, datë 29.07.2020 – Projekt-Buxheti Afatmesëm 2021–2023</i> <i>Evidenca 4.29 – VBA nr. 19, datë 25.07.2023 – Projekt-Buxheti Afatmesëm 2024–2026</i></p>




	<p>Evidenca 4.30 – Kërkesat e Fakultetit të Artit Skenik për staf sipas kategorive për vitin pasardhës Evidenca 4.31 – Pasqyrimi financiar vjetor për vitet 2021–2024</p>
<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>Në varësi të dokumentacionit të dorëzuar nga Universiteti i Arteve (UART), vërehet se institucioni ka ndërmarrë hapa pozitivë në drejtim të planifikimit financiar të njësive bazë përgjegjëse për programet e studimit. Dokumente si relacionet e Fakultetit të Artit Skenik dhe kërkesat për burime njerëzore (Evidencat 4.24, 4.27, 4.30) pasqyrojnë qartë nevojat për staf, mirëmbajtje të ambienteve, pajisje didaktike dhe elementë të tjerë mbështetës për procesin mësimor. Gjithashtu, përmenden edhe kërkesa për literaturë dhe përmirësim të aksesit në burime bibliotekare, si dhe aktivitete që lidhen me realizimin praktik të programeve.</p> <p>Megjithatë, në dokumentacionin ekzistues nuk gjenden informacione të detajuara mbi grantet vendase apo të huaja, detyrimet financiare të njësive, apo kontratat e lidhura për shërbime të posaçme në funksion të programeve. Këto elementë mbeten të pasqyruara pjesërisht ose nuk janë të dokumentuara në mënyrë të drejtpërdrejtë.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, vërehet se kriteri është trajtuar në mënyrë të kënaqshme, veçanërisht në pjesën që lidhet me strukturën bazë të mbështetjes financiare për programet e studimit. Ndërkohë, disa elementë më të veçantë mund të përfitonin nga një paraqitje më e qartë dhe e plotësuar, për të reflektuar sa më mirë kërkesat e plota të standardit. Në këtë drejtim, sugjerohet që UART të vijojë përmirësimin e dokumentacionit financiar, duke përfshirë të gjithë zërat e përmendur në kriter, në mënyrë të integruar dhe të lehtë për t'u ndjekur.</p> <p>Referanca Evidenca 4.27 – VSA nr. 33, datë 20.07.2023 – Projekt-Buxheti Afatmesëm 2024–2026 Evidenca 4.24 – "Paraqitja e buxhetit nga administratori i FAS" Evidenca 4.30 – "Kërkesat e FAS për staf akademik sipas kategorive për vitin pasardhës"</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>UART nuk i është nënshtruar ndonjë auditimi financiar.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësive bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>Drejtorja e financave dhe bordi i administrimit janë njësitë të cilat miratojnë dhe shpërndajnë grantet në UA.</p> <p>Për të diversifikuar burimet e të ardhurave, sygjerohet më tej të ardhurat dytësore në mënyrë që të ulët riskun e "goditjeve" nga rëniet e përkohshme të numrit të studentëve, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes në projektet e financuara nga donatorë si EU, IIK, SIDA etj.</p>





	<p>Referenca: -RVB Evidenca 4.33 Dokumente nga drejtoria ekonomike mbi raportimin per realizimin e buxhetit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në funksion të Kriterit 5, që kërkon nga institucioni garantimin e qëndrueshmërisë financiare për zhvillimin dhe funksionimin normal të programeve të studimit të njësisë bazë, dokumentacioni i vendosur në dispozicion nga Universiteti i Arteve (UART) ofron disa elementë që dëshmojnë përpjekjet institucionale në këtë drejtim, por gjithashtu lë vend për përmirësim në disa drejtime.</p> <p>Në radhë të parë, dokumentet si buxhetet afatmesme të miratuara për periudhat 2020–2022, 2021–2023, 2023–2025 dhe 2024–2026 (Evidencat 4.25, 4.26, 4.27, 4.28 dhe 4.29), tregojnë një planifikim financiar të vazhdueshëm dhe në kohë, i cili është miratuar nga organet përkatëse (Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit). Kjo përbën një tregues pozitiv për angazhimin institucional në ruajtjen e qëndrueshmërisë financiare në afat të mesëm.</p> <p>Gjithashtu, paraqitja e buxhetit nga administratori i FAS (Evidenca 4.24), si dhe kërkesat për burime njerëzore sipas kategorive (Evidenca 4.30), dëshmojnë se në nivel njësie ka reflektim mbi nevojat konkrete për funksionimin e programeve dhe se ekziston ndërveprim midis njësisë dhe strukturave qendrore në hartimin e buxhetit.</p> <p>Megjithatë, në dokumentacionin e dorëzuar nuk janë të qarta mekanizmat që lidhen me ndërhyrje të posaçme në rast të vështirësive financiare, apo diversifikimi i burimeve të financimit, si për shembull grante të jashtme, bashkëpunime me aktorë të tjerë, ose projekte që mund të sjellin të ardhura të reja. Po ashtu, mungojnë analizat e riskut financiar për programet e studimit që mund të jenë më të cenueshme në aspektin e qëndrueshmërisë, siç është rasti i programit të Koreografisë, që kërkon mbështetje të veçantë për komponentët praktikë dhe infrastrukturorë.</p> <p>Në këtë kuptim, garancia për qëndrueshmëri financiare është e adresuar nëpërmjet dokumenteve bazë buxhetore dhe planifikimit të rregullt, por do të ishte e dobishme që UART të zhvillojë më tej praktikat që lidhen me vlerësimin e rrezikut, planifikimin e ndërhyrjeve në raste të veçanta dhe eksplorimin e burimeve alternative financimi. Kjo do të ndihmonte në forcimin e sigurisë financiare për të gjitha programet e studimit dhe do të mundësonte një reagim më të shpejtë dhe të strukturuar ndaj sfidave të mundshme.</p> <p>Referanca Evidenca 4.24 – Paraqitja e buxhetit nga administratori, Fakulteti i Artit Skenik Evidenca 4.25 – VSA nr. 24, datë 18.07.2019 – Miratimi i Projekt-Buxhetit Afatmesëm 2020–2022, UART Evidenca 4.26 – VSA nr. 32, datë 20.07.2022 – Miratimi i Buxhetit Afatmesëm 2023–2025</p>




	<p><i>Evidenca 4.27 – VSA nr. 33, datë 20.07.2023 – Projekt-Buxheti Afatmesëm 2024–2026</i></p> <p><i>Evidenca 4.28 – VBA nr. 28, datë 29.07.2020 – Projekt-Buxheti Afatmesëm 2021–2023</i></p> <p><i>Evidenca 4.29 – VBA nr. 19, datë 25.07.2023 – Projekt-Buxheti Afatmesëm 2024–2026</i></p> <p><i>Evidenca 4.30 – Kërkesat e Fakultetit të Artit Skenik për staf sipas kategorive për vitin pasardhës</i></p> <p><i>Evidenca 4.31 – Pasqyrimi financiar vjetor për vitet 2021–2024</i></p>			
Konkluzione	<p><i>Bazuar në dokumentacionin e dorëzuar, Universiteti i Arteve ka ndërmarrë hapa pozitivë për të garantuar qëndrueshmëri financiare në nivel institucional dhe të njëjësive bazë. Hartimi dhe miratimi i buxheteve afatmesme për periudha të njëpasnjëshme (2020–2026), si dhe përfshirja e kërkesave specifike nga Fakulteti i Artit Skenik, tregojnë një angazhim të vazhdueshëm në drejtim të planifikimit dhe mbështetjes së programeve të studimit.</i></p> <p><i>Megjithatë, sugjerohet të hartohen te dhëna të detajuara mbi ndërhyrjet në rast vështirësish financiare dhe mbi burime alternative si grante apo projekte të financuara. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për programe si Koreografia, që kërkojnë mbështetje praktike të vazhdueshme.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X
Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	Universiteti i Arteve ka ndërtuar një qasje të qartë dhe të organizuar për menaxhimin e ciklit të plotë akademik të studentëve të programit Bachelor në Koreografi. GVJ vlerëson se ky proces është i mbështetur në mënyrë të kujdesshme mbi ligjin për arsimin e lartë dhe aktet përkatëse nënligjore, duke garantuar që çdo hap – nga pranimi deri në diplomim – të jetë i bazuar në rregulla të përcaktuara mirë. Studentët orientohet përmes statutit, rregulloreve të programit, departamentit dhe sekretarisë mësimore, të cilat janë të miratuara nga Senati Akademik dhe të publikuara në faqen zyrtare të universitetit. Kjo transparencë krijon një ndjenjë sigurie dhe orientimi për studentët në ecurinë e tyre akademike.




	<p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Evidenca 1.4: "VKM Nr. 145, datë 10.03.2021, Për dhënien e Statusit të veçantë UART" Evidenca 1.5: "Statuti i UART" Evidenca 5.1: "Rregullorja e UART" Evidenca 1.15: "Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit" Evidenca 1.17: "Rregullorja e Departamentit S&K" Evidenca 1.18: "Rregullorja e Programit të Studimit BSc në Koreografi"</p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ u njoh me dokumentacionin dhe procedurat që lidhen me pranimin, vijueshmërinë dhe përfundimin e studimeve në Universitetin e Arteve, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator të arsimit të lartë në Shqipëri. Në përmbajtjen e paraqitur, evidentohet se UART dhe konkretisht Fakulteti i Artit Skenik, përmes strukturave përkatëse, zbaton një politikë të qartë dhe gjithëpërfshirëse që garanton barazi dhe transparencë për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit në Koreografi.</p> <p>Politikat dhe rregulloret që mbështesin funksionimin e këtij programi janë të publikuara dhe të aksesueshme lehtësisht përmes faqes zyrtare dhe komunikimit institucional, duke përfshirë kriteret e pranimin, procedurat e transferimit, si dhe të gjithë kuadrin që ndihmon studentët të kuptojnë rrugëtimin e tyre akademik. Në rastin e programit të Koreografisë, GVJ vlerësoi se përzgjedhja e kandidatëve nuk mbështetet vetëm në mesataren akademike, por përfshin gjithashtu vlerësimin e aftësive artistike përmes konkurseve dhe prezantimeve të veçanta, duke përputhur kështu natyrën e studimeve me nevojën për vlerësim cilësor dhe profesional.</p> <p>Kjo qasje jo vetëm që përputhet me Kriterin 2 të standardeve të cilësisë, por tregon dhe një përkushtim të qëndrueshëm për të ruajtur integritetin artistik dhe akademik të programit.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Web në faqen zyrtare të UART Evidenc 5.2; 5.3; 5.4 - Kriteret e konkurrimit të FAS për vitet akademike 2021–2024 Web Departamenti S&K - <u>http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=59&niveli=54</u></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e</p>	<p>Gjatë takimeve në Fakultetin e Artit Skenik (FAS), u konstatua se kandidatët për programet e ciklit të parë i nënshtrohen konkurseve të pranimin, të organizuara sipas rregullores dhe kriterëve të miratuara nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve (UART). Departamenti i Koreografisë përcakton kuotat, tarifat, kriteret dhe rregulloret e</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>pranimin në përputhje me standardet shtetërore të cilësisë. Propozimet e departamentit shqyrtohen nga Dekani i FAS dhe miratohen nga Senati Akademik.</p> <p>Konkursi zhvillohet çdo vit akademik dhe përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Hartimin e një skice platforme koreografike mbi një temë të caktuar; • Bashkëbisedim mbi formimin kulturor në fushën e koreografisë dhe historisë së saj; • Interpretime koreografike ose realizime të shkurtra artistike sipas udhëzimeve të komisionit. <p>Studentët mund të pranohen nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia e Veriut, Mali i Zi, Presheva, Bujanovci, Medvegja dhe vende të tjera, me certifikim të gjuhës shqipe. Kuotat, kriteret dhe tarifat bëhen publike në faqen zyrtare të fakultetit dhe në ambientet e njoftimeve. Dekanati ngre grup pune për organizimin dhe funksionimin e procesit, sipas Urdhrit të Rektorit për masat në konkurse.</p> <p>Të gjitha këto procedura respektojnë rregulloret dhe udhëzimet ligjore në fuqi për ciklin e parë të studimeve në UART.</p> <p>Referanca RVB Evidenca 1.18: Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi Evidenca 5.2;5.3;5.4: FAS – Kriteret dhe Rregulloret e Konkurseve Bachelor 2021–2025</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>Gjatë takimit, GVJ u njoh me procedurën e njohjes së krediteve dhe transferimit të studentëve në programin e Koreografisë, e cila zhvillohet në përputhje me kuotat e miratuara dhe rregulloret institucionale. Kjo procedurë përfshin vlerësimin e krediteve të fituara më parë nga studentët, në programe të të njëjtit cikël dhe fusha të përafërta, brenda ose jashtë UART. Vlerësimi kryhet nga një komision i ngritur për këtë qëllim nga Departamenti përkatës dhe vendimi final miratohet nga Dekani i FAS, me qëllim vazhdimin dhe integrimin e suksesshëm të studentit në programin e studimit.</p> <p>Referanca RVB Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit; nenet 24-25</p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Gjatë takimeve, GVJ u informua se kuotat e pranimit, kriteret dhe rregulloret e konkurseve të pranimit të konkurrentëve, së bashku me përqindjen e pikëzimit të konkurseve, pasi miratohen nga Senati Akademik i UART, bëhen publike në faqen e internetit të fakultetit dhe në ambientet e përcaktuara pranë FAS. Për të mbështetur informimin e publikut dhe kandidatëve të mundshëm, institucioni organizon para fillimit të çdo viti akademik takime të hapura të stafit akademik me kandidatët e interesuar për të ndjekur programet bachelor, ku shpjegohen kriteret, procedurat, tarifat dhe mundësitë e regjistrimit, si dhe mundësitë e mobilitetit. Në zbatim të Urdhrit të Rektorit për masat e konkurseve të pranimit, Dekani i FAS ngrit një grup pune me detyra</p>




	<p>dhe afate të përcaktuara, duke siguruar organizimin dhe funksionimin e stafit administrativ dhe akademik. Ky urdhër publikohet në rubrikën e njoftimeve në ambientet e FAS dhe në të gjitha faqet elektronike</p> <p>Referanca Evidenca 1.15: "Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit" Evidenca 5.2: "FAS Kriteret dhe Rregulloret e konkurseve" Evidenca 5.5: "Urdhër Dekani FAS për ngritjen e komisioneve të pranimeve"</p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>GVJ u njoh gjatë takimeve dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion me mënyrën sesi Universiteti i Arteve e adreson këtë çështje. UART ndjek parimin e barazisë dhe përfshirjes sociale, duke parashikuar kuota të veçanta pranimi për studentë nga komunitetet Rom dhe Ballkano-Egjiptian, në përputhje me aktet ligjore në fuqi, siç përcaktohet në VKM nr. 251, datë 27.03.2020. Këto kuota përfshihen në dokumentet orientuese të pranimeve dhe bëhen të aksesueshme për publikun përmes kanaleve zyrtare.</p> <p>Sa i përket programit të studimit në Koreografi GVJ u informua se aktualisht nuk janë parashikuar kuota të veçanta për persona me aftësi të kufizuara, për shkak të natyrës praktike dhe kërkesave fizike që ky program përfshin. Kjo është një zgjedhje që lidhet me specifikat e formimit artistik dhe performativ, ku angazhimi trupor dhe ndërveprimi skenik luajnë një rol të rëndësishëm. Universiteti thekson se kjo nuk vjen nga një qëndrim përjashtues, por nga nevoja për të ruajtur standardet e sigurisë dhe cilësisë brenda natyrës së veçantë të programit.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Evidenca 2.4 – VKM nr. 251, datë 27.03.2020 Evidenca 5.8;5.9;5.10 – Kapacitetet pritëse Bachelor Koreografi 2022-2025</p>
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Gjatë vizitës dhe sipas RVB, u konstatua se Universiteti i Arteve respekton parimin e meritës dhe barazisë, pa vendosur kritere të veçanta për kandidatët e huaj. Ata mund të konkurrojnë nëse kanë diplomë të njësuar sipas ligjit. Studimet mund të ndiqen edhe nga shtetas të huaj sipas marrëveshjeve ndërkombëtare, me kusht që të zotërojnë gjuhën shqipe, e vërtetuar përmes certifikatave përkatëse.</p> <p>Referanca RVB Evidenca 1.15 "Rregullorja e ciklit të I-rë të studimit"</p>
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për</p>	<p>GVJ u njoh me procedurat dhe kriteret që Universiteti i Arteve ndjek për dhënien e bursave studentore, si pjesë e politikave të tij mbështetëse ndaj studentëve në nevojë dhe atyre me rezultate të larta akademike. Këto procedura janë të dokumentuara dhe zbatohen në përputhje me aktet ligjore dhe vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave. GVJ</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-13423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al





<p>institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>vlerëson se institucioni ka ndërtuar një sistem të qartë dhe gjithëpërfshirës për përzgjedhjen e përfituesve, duke ruajtur barazinë e aksesit dhe duke promovuar përfshirjen sociale.</p> <p>Referanca RVB Evidenca 5.11: VKM nr. 780, datë 26/12/2018 – Kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit Evidenca 2.4: VKM nr. 251, datë 27/03/2020 – Për përjashtimin nga pagesa të studentëve Romë/Ballkano–Egjiptianë Evidenca 5.12: VBA nr. 4, datë 16/02/2023 – Reduktimi i tarifave të shkollimit</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Universiteti i Arteve, përmes dokumentacionit dhe procedurave të miratuara, ka ndërtuar një qasje të rregullt dhe transparente për menaxhimin e ciklit akademik të studentëve të programit në Koreografi. GVJ vlerëson se çdo hap, nga pranimi deri në diplomim, mbështetet në rregullore të qarta dhe të aksesueshme publikisht, duke garantuar barazi dhe profesionalizëm. Përzgjedhja e studentëve në këtë program bazohet në konkurse artistike, në përputhje me kërkesat e fushës. Ndërkohë, ndonëse nuk parashikohen kuota për persona me aftësi të kufizuara për shkak të natyrës praktike të programit, UART tregon angazhim për përfshirje sociale përmes bursave dhe mbështetjes për studentët në nevojë. Kjo qasje përputhet me kërkesat e Kriterit 2 dhe 6 për akses, barazi dhe cilësi në arsimin e lartë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>GVJ u njoh me mënyrën se si Universiteti i Arteve informon studentët lidhur me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik nga një vit në tjetrin. Në rregulloren e programit të studimit janë të përcaktuara qartë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të drejtat dhe detyrat e studentëve; • zhvillimi dhe hyrja në provime; • kriteret e vlerësimit dhe dokumentimi i notave; • komunikimi i rezultateve; • transferimi apo rifillimi i studimeve. <p>Gjatë vizitës u konstatua se informacioni për orientimin akademik është i aksesueshëm përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> • sekretarive mësimore; • faqes zyrtare të universitetit; • sistemit PITAGORA, ku studentët ndjekin progresin personal, notat dhe kreditë e fituara.




	<p>Ky sistem i qartë dhe shumëkanalësh komunikimi garanton transparencë dhe mbështetje të vazhdueshme për studentët gjatë gjithë ciklit të studimeve.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Evidenca 1.16 "Rregullorja e Njesisë Kryesore FAS" Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi"</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>GVJ u informua se për programin e studimit në Koreografi pranë UART lejohet transferimi i studentëve nga institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, në përputhje me procedurat e përcaktuara. Për t'u transferuar, studenti duhet të ketë përfunduar të paktën 48 kredite në programin përkatës. Njohja e krediteve bëhet nga një komision i ngritur nga Dekani, i cili shqyrton përputhshmërinë e lëndëve me programin e Koreografisë. Në rast njohjeje të pjesshme, studentit mund t'i kërkohet të plotësojë diferencat përmes provimeve apo detyrave të tjera. Këto informacione janë të dokumentuara dhe të aksesueshme edhe përmes Zyrës së Mbështetjes së Studentëve dhe Këshillimit të Karrierës.</p> <p>Referanca Shënime gjatë vizitës Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi"</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë, në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore të FAS, informon studentët për kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve. GVJ u njoh me këtë proces dhe vlerësoi se informacioni përcillet qartë nga pedagogët që në fillim të semestrit, përmes programeve lëndore dhe komunikimit individual duke evidentuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Vlerësimi i studentëve i cili ndahet në komponentë me peshë të caktuar. • Pedagogët orientojnë studentët mbi provimet dhe detyrimet vjetore. • Mësimdhënia organizohet në mënyrë individuale ose në grupe të vogla për lëndët artistike. • Informacioni jepet përmes komunikimit të drejtpërdrejtë dhe dokumentacionit përkatës. <p>Kjo qasje ndihmon studentët të kuptojnë qartë mënyrën e vlerësimit dhe të përgatiten sipas kërkesave të fushës së tyre.</p> <p>Referanca Shënime gjatë vizitës Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi"</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë takimit me GVJ, u paraqitën në mënyrë të qartë procedurat që lidhen me diplomimin në programin Bachelor në Koreografi. GVJ u informua se në përfundim të programit të studimit, diplomimi realizohet përmes një provimi diplome, i cili përfshin paraqitjen e një teze teorike dhe një mbrojtje artistike të diplomës. Studentët lejohen të mbrojnë temën e diplomës vetëm pasi të kenë përmbushur të gjitha</p>




	<p>detyrimet akademike dhe të kenë fituar numrin e kërkuar të krediteve sipas planit mësimor. Po ashtu, kërkohet që përpara mbrojtjes, studentët të kenë shlyer çdo detyrim financiar ndaj institucionit.</p> <p>Gjithashtu, Fakulteti i Artit Skenik, brenda dy muajsh nga fillimi i vitit shkollor, i informon studentët e vitit të fundit për temat e diplomës dhe kërkesat përkatëse sipas specifikës së programit të Koreografisë. Procesi i përgatitjes, organizimit dhe mbrojtjes së diplomës, si dhe vlerësimi i punimit dhe lëshimi i diplomës, zhvillohen në përputhje me rregulloren e ciklit të parë të studimeve në UART, duke respektuar natyrën unike të formimit artistik të këtij programi.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Evidenca 1.18 "Rregullorja e Programit të Studimit Koreografi"</p>			
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</p>	<p>Gjatë dy ditëve të takimeve me GVJ, u theksua se Universiteti i Arteve ka ndërtuar një praktikë të qëndrueshme dhe të hapur për të informuar të rinjtë mbi programet e studimit, nëpërmjet aktiviteteve si "Open Day". Këto evente u vlerësuan si shumë efektive për të prezantuar infrastrukturën, stafin akademik, procesin mësimor dhe atmosferën krijuese të institucionit. Përdorimi i materialeve informuese dhe rrjeteve sociale si Instagram, Facebook, LinkedIn dhe faqja zyrtare e UART ka lehtësuar qasjen ndaj informacionit dhe ka përmirësuar ndjeshëm komunikimin me të interesuarit.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Evidenca 5.13 "Open Day UART Dhjetor 2024" Faqja zyrtare e UART</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Nga sa u evidentua gjatë vizitës, Universiteti i Arteve tregon një përkushtim serioz dhe të qëndrueshëm për të orientuar dhe mbështetur studentët, veçanërisht në programin e Koreografisë. Informacioni i strukturuar mirë, qasja shumëkanalëshe dhe transparenca në komunikim janë elementë pozitivë që ndikojnë drejtpërdrejt në përvojën studentore. Vlerësohet sidomos fakti që proceset si transferimi, vlerësimi dhe diplomimi janë të qarta, të dokumentuara dhe të përshtatura me specifikën artistike të programit. UART reflekton një filozofi të hapur dhe përfshirëse, që e vendos studentin në qendër të vëmendjes, duke krijuar një mjedis të favorshëm për zhvillim akademik dhe profesional.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				X

Standardi V.3





Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.</p>	<p>Universiteti i Arteve ka treguar një përkushtim të qartë për t'i informuar studentët në mënyrë të plotë dhe të kuptueshme që nga hapat e parë të kontaktit me institucionin. Studentët marrin informacion të detajuar mbi strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programeve të studimit në disa momente kyçe, si gjatë takimeve informuese në shkollat e mesme, ditëve të hapura me maurantët, javës së parë të akomodimit, apo përmes pedagogëve koordinatorë gjatë studimeve.</p> <p>Gjatë takimeve dhe materialeve të vëna në dispozicion, GVJ u njoh drejtpërdrejt me mënyrën sesi universiteti e realizon këtë proces informimi. U vlerësua se përmes fletëpalosjeve, posterve, broshurave dhe spoteve promovuese, institucioni ndihmon studentët të kuptojnë më mirë programet që ofron dhe si janë të organizuara ato. Për më tepër, informacioni i plotë dhe i përditësuar është i aksesueshëm edhe në faqen zyrtare të universitetit, ku janë publikuar format PDF të planeve mësimore, të dhëna mbi semestrat, lëndët, orët e mësimimit dhe format e vlerësimit.</p> <p>Ky angazhim tregon se universiteti e trajton me serioz informimin dhe orientimin e studentëve, duke krijuar një ambient të qasshëm dhe të hapur. Një përmirësim i vogël mund të ishte shtimi i materialeve interaktive, si video guida ose platforma vizuale, që do ta bënin përvojën e informimit edhe më të lehtë dhe më afër pritshmërive të studentëve të rinj.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës www.uart.edu.al http://www.uart.edu.al/programet-e-studimit</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<p>Universiteti i Arteve informon studentët e programit në Koreografi në përputhje me Kriterin V.3 – Kriteri 2, duke u ofruar atyre syllabus për çdo lëndë në fillim të semestrit, ku përfshihen temat mësimore, literatura ndihmëse dhe format e vlerësimit. Ky informacion përcillet në mënyrë të rregullt nga pedagogët dhe është gjithashtu i aksesueshëm në faqen zyrtare të universitetit. Studentët janë të informuar mbi strukturën, organizimin dhe përmbajtjen e programit gjatë gjithë ciklit të studimeve, duke pasur një pasqyrë të qartë mbi rrjedhën akademike dhe pritshmëritë për secilën lëndë. Në këtë mënyrë, procesi i informimit është i plotë dhe i përshtatur me kërkesat e profilit studimor.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e</p>	<p>Sipas takimeve të kryera nga GVJ dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion gjatë vizitës, si edhe në përgjigje të pyetjeve të ngritura</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>punësimi, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>gjatë takimeve me stafin akademik dhe administrativ, u konstatua se Universiteti i Arteve ka mekanizma funksionale për të informuar dhe orientuar studentët mbi mundësitë e përfshirjes në tregun e punës. Studentët, veçanërisht ata të Fakultetit të Artit Skenik dhe të Departamentit të Skenografisë dhe Koreografisë, janë të angazhuar në aktivitete të ndryshme kulturore e artistike që zhvillohen në bashkëpunim me institucione publike dhe private, duke përfutur përvojë konkrete profesionale gjatë kohës që janë ende në studime. Këto angazhime janë bërë të mundura edhe falë marrëveshjeve që UART ka lidhur me institucione të artit dhe kulturës, në kuadër të nismës “Pakti për Universitetin”.</p> <p>Informacioni mbi këto mundësi përcillet në mënyrë të qartë përmes portaleve zyrtare të universitetit, faqeve online dhe njoftimeve të afishuara pranë sekretarive mësimore, duke u bërë lehtësisht i aksesueshëm për studentët. Megjithatë, për të pasur një pasqyrë të saktë dhe të qëndrueshme mbi angazhimin real të studentëve pas diplomimit dhe nivelin e përputhshmërisë së tyre me kërkesat e tregut të punës, një rol kyç i takon Zyrës së Alumni-t. Kjo zyrë duhet të mbledhë dhe analizojë rregullisht feedback nga të diplomuarit dhe punëdhënësit, për të ndihmuar institucionin të kuptojë më mirë se sa efektivisht po përgatiten studentët për realitetin profesional dhe për të përmirësuar vazhdimisht programet dhe mbështetjen që u ofrohet atyre.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion Evidenca 1.21 "Marrëveshjet me partnerët UART"</p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.</p>	<p>Të gjithë studentët e programit të studimit e Bsc "Koreografi" kanë akses në sistemin interaktiv të universitetit "Pitagora", ku gjejnë të gjitha informacionet për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor si dhe logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Po ashtu, në dispozicion të tyre janë edhe zyrat përkatëse në institucion të cilat i ofrojnë këto shërbime sa herë u kërkohen nga të interesuarit.</p> <p>Referenca: -RVB -Shënime nga vizita në Institucion</p>
<p>Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.</p>	<p>Plani mësimor, lëndët, kreditet dhe syllabus-et janë të aksesueshme në sistemin PITAGORA dhe faqen zyrtare të UART, duke i ndihmuar studentët të organizojnë angazhimet akademike.</p> <p>Faqja zyrtare e Universitetit të Arteve: Sistemi PITAGORA – https://uart.pitagora.rash.al/login</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ vlerëson se Universiteti i Arteve ka një sistem funksional informimi dhe orientimi për studentët, që nis nga faza e regjistrimit dhe vazhdon gjatë gjithë studimeve. Informacioni ofrohet në mënyrë të qartë përmes pedagogëve, materialeve promovuese dhe platformave si faqja zyrtare dhe sistemi PITAGORA. Studentët e programit në Koreografi janë të angazhuar edhe praktikisht përmes bashkëpunimeve</i></p>




	<i>me institucione kulturore, duke fituar përvojë profesionale gjatë studimeve. Këto përfshirje mbështeten nga marrëveshje institucionale dhe nisma si "Pakti për Universitetin", duke forcuar lidhjen me tregun e punës.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	Gjatë vizitës në universitet, GVJ konstatoi se sekretaria mësimore mbledh dhe ruan të dhëna të detajuara lidhur me studentët dhe performancën e tyre akademike. Sipas të dhënave të paraqitura në Tabelën 23 (viti akademik 2023-2024), rezultojnë se 9 studentë kanë përfunduar studimet, ndërsa vetëm 1 prej tyre është i punësuar në fushën përkatëse, në përputhje me programin e studimit.
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	Gjithashtu, sipas evidencës 5.14 "Statistika FAS për numrin e studentëve dhe të diplomuarve 2022-2025", programi i Koreografisë ka treguar një vazhdimësi pozitive në diplomimin e studentëve. Në vitin akademik 2022-2023 janë diplomuar 7 studentë, ndërsa në vitin 2023-2024 ky numër është rritur në 10, duke reflektuar efikasitetin në përfundimin e studimeve. Për vitin akademik 2024-2025, nuk është evidentuar asnjë student i diplomuar në programin e Koreografisë, pasi vizita është kryer para përfundimit të procesit të diplomimit. Në tërësi, Koreografia mbetet një ndër programet më të qëndrueshme në Fakultetin e Arteve Skenike sa i përket numrit të studentëve të diplomuar. Në këtë program nuk rezultojnë transferime apo dhe largime, referuar tabelës (Tabela 21) në RVB. Këto të dhëna i referohen shtojcave të RVB si dhe ruhen në sekretarinë mësimore sipas formateve standarde të MAS dhe QSHA. <i>Referanca</i> <i>RVB</i> <i>Shënime gjatë vizitës</i> <i>Evidenca 5.14 "Statistika FAS për numrin e studentëve dhe të diplomuarve 2022 — 2025"</i> <i>Faqja web e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe SLIP-A</i>
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të	Sekretaria mësimore ruan të dhënat për të gjithë studentët. Kjo përfshin statusin, notat, frekuentimin, dhe informacionet e tjera të rëndësishme

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (0) 222-13123

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>për avancimin e studentit. Pjesa e këtyre të dhënave është e dukshme për studentët përmes sistemit PITAGORA, të mundësuar nga RASH, ndërsa të tjera janë të aksesueshme nga stafi i specializuar që mund të krijojë statistika ose analiza të të dhënave.</p> <p>GVJ konstatoi gjatë vizitës se sekretaria mësimore gjithashtu ruan të dhënat zyrtare në letër, sipas formateve standarde të kërkuara. Përveç përfaqësimit në organet vendimmarrëse, studentët kontribuojnë në vlerësimin e procesit akademik përmes sondazheve të Sektorit Mësimor, të cilat ndihmojnë në përmirësimin e programeve dhe mësimdhënies.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Evidenca 3.13 "Screenshot-e nga sistemi Pitagora"</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Gjatë vizitës, GVJ u njoh me funksionimin e Sektorit Mësimor, i cili, sipas rregullores së miratuar nga Senati Akademik i Universitetit të Arteve, është përgjegjës për kryerjen e kontroleve periodike mbi të dhënat akademike nëpërmjet sekretarive mësimore dhe sistemit të informacionit. Ky sektor monitoron dhe verifikon përputhshmërinë e regjistrave të notave me të dhënat në sistem, duke garantuar saktësinë dhe besueshmërinë e tyre. Në përfundim të çdo viti akademik, Sektori Mësimor kryen kontrole duke krahasuar regjistrat e notave me sistemin elektronik dhe, deri më tani, nuk është evidentuar asnjë problem serioz në hedhjen apo ndryshimin e tyre. Gjatë takimit, GVJ pati mundësi të kryejë vetë verifikime të rastësishme dhe konstatoi se çdo evidentim ishte në përputhje me procedurat përkatëse.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Evidenca 5.15 "Rregullorja e Sektorit Mësimor UART"</p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Gjatë takimit me përfaqësuesit e njësisë bazë dhe Departamentit S&K, GVJ u njoh me procesin e hartimit të raportit vjetor analitik, i cili përfshin të dhëna mbi cilësinë e studentëve, rezultatet akademike dhe realizimin e objektivave të programeve të studimit. Ky raport shërben si bazë për analizën vjetore institucionale.</p> <p>GVJ verifikoi se raporti mbulon analiza të strukturuar mbi mësimdhënien, përqindjen e të diplomuarve, pjesëmarrjen në projekte dhe vlerësimin e cilësisë së studentëve. U konstatua gjithashtu se ekziston bashkëpunim i rregullt me Zyrën e Alumni për të ndjekur rrugëtimin profesional të të diplomuarve dhe për të mbledhur të dhëna mbi integrimin e tyre në tregun e punës.</p> <p>UART tregoi një qasje të qëndrueshme pozitive dhe përmirësuese, duke theksuar përkushtimin për të forcuar mekanizmat e mbledhjes së të dhënave dhe bashkëpunimin me Alumni dhe studentët, si pjesë e</p>




	përpjekjeve për zhvillim të vazhdueshëm institucional dhe ngritje të cilësisë.			
	Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Evidenca 1.25 "Raportet e vlerësimit të performancës vjetore"			
Konkluzione	<i>Gjatë vizitës në Universitetin e Arteve, GVJ konstatoi se sekretaria mësimore mbledh dhe ruan të dhëna të detajuara mbi studentët dhe performancën e tyre akademike, të aksesueshme nëpërmjet sistemit PITAGORA dhe formateve standarde. U vërejt se një pjesë e studentëve të diplomuar janë të punësuar në fushën përkatëse, çka tregon nevojën për përmirësim në ndjekjen e punësimit pas diplomimit. Programi i Koreografisë ka treguar qëndrueshmëri në diplomime, ndërsa nuk janë raportuar largime apo transferime. GVJ u njoh edhe me funksionimin e Sektorit Mësimor, i cili kryen verifikime të rregullta të saktësisë së të dhënave akademike, dhe me raportet vjetore të performancës, që ndihmojnë në analizën institucionale. UART demonstroi një qasje pozitive për përmirësim, sidomos në forcimin e bashkëpunimit me Zyrën e Alumni dhe studentët për të ndjekur integrimin e tyre profesional.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5

Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	<p>GVJ u njoh me angazhimin aktiv të studentëve të programit të studimit në Koreografi në jetën institucionale të Universitetit të Arteve. Studentët marrin pjesë dhe janë të përfaqësuar në strukturat vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, komisionet për Sigurimin e Cilësisë dhe Marrëdhëniet me Studentët, si dhe në Këshillin Studentor. Përmes këtyre mekanizmave, ata inkurajohen të marrin pjesë me ide dhe propozime mbi aspekte të ndryshme të jetës akademike dhe institucionale.</p> <p>GJitashtu pergjate takimeve u theksua se UART mbështet Këshillin Studentor dhe inkurajon përfshirjen aktive të studentëve në veprimtari artistike, duke i trajtuar ata si bashkëpunëtorë të barabartë në projekte krijuese me pedagogët. Në programin e Koreografisë, GVJ vlerësoi pjesëmarrjen e studentëve në proceset artistike dhe organizative, si dhe kontributin e tyre në zhvillimin e projekteve performative në bashkëpunim të ngushtë me stafin akademik.</p> <p>Referanca RVB</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
 Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

	<p><i>Shënime gjatë vizitës</i> <i>Evidenca 1.1: Ligji Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" – Kreu III</i> <i>Evidenca 1.5: Statuti i Universitetit të Arteve – Kreu III</i> <i>Evidenca 1.16: Rregullorja e Njesisë Kryesore FAS (Fakulteti i Artit Skenik)</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët u vu re se ata janë të vetëdijshëm për rolin e tyre përfaqësues në jetën institucionale dhe janë të informuar për mënyrat se si mund të japin mendimet apo të shprehin shqetësimet e tyre. Studentët shprehen se, në përgjithësi, opinionet dhe problemet e tyre merren në konsideratë, edhe pse ndonjëherë procesi nuk ecën aq shpejt apo me ndikimin që ata presin. Megjithatë, ekziston një ndjenjë pozitive për përfshirjen dhe dëgjimin e tyre nga ana e stafit akademik dhe drejtuesve.</p> <p>Fakti që Universiteti i Arteve është një institucion relativisht i vogël, krijon një klimë të afërt dhe të komunikueshme. Kjo përmasë ndihmon që marrëdhëniet mes studentëve, pedagogëve dhe strukturave drejtuese të jenë më të ngushta dhe të natyrshme. Studentët ndihen pjesë e një komuniteti të hapur, ku secili ka mundësi reale për t'u dëgjuar dhe për të ndikuar në jetën e përditshme akademike dhe artistike. Komunikimi brenda universitetit konsiderohet nga studentët si i lehtë dhe i aksesueshëm, gjë që e bën përvojën e tyre më të plotë dhe më bashkëpunuese.</p> <p><i>Referanca</i> <i>RVB</i> <i>Shënime gjatë vizitës</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.</p>	<p>UART është në komunikim të vazhdueshëm me studentët përmes aktiviteteve mësimore. Sektori mësimor gjithashtu realizon sondazhe mbi programin e studimit me studentët dhe personelin akademik.</p> <p>Duhet theksuar se, duke qenë një universitet i vogël, është e lehtë që secili të dëgjohej. Universiteti rezultoi të jetë një komunitet gjithëpërfshirës dhe në të njëjtën kohë, komunikimi ndërmjet të gjithë aktorëve është relativisht i lehtë dhe efikas.</p> <p><i>Referanca</i> <i>RVB</i> <i>Shënime gjatë vizitës</i> <i>Evidenca 5.16: Sondazhet e kryera nga Sektori Mësimor</i> <i>Evidenca 3.7: Të dhënat nga pyetësorët e studentëve në Fakultetin e Artit Skenik (FAS), përpunuar nga Sektori Mësimor</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit</p>	<p>Referuar rregullores së programit të studimit, Neni 19, përcaktohen mënyrat e vlerësimit të studentit dhe mundësitë e ankimimit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/njesisë/pedagogut përgjegjës.</p>	<p>Komunikimi i rezultateve bëhet në një seancë të posaçme ku studenti ka mundësi të njihet me vlerësimin dhe të shprehë mendimin e tij. Brenda 24 orëve nga marrja e rezultatit, studenti ka mundësi të ankohet për rezultatin. Në këto raste, Dekani verifikon rastin dhe jep edhe vlerësimin përfundimtar.</p> <p>Gjatë vizitës së GVJ me grupin e studentëve, nuk u identifikua asnjë rast konkret ankimimi.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Evidenca 1.16: Rregullorja e Njesisë Kryesore FAS (Fakulteti i Artit Skenik) Evidenca 1.15: Rregullorja e Programit të Studimit</p>								
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ u njoh me angazhimin aktiv të studentëve të programit të Koreografisë në jetën akademike, artistike dhe institucionale të Universitetit të Arteve. Studentët janë të përfaqësuar në strukturat vendimmarrëse si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, komisionet për Sigurimin e Cilësisë dhe Këshillin Studentor, ku kontribuojnë me mendime dhe propozime për çështje që lidhen me jetën në universitet. Ata shprehën ndërgjegjësim për rolin e tyre dhe vlerësuan faktin që zëri i studentëve dëgjohet, edhe pse ndikimi nuk është gjithmonë i menjëhershëm. UART, si një institucion i vogël, ofron një ambient gjithëpërfshirës me komunikim të drejtpërdrejtë dhe efikas midis studentëve, stafit dhe drejtuesve. Studentët marrin pjesë si bashkëpunëtorë të barabartë në projekte krijuese me pedagogët, ndërsa Sektori Mësimor mbështet këtë përfshirje edhe përmes sondazheve dhe pyetësorëve që synojnë përmirësimin e përvojës studentore. Po ashtu, rregullorja e programit parashikon mekanizma të qartë për transparencën e vlerësimeve dhe të drejtën për ankim, megjithëse gjatë vizitës nuk u raportua asnjë rast konkret ankimimi.</p>								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th data-bbox="627 1424 798 1480">Nuk përmbushet</th> <th data-bbox="805 1424 1018 1480">Përmbushet pjesërisht</th> <th data-bbox="1026 1424 1238 1480">Përmbushet kryesisht</th> <th data-bbox="1246 1424 1479 1480">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td data-bbox="627 1491 798 1525"></td> <td data-bbox="805 1491 1018 1525"></td> <td data-bbox="1026 1491 1238 1525"></td> <td data-bbox="1246 1491 1479 1525">X</td> </tr> </tbody> </table>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet</p>	<p>GVJ, përgjatë takimeve dhe në bazë të dokumentacionit të shqyrtuar, konstatoi se Universiteti i Arteve ka ngritur struktura funksionale për informimin dhe mbështetjen e studentëve, si Sekretaria Mësimore dhe Sektori Mësimor. Këto njësi ndjekin dhe dokumentojnë ecurinë akademike të studentëve gjatë gjithë ciklit të studimeve, duke ofruar asistencë për çështje akademike e administrative. Informimi realizohet</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
 Pranë gjim. «Q. Stafan», Tiranë
 Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




<p>ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.</p>	<p>në mënyrë të rregullt përmes faqes zyrtare të institucionit, postës elektronike, njoftimeve në stenda dhe kontakteve të drejtpërdrejta me pedagogët.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Evidencës 5.15 Rregullorja e Sektorit Mësimor UART</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Studentët janë në kontakt të vazhdueshëm me strukturën e universitetit dhe rezultojnë të jenë të informuar mirë dhe të kënaqur me nivelin e komunikimit dhe ndihmës. Ata marrin informacionin kryesor përmes internetit (web dhe social media) dhe sistemit PITAGORA, i cili u mundëson atyre të aksesojnë të dhëna dhe informacionet e rëndësishme për avancimin e tyre individual në program. Nga ana tjetër, Sekretaria Mësimore, Sektori Mësimor dhe Departamenti duket se janë efikasë dhe të dobishëm në procesin e informimit dhe këshillimit.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Evidenca 5.15 Rregullorja e Sektorit Mësimor UART Evidenca 4.19 Manuali Pitagora</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Sektori Mësimor, ku përfshihen struktura e Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, është përgjegjës për informimin dhe asistencën e studentëve për aktivitetet e përditshme brenda universitetit. Në rregulloren e tij thuhet:</p> <p>Zyra mësimore, informimit të studentëve, karrierës dhe alumni. zbaton detyrat si më poshtë:</p> <p>Mban marrëdhënie të vazhdueshme me këshillat studentorë, drejton procesin e këshillimit të studentëve, mban komunikim me tregun e punës, si dhe ofron asistencë në orientimin dhe zhvillimin e karrierave profesionale të studentëve në fushën e arit dhe të kulturës.</p> <p>Përditëson bazën e të dhënave të institucioneve me të cilat UART ka marrëveshje bashkëpunimi, të cilat kanë në funksion Karrierën dhe punësimin e ardhshëm të të studentëve të UART.</p> <p>Në rastin e programit të studimit, një pjesë e studentëve fillojnë të lidhen me tregun e punës para diplomimit. Tregu i punës është ende i etur për profesionistë të rinj, kështu që në këtë rast, puna e zyrës së karrierës është disi më e lehtë.</p> <p>Referanca RVB Evidencës 5.15 Rregullorja e Sektorit Mësimor UART. Evidencës 1.15 Rregullorja e Ciklit të I-rë të Studimit</p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe</p>	<p>Gjatë takimeve, GVJ u informua se Universiteti i Arteve ka ngritur një strukturë të posaçme për Këshillimin e Karrierës dhe Alumni-n, e cila është përgjegjëse për mbajtjen e kontakteve të rregullta dhe të qëndrueshme me ish-studentët e diplomuar. Kjo strukturë luan një rol të rëndësishëm në ndjekjen e rrugëtimit profesional dhe akademik të të diplomuarve, duke synuar të krijojë ura komunikimi midis tyre dhe institucionit.</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	<p>Megjithëse janë ndërmarrë hapa pozitivë në këtë drejtim, u theksua nevoja që struktura të zhvillojë më tej një bazë të dhënash funksionale dhe të përditësuar, e cila të shërbejë për të gjurmuar në mënyrë sistematike punësimin e studentëve në tregun e punës, si dhe për të mbledhur informacion mbi sektorët ku ata angazhohen (publik, privat, vetëpunësim), vazhdimin e studimeve apo sfidat me të cilat përballen. Një bazë e tillë të dhënash do të ndihmonte jo vetëm në pasqyrimin real të ecurisë së ish-studentëve pas diplomimit, por edhe në përmirësimin e programeve të studimit, përmes përshtatjes së tyre me kërkesat e tregut të punës. Gjithashtu, kjo do të përbënte një instrument të rëndësishëm për vendimmarrjen strategjike të institucionit dhe për përmbushjen e standardeve të cilësisë në arsimin e lartë.</p> <p>Referanca RVB Evidencës 5.15 Rregullorja e Sektorit Mësimor UART Evidencës 6.6 Komunikimi me Alumni</p>
--	--

Konkluzione	<p><i>GVJ konstatoi se Universiteti i Arteve ofron një ambient edukativ të organizuar dhe funksional, ku studentët marrin mbështetje të vazhdueshme përmes Sektorit Mësimor dhe Sekretarisë Mësimore, në bashkëpunim me departamentet përkatëse. Këto struktura u ofrojnë studentëve ndihmë të shpejtë dhe efektive për çështje akademike dhe administrative, duke mundësuar një ndërveprim të rregullt dhe të frytshëm.</i></p> <p><i>Studentët deklaruan se komunikimi me stafin është i lehtë dhe problemet zgjidhen në kohë, çka kontribuon në një proces studimi pa pengesa. Kjo mbështetje përbën një faktor të rëndësishëm për cilësinë e programeve. GVJ sugjeron që Struktura e Këshillimit të Karrierës dhe Alumni-t të përforcohet, duke ndërtuar një bazë të dhënash për ndjekjen e punësimit të të diplomuarve në tregun e punës.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

Standardi VI.1

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe	Përgjatë takimit në Universitetin e Arteve, Grupi i Vlerësimit të Jashtëm (GVJ) u njoh jo vetëm me proceset administrative dhe organizative të institucionit, por edhe me vizionin strategjik që e udhëheq atë në ofrimin dhe zhvillimin e programeve të studimit.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al


Web site: www.ascal.al




<p>inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Vëmendje e veçantë iu kushtua programit të studimit Bachelor në Koreografi, i cili përfaqëson një qasje të veçantë akademike, duke reflektuar dinamizmin dhe karakterin multidimensional të kësaj disipline artistike. Universiteti i Arteve ka ndërtuar këtë program mbi baza bashkëkohore pedagogjike, duke i përshtatur objektivat mësimore me kërkesat aktuale të tregut të punës në fushën e artit skenik dhe me nevojat e individualizuara të studentëve. Programi ndërthur në mënyrë të balancuar metodologjitë tradicionale të mësonjësit me qasje moderne e eksperimentale, duke synuar të zhvillojë jo vetëm kompetencat teknike të studentëve, por edhe ndjeshmërinë e tyre artistike, mendimin kritik, kreativitetin dhe shprehjen individuale në procesin koreografik. Programi synon të përgatisë studentët për një treg pune në zhvillim të vazhdueshëm, duke i pajisur ata me metodologjite dhe njohuritë e nevojshme për të krijuar vepra origjinale në fushën e artit skenik, si dhe për të kontribuar në pasurimin e jetës kulturore kombëtare dhe ndërkombëtare. Kjo qasje përforcon rolin e universitetit si një qendër akademike dhe krijuese e rëndësishme për zhvillimin e talenteve të reja në fushën e arteve.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës</p> <p>Evidencës 2.1 – Plani Mësimor i Programit Bachelor në Koreografi Evidencës 2.2 – Kurrikula/Syllabuset e Programit Bachelor në Koreografi</p>
<p>Kriteri 2. Strukturat zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>GVJ u informua në lidhje me mekanizmat e përdorur për monitorimin dhe vlerësimin periodik të ecurisë së programeve të studimit dhe aftësive mësimdhënëse, përmes sondazheve dhe pyetësorëve të zhvilluara me studentët dhe pedagogët nga Sektori Mësimor dhe departamentet përkatëse. Gjatë takimeve, u theksua rëndësia e mbështetjes për kualifikimin e personelit akademik dhe organizimin e aktiviteteve të përbashkëta ndërmjet departamenteve. Për më tepër, GVJ u njoh me analizat vjetore të punës, që përfshijnë rekomandime për përmirësimin e proceseve mësimore dhe aftësive mësimdhënëse.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Evidenca 1.5: VSA nr. 15, datë 30/08/2021 – Statuti i UART Evidenca 1.25: VSA nr. 2, datë 10.01.2025 – Raporti Vjetor 2023–2024</p>
<p>Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.</p>	<p>Në Universitetin e Arteve, studentët janë në qendër të procesit mësimor dhe përfshihen në çdo fazë të zhvillimit të programeve – nga struktura e lëndëve, mënyra e vlerësimit, deri te paraqitjet përfundimtare. Procesi mësimor ndërtohet mbi një komunikim të hapur dhe të vazhdueshëm ndërmjet studentëve dhe stafit akademik, duke siguruar një mjedis të bashkëpunueshëm dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të tyre.</p> <p>Gjatë vizitës dhe takimeve në institucion, GVJ-së i është vënë në dispozicion çdo material i nevojshëm lidhur me programin dhe proceset</p>




	<p>akademike. Në takimet me studentët dhe stafin akademik, u vërejt një përfshirje e thellë dhe njohje e mirë e procedurave, si dhe e aktivitetit mësimor në tërësi, gjë që dëshmon për angazhimin dhe seriozitetin në zbatim të politikave të cilësisë.</p> <p>Studentët japin vlerësim periodik për cilësinë e mësimdhënies, përmbajtjen e kurrikulës dhe aspektet e tjera akademike përmes pyetësorëve strukturuar. Rezultatet e këtyre vlerësimeve përpunohen në raporte përmbledhëse, të cilat ndihmojnë në identifikimin e aspekteve që kërkojnë ndërhyrje ose përmirësim.</p> <p>Një element kyç i këtij programi është garantimi i një vlerësimi të drejtë dhe transparent të arritjeve akademike. Studentët kanë të drejtën të kërkojnë rishikimin e vlerësimeve të tyre, fillimisht pranë Departamentit të Skenografisë dhe Koreografisë, dhe nëse e shohin të nevojshme, më pas edhe pranë Dekanatit apo Rektoratit. Ky mekanizëm i apelimit nxit një kulturë përgjegjshmërie dhe objektiviteti në vlerësim.</p> <p>Përtej procesit të vlerësimit, studentët luajnë një rol aktiv edhe në zhvillimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programeve akademike. Ata inkurajohen të japin opinione dhe sugjerime për përmbajtjen e lëndëve, duke ndihmuar në përshtatjen e tyre me tendencat më të fundit në fushën e koreografisë dhe arteve skenike. Në këtë mënyrë, programi është në zhvillim të vazhdueshëm dhe reflekton dinamizmin e disiplinës artistike që përfaqëson.</p> <p>Megjithatë, gjatë takimeve, GVJ nuk konstatoi raste konkrete ankimimesh formale, çka mund të jetë rezultat i përmasave të vogla të programit dhe marrëdhënieve të ngushta ndërmjet studentëve dhe stafit, të cilat lehtësojnë zgjidhjen e çështjeve në mënyrë të drejtpërdrejtë, pa kaluar në rrugë zyrtare.</p> <p>Referanca RVB Shënime gjatë vizitës Evidenca 1.15: VSA nr. 16, datë 07/10/2021 – Rregullore Mësimore e Ciklit të I të Studimeve Bachelor, Neni 20, Pika 1. Evidenca 1.5: VSA nr. 15, datë 30/08/2021 – Statuti i UART, Neni 123, Pika 2. Evidenca 6.2: VSA nr. 26, datë 24/05/2023 – Rregullore për Zgjedhjet e Këshillit Studentor, Neni 21.</p>
<p>Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se monitorimi i cilësisë në Universitetin e Arteve realizohet përmes pyetësorëve të studentëve, ndërsa rezultatet e mbledhura publikohen dhe shpërndahen në disa forma. Ato prezantohen në takime informuese me studentë, staf akademik dhe administrativ, ku diskutohen gjetjet dhe propozohen përmirësime të mundshme. Departamenti kryen analiza vjetore mbi rezultatet e monitorimit, duke identifikuar pikat e forta dhe dobësitë, që ndihmojnë në hartimin e strategjive për zhvillim dhe përmirësim. Rezultatet e</p>




	<p>vlerësimin apo raportet analitike përkatëse nuk rezultojnë të aksesueshme dhe publike. Rekomandohet bërija publike e rezultateve duke shfaqur analiza të përgjithshme e duke shmangur informacione apo të dhëna që lidhen me individë.</p> <p>Evidenca 1.25: Raportet Vjetore – Transparenca Evidenca 3.7 dhe 6.1: Rezultatet e pyetësorit për studentët dhe stafin akademik Evidenca: Foto nga mbledhja mbi raportin vjetor për vitin akademik 2023–2024</p>			
<p>Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimin dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.</p>	<p>Sondazhet dhe raportet përkatëse analizohen dhe diskutohen nga autoritetet drejtuese dhe personeli akademik duke evidentuar problematikat apo edhe praktikave të mira. Ky proces ndikon në nxitjen e personelit akademik dhe strukturave në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Ky angazhim u vu re edhe gjatë takimit të GVJ-së me personelin akademik.</p> <p>Referenca: Shënime gjatë takimeve</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p>Gjatë vizitës në Universitetin e Arteve dhe shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, GVJ vërejt një përpjekje të strukturuar, të qëndrueshme dhe në zhvillim të vazhdueshëm për garantimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Strukturat përgjegjëse të institucionit treguan një angazhim serioz për zbatimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë, duke përfshirë edhe përdorimin e instrumenteve të vlerësimin nga studentët dhe stafi akademik.</p> <p>Studentët u evidentuan si aktorë aktivë në këtë proces, jo vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes në pyetësorë vlerësues, por edhe në komunikim të drejtpërdrejtë me stafin akademik për çështje që lidhen me përmirësimin e përmbajtjes së lëndëve dhe metodologjisë mësimore. Kjo përfshirje është një element pozitiv që kontribuon në ndërtimin e një mjedisi akademik gjithëpërfshirës dhe reflektues.</p> <p>Megjithatë, GVJ sugjeron që rezultatet e vlerësimeve të studentëve dhe stafit akademik të bëhen të aksesueshme publikisht në formë të përmbledhura dhe anonime, në mënyrë që të rritet transparenca dhe të nxisë një klimë besimi dhe përmirësimi të vazhdueshëm. Publikimi i rezultateve jo vetëm që i informon të gjitha palët e interesuara për gjendjen aktuale të cilësisë në mësimdhënie, por gjithashtu mund të shërbejë si nxitje për reflektim të brendshëm dhe veprime përkatëse nga strukturat drejtuese të institucionit.</p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p>X</p>

Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Gjatë takimeve të kryera, GVJ konstatoi se struktura organizative e Universitetit të Arteve është në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 dhe mbështetet në Statutin dhe aktet rregullatore të institucionit. Për sigurimin e brendshëm të cilësisë, funksionon NJSBC në bashkëpunim me Sektorin Mësimor dhe njësitë akademike. Detyrat përfshijnë rishikimin e akteve, zbatimin e standardeve sipas Kodit të Cilësisë, vlerësimin periodik të veprimtarive dhe mbajtjen e databazës së ish-studentëve. GVJ vlerëson se ky organizim mbështet një qasje të strukturuar dhe funksionale për sigurimin e cilësisë në UART.</p> <p>Nga njohja e GVJ me institucionin tri rezultojnë strukturat kryesore në UART që lidhen me sigurimin e brendshëm të cilësisë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Departamenti - Sektori Mësimor - Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë <p>Sipas rregullores së funksionimit të NJSBC, struktura përgjegjëse është Zyra Mësimore dhe Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Karrierës dhe Alumnit. Kjo zyrë kryen vlerësimin dhe raportimin periodik në përputhje me standardet e cilësisë. Kjo zyrë raporton tek Zv. Rektori për anën mësimore.</p> <p><i>Evidenca 6.4, VSA nr. 24, datë 07/10/2021 – Rregullorja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, Neni 2 dhe Neni 4.</i> <i>Evidenca 5.15, VSA nr. 21, datë 07/10/2021 – Rregullore e Sektorit Mësimor & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Neni 5.</i> <i>Evidenca 1.17, VSA nr. 34, datë 20/07/2022 – Rregullore e Departamentit Skenografi-Koreografi, Neni 3.</i> <i>Evidenca 1.16, VSA nr. 35, datë 07/12/2021 – Rregullore e Veprimtarisë së Përgjithshme dhe asaj Mësimore të Fakultetit të Artit Skenik.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me njësitë përkatëse u njoh me rolin e Njesisë Bazë, që është përgjegjëse për përmirësimin e cilësisë në Universitetin e Arteve, e mbështetur nga Sektori Mësimor dhe Sekretaria Mësimore. Pas përfundimit të procesit mësimor, stafi akademik shqyrton problematikat dhe propozon ndryshime për përmirësimin e programeve. Universiteti siguron që studentët të kenë akses në pedagogë të ftuar nga institucione kulturore dhe artistike. Njësia Bazë kryen analiza të detajuara të procesit mësimor, mbështetur nga sygjyerimet e stafit dhe anketimet e studentëve, dhe përcjell rezultatet në Departament dhe Dekanat për shqyrtim. Universiteti ka zhvilluar një strategji për sigurimin e cilësisë përmes përgatitjes dhe standardizimit të dokumentacionit, rregulloreve, politikave dhe procedurave, duke siguruar përmbushjen e kërkesave ligjore dhe akademike.</p> <p>Referenca: RVB Shënime gjatë vizitës <i>Evidenca 1.5, VSA nr. 15, datë 30/08/2021 – Statuti i UART, Kreu X.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në</p>	<p>Universiteti është subjekt i akreditimeve periodike institucionale dhe programeve, një praktikë e vendosur prej disa vitesh. Raportet e vlerësimit të brendshëm hartohen si pjesë e procedurës standarde, pasuar nga raportet e vlerësimit të jashtëm. Rezultatet e akreditimeve</p>

<p>arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>tregojnë se universiteti ka një performancë të qëndrueshme në lidhje me cilësinë e programeve, që dëshmon masa dhe mjete efikase për Sigurimin e Cilësisë.</p> <p>Referenca: RVB Shënime gjatë vizitës</p>			
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira në programin e studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në Universitetin e Arteve, GVJ u njoh me mekanizmat që institucioni përdor për garantimin e cilësisë së programeve të studimit. Një tregues i rëndësishëm ishte vijimi i studimeve të ciklit të dytë nga të diplomuarit Bachelor, që reflekton efektivitetin e kurrikulave dhe vlerësimin pozitiv të studentëve.</p> <p>Procesi i kontrollit të programeve zhvillohet në mënyrë të rregullt dhe të strukturuar. Në rastet kur evidentohen mangësi, ndërmerren masa konkrete për përmirësim. Kjo qasje mbështet përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në mësimdhënie dhe kërkim artistic performativ.</p> <p>Referenca: RVB Shënime gjatë vizitës</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Politikat dhe procedurat që lidhen me Sigurimin e Cilësisë janë tashmë të pranishme në strukturën institucionale të universitetit dhe po kalojnë një fazë të rëndësishme konsolidimi. Këto politika janë konceptuar për të garantuar një bazë të qëndrueshme mbi të cilën mund të zhvillohet dhe përmirësohet cilësia akademike, në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të arsimit të lartë. Ato janë integruar gradualisht në praktikën e përditshme të stafit akademik dhe administrativ, duke ndikuar drejtpërdrejt në mënyrën se si programi menaxhohet, zbatohet dhe vlerësohet. Përmes zbatimit të këtyre procedurave, është bërë i mundur identifikimi i pikave të forta dhe aspekteve që kërkojnë përmirësim, duke e kthyer këtë proces në një mekanizëm aktiv për reflektim dhe zhvillim të vazhdueshëm. Këto instrumente jo vetëm që ndihmojnë në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe të përmbajtjes kurrikulare, por gjithashtu rrisin ndërgjegjësimin institucional për rëndësinë e vlerësimit të brendshëm dhe planifikimit strategjik. Megjithatë, me zhvillimin e mëtejshëm të programit dhe rritjen e kompleksitetit të kërkesave akademike dhe profesionale, do të jetë e nevojshme që këto politika të plotësohen me qasje të veçanta dhe të përshtatura sipas natyrës unike të programit. Kjo përfshin hartimin e mekanizmave specifike të sigurimit të cilësisë që adresojnë karakteristikat e fushës, objektivat afatgjata dhe potencialin krijues e profesional të studentëve. Këto qasje të personalizuar do të ndihmojnë jo vetëm në përmirësimin e vazhdueshëm të programit, por edhe në ruajtjen e identitetit të tij akademik dhe rritjen e ndikimit të tij në tregun e punës dhe në komunitetin artistik më gjerë.</i></p>			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p>Sigurimi i cilësisë së programit është përgjegjësi e Departamentit të Skenografi dhe Kostumografi. Departamenti monitoron aktivitetin e përditshëm, kryen analiza periodike dhe iniciativat për ndryshime dhe përmirësime në strukturën dhe përmbajtjen e programit. Analiza e punës vjetore të departamentit dokumentohet përmes raporteve të departamentit. Departamenti dhe Sektori Mësimor zhvillojnë gjithashtu një analizë të sondazheve periodike mbi mësimdhënien.</p> <p><i>Evidenca 1.5, VSA nr. 15, datë 30/08/2021 – Statuti i UART, Kreu X: Mbi Sigurimin e Cilësisë.</i> <i>Evidencat 3.7 dhe 6.1 – Rezultatet e pyetësorëve për studentët dhe stafin akademik.</i> <i>Evidenca 1.25, VSA nr. 2, datë 10/01/2025 – Raporti Vjetor 2023–2024.</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Gjatë vizitës së kryer në institucion dhe shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion, GVJ konstatoi se Universiteti i Arteve ka një sistem të qartë dhe të strukturuar për vlerësimin dhe monitorimin e cilësisë akademike, duke e parë këtë si bazë për zhvillimin institucional. Raportet analizojnë rezultatet dhe identifikojnë pika të forta dhe fusha për përmirësim. Rezultatet përcaktohen nga objektivat strategjike dhe standardet kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Procesi përfshin metoda të brendshme dhe të jashtme, përfshirë pyetësorë dhe raportime nga departamentet për performancën akademike dhe aktivitetet artistike. Universiteti nxit angazhimin në projekte artistike dhe promovon kulturën e cilësisë dhe inovacionit.</p> <p>Për të adresuar mangësitë, miratohen masa konkrete për përmirësim, si përditësimi i programeve, zhvillimi profesional i stafit dhe investime në infrastrukturë. Këto masa zbatohen nëpërmjet një koordinimi institucional. Universiteti synon të ruajë dhe forcojë cilësinë akademike dhe artistike në mënyrë të qëndrueshme.</p> <p><i>Referanca</i> <i>Shënime nga vizita në Institucion</i> <i>Evidenca 1.25 – Raportet Vjetore</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit</p>	<p>Gjatë takimit të kryer në UART, GVJ u njoh me qasjen e strukturuar dhe shumëanshme të Universitetit të Arteve për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënies, kurrikulës dhe performancës së studentëve. Proceset zhvillohen në nivel institucioni, fakulteti dhe departamenti, duke</p>




<p>përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>siguruar monitorim dhe përmirësim të qëndrueshëm. Universiteti përdor metoda të ndryshme, si vlerësimin e studentëve, vëzhgimin gjatë praktikave dhe analizimin e punimeve të diplomës. Sektori Mësimor menaxhon pyetësorët për monitorimin e cilësisë, ndërsa pedagogët e jashtëm kontribuojnë me përvojën e tyre, duke lidhur akademinë me tregun e punës. Kjo siguron një vlerësim të vazhdueshëm dhe gjithëpërfshirës të cilësisë akademike dhe përgatitjen e studentëve për sfidat profesionale.</p> <p>Referanca Shënime nga vizita në Institucion Evidenca 1.25, VSA Nr. 2, datë 10/01/2025 – Raporti Vjetor 2023-2024 web Evidencë 6.5 – Foto nga proceset e mësimdhënies në auditor dhe foto nga provimet apo diploma të studentëve.</p>
<p>Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program.</p>	<p>Gjatë takimit, GVJ u njoh si nga raporti ashtu edhe nga bisedat me stafin drejtues me informacionet e vëna në dispozicion. Universiteti i Arteve, si i vetmi institucion publik i arsimit të lartë në fushën e artit dhe kulturës në Shqipëri, synon përgatitjen akademike dhe profesionale të artistëve të rinj dhe zhvillimin e skenës kulturore vendase. Për sigurimin e cilësisë së programeve dhe përshtatjen me kërkesat e tregut të punës, përdor metoda të ndryshme vlerësimi. Studentët vlerësojnë kurrikulën, mësimdhënien, kushtet infrastrukturore dhe metodat didaktike, duke identifikuar problematikat e mundshme. Pedagogët e brendshëm dhe të jashtëm kontribuojnë në përmirësimin e procesit mësimor dhe sjellin përvojë nga industria kulturore për të përshtatur programet me zhvillimet më të fundit. Memorandumet e bashkëpunimit me institucione artistike dhe organizata ofrojnë studentëve mundësi për praktika profesionale dhe përvojë reale në sektorin kulturor. Kjo qasje integruese garanton që Universiteti i Arteve të jetë një qendër akademike dhe krijuese e rëndësishme, në përputhje me standardet më të larta të arsimit të lartë artistik.</p> <p>Tabela Nr. 16 nga seria tabelave 1-24 të programit të studimit Bachelor në "Koreografi" – të dhënat infrastrukturore për Fakultetin e Artit Skenik. Evidenca 3.7 – Pyetësori për studentët. Evidenca 6.1 – Pyetësori për stafin akademik. Evidenca 6.6 – Komunikimi me ish-studentë përmes email-it ose formularëve / Raporti Alumni. Evidenca 1.29 – Marrëveshje bashkëpunimi të UART me institucione homologe, brenda dhe jashtë vendit.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ vërejtë se departamenti dhe strukturat përkatëse të universitetit përgjegjëse për Sigurimin e Cilësisë zhvillojnë një punë të qëndrueshme dhe sistematike për të monitoruar dhe kontrolluar cilësinë e programeve akademike. Këto njësi janë duke përmirësuar gradualisht instrumentat dhe metodat që përdorin, duke i bërë ato më të efektshme dhe të integruara në praktikën e përditshme të menaxhimit akademik. Proceset e vlerësimit janë në fazë konsolidimi, duke garantuar që vlerësimet të jenë më objektive, të strukturuar dhe të</p>

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




	<p>përshatura me nevojat specifike të çdo programi studimi. Kjo përpjekje e vazhdueshme kontribuon në identifikimin e hershëm të sfidave dhe mundësive për përmirësim, duke siguruar një rritje të qëndrueshme të cilësisë në të gjitha nivelet akademike dhe administrative të universitetit. Në këtë mënyrë, universiteti forcon besueshmërinë dhe integritetin e tij akademik, duke ofruar një mjedis të përshatshëm për zhvillimin profesional dhe shkencor të studentëve dhe stafit.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion dhe në bashkëbisedim me zyrën përkatëse, GVJ u njoh me funksionimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë në Fakultetin e Artit Skenik të Universitetit të Arteve. U evidentua se procesi i sigurimit dhe përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë së programeve të studimit përfshin aktivisht si aktorët e brendshëm, ashtu edhe ata të jashtëm. Pedagogët e jashtëm bashkëpunojnë ngushtësisht me njësitë përkatëse akademike për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm të cilësisë, në përputhje me standardet dhe kriteret institucionale. Gjithashtu, GVJ u informua se studentët kanë rol të drejtpërdrejtë në këtë proces përmes përfaqësimit të tyre dhe pjesëmarrjes në vlerësimet periodike të cilësisë. Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë vepron në bazë të Statutit dhe rregulloreve përkatëse të universitetit, duke garantuar përfaqësimin e strukturave akademike dhe administrative në Komisionin përkatës (KSBC), përfshirë edhe një përfaqësues studentor, siç përcaktohet në nenet 135 dhe 136 të Statutit të Universitetit.</p> <p><i>Referanca</i> <i>Shënime nga vizita në Institucion</i> <i>Evidenca 1.5, VSA nr. 15, datë 30/08/2021 – Statuti i UART</i> <i>Evidenca 6.4, VSA nr. 24, datë 07/10/2021 – Rregullorja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Sipas Nenit 6 të së njëjtës rregullore (shih më sipër), Njësia për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) ka disa funksione kyçe, përfshirë: mbledhjen e të dhënave sipas treguesve cilësorë e sasiore, organizimin e vlerësimeve periodike, përditësimin e dokumentacionit dhe procedurave, përmirësimin e metodologjisë së punës, përpunimin e pyetësorëve dhe vlerësimin e stafit akademik. Gjithashtu, ajo bashkërendon procesin e vlerësimit të brendshëm, harton raportin përkatës çdo dy vite dhe merr pjesë në GVB, duke ruajtur dhe përmirësuar njohuritë përmes trajnimeve.</p> <p>GVJ vërejtë se këto funksione realizohen nga NJSBC, edhe pse jo gjithmonë të mbështetura me dokumentacion të plotë. Megjithatë,</p>




	<p>proceset janë të vendosura dhe në fazë konsolidimi. Përveç NJSBC, Departamenti dhe Sektori Mësimor mbajnë përgjegjësi të rëndësishme në menaxhimin dhe zbatimin e praktikave të sigurimit të cilësisë në nivel programi studimi.</p> <p><i>Evidenca 1.5, VSA nr. 15, datë 30/08/2021 – Statuti i UART, Neni 35.</i> <i>Evidenca 6.4, VSA nr. 24, datë 07/10/2021 – Rregullorja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i> <i>Evidenca 5.15, VSA nr. 21, datë 07/10/2021 – Rregullorja e Zyrës Mësimore & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</i> <i>Evidenca 3.7 – Pyetëtori për Studentët.</i> <i>Evidenca 6.1 – Pyetëtori për Stafin Akademik.</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit.</p>	<p>Departamenti i Skenografisë dhe Koreografisë zhvillon një proces të strukturuar dhe gjithëpërfshirës për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit. Në këtë proces përfshihen fakulteti, stafi akademik, ndihmësakademik, administrativ dhe studentët, të cilët kontribuojnë aktivisht përmes takimeve dhe platformave elektronike. Grupi i vlerësimit të brendshëm, i udhëhequr nga Dekani i Fakultetit të Artit Skenik, siguron një proces transparent dhe të organizuar, duke garantuar respektimin e standardeve akademike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</p> <p><i>Evidenca 1.9.1 – Shkresë për ngritjen e Grupit të Vlerësimit të Brendshëm.</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Gjatë vizitës në universitet dhe takimeve të ndryshme që u mbajtën, GVJ konstatoi mungesën e çdo shenje diskriminimi, pabarazie apo sjelljeje që nuk i përket etikës akademike. Një ambient gjithëpërfshirës, harmonik dhe respektues u perceptua si ndër studentët ashtu edhe ndër stafin akademik.</p>
<p>Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk kemi evidenca për angazhimin e drejtpërdrejtë të ekspertëve të jashtëm në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë. Siç përmendet më sipër, referuar rregullores së NJSBC në rastet kur ka akreditime për herë të parë apo institucionale, thirret një ekspert i jashtëm. Gjithashtu, angazhimi i pedagogëve të jashtëm, të lidhur drejtpërdrejt me tregun e punës jep një feedback të vazhdueshëm për politikën dhe qasjet e institucionit në drejtimin e SBC. Po ashtu përmes kontakteve me universitete të huaja mundësohet shkëmbimi i eksperiencave të mira dhe marrja e feedback-ut. Përfshirja e ekspertëve të jashtëm si pjesë e përhershme dhe zyrtare e strukturave të SBC do të mund të sillnin një perspektivë përtej rutinës institucionale.</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>Gjatë vëzhgimeve dhe takimeve, GVJ konstatoi një mjedis institucional ku bashkëpunimi ndërmjet aktorëve të brendshëm në procesin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë është i barabartë, i hapur dhe pa</i></p>




	<p><i>përfshirje apo diskriminim. Strukturat dhe procedurat aktuale nxisin pjesëmarrjen aktive të stafit akademik, administrativ dhe studentëve, duke krijuar një bazë solide për reflektim dhe përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë në arsimin dhe menaxhimin e programeve. Megjithatë, GVJ vë në dukje se për të forcuar këtë proces dhe për të garantuar transparencë dhe përfaqësim të plotë, duhet të rritet përfshirja aktive e aktorëve të jashtëm. Pjesëmarrja më e organizuar dhe e vazhdueshme e alumni-t, ekspertëve të jashtëm dhe përfaqësuesve të tregut të punës në Komisionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe në proceset e tjera të vlerësimit do të pasuronte perspektivat dhe do të afronte universitetin me nevojat e profesionit.</i></p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.</p>	<p>Në përgjithësi, GVJ konstatoi një nivel transparence dhe komunikimi të mirë brenda universitetit. Një pjesë e mirë e dokumentacionit, rregulloreve dhe informacionit aksesohet lehtësisht online përmes faqes web. UART përdor faqen zyrtare të web- it dhe rrjetet sociale, komunikimin me email dhe takimet informuese në kuadër të këtij qëllimi.</p> <p>http://www.uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=208&niveli=81 http://uart.edu.al/index.php?pg=faqe&id=292&niveli=85</p>
<p>Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>Gjatë takimit, GVJ u informua se Universiteti i Arteve, në përputhje me parimet e lirisë akademike, etikës dhe legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale, publikon certifikatat e akreditimit të programeve të studimit për të garantuar transparencë dhe respektim të standardeve akademike. Gjatë vizitës në institucion dhe në bashkëpunim me grupin përkatës, GVJ u njoh me mënyrën se si Universiteti i Arteve zbaton procesin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili mbështetet në dokumente rregullatore të hartuara nga Sektori Mësimor dhe Njësia për Cilësi. Ky proces garanton një vlerësim të strukturuar, objektiv dhe të orientuar drejt përmirësimit të vazhdueshëm në të gjitha nivelet akademike dhe administrative. Gjithashtu, GVJ u informua se publikimi i certifikatave të akreditimit në faqen zyrtare të institucionit siguron transparencë dhe ofron një pasqyrë të plotë mbi arritjet dhe sfidat institucionale, duke forcuar kulturën e përgjegjshmërisë, besueshmërisë dhe integritetit akademik.</p> <p><i>Evidenca 1.5, VSA nr. 15, datë 30/08/2021 – Statuti i UART, Neni 76. Evidenca 6.4, VSA nr. 24, datë 07/10/2021 – Rregullorja e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</i></p>

	<i>Evidenca 5.15, VSA nr. 21, datë 07/10/2021 – Rregullorja e Zyrës Mësimore & Kurrikulës, Informimit të Studentëve, Këshillimit të Karrierës dhe Alumni.</i>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	GVJ u njoh me procedurat dhe masat që Universiteti i Arteve, Fakulteti i Artit Skenik, ndjek për të adresuar problematikat e evidentuara nga raportet vjetore, sondazhet dhe pyetësorët. Këto instrumente shoqërohen gjithmonë me analizë të rezultateve dhe plan masash konkrete për përmirësimin e aspekteve të dobëta. Në rastin e vlerësimit të programeve për akreditim, grupi i punës për vlerësimin e brendshëm harton një seri ndërhyrjesh të orientuara drejt zgjidhjeve efektive dhe të përkohshme.
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Duhet theksuar se sistemi i Sigurimit të Cilësisë në UA është i ngritur në aspektin formal dhe është relativisht i konsoliduar. Departamenti menaxhon dhe monitoron ecurinë e programit të studimit dhe kryen punë të vazhdueshme në zhvillimin e tij. Procesi i parë i akreditimit (hartimi i RVB dhe RVJ) është në thelb hapi fillestar në vlerësimin e gjithanshëm të këtij programi, i cili deri tani rezulton të jetë integruar mjaft mirë në ofertën akademike të UA.
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë takimit, GVJ u njoh me organizimin e sektorit Mësimor dhe Kurrikulës (NJSBC), i cili zhvillon sesione për të informuar dhe sensibilizuar stafin dhe studentët për përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit. GVJ u njoh me aktivitetet të cilat përfshijnë takimet e zhvilluara për ndërgjegjësimin e personelit akademik dhe zhvillimin e anketave në lidhje dhe me programin e studimit "Koreografi", me vlerësime të mbështetura në dokumentat konkrete. <i>Evidences 6.3 Foto nga takimet informuese ose email mbi organizimin e nje takimi informues</i> <i>Evidence 3.7 Të dhëna nga pyetësoret e studentëve në FAS nga Sektori Mësimor</i> <i>Evidence 6.1 Të dhëna nga pyetësorët e stafit akademik në FAS</i>
Konkluzione	<i>Politikat dhe procedurat për Sigurimin e Cilësisë janë të pranishme dhe në proces konsolidimi, duke u integruar gradualisht në praktikën e përditshme të stafit akademik. Ato synojnë përmirësimin e vazhdueshëm të programeve të studimit dhe shërbejnë si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë. GVJ vlerëson angazhimin e vazhdueshëm të strukturave institucionale në ndërtimin e një mjedisi bashkëpunues, gjithëpërfshirës dhe të qëndrueshëm për garantimin e cilësisë në arsimin e lartë. Në këtë kuadër, GVJ nënvizon nevojën për qasje më të përshtatura dhe të personalizuara që reflektojnë natyrën unike të disa programeve të veçanta, si ai i Koreografisë, i cili përfshin komponentë të theksuar praktik, krijues dhe ndërdisiplinor. Kjo kërkon një vlerësim më të ndjeshëm ndaj specifikave artistike dhe profesionale të fushës. Në këtë drejtim, përfshirja e ekspertëve të jashtëm në strukturat e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe në proceset përkatëse do të ndihmonte në ofrimin e një perspektive të pavarur dhe gjithëpërfshirëse për</i>





	<i>vlerësimin e performancës dhe zhvillimit të programeve, veçanërisht për ato me profil të veçantë si Koreografia.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Koreografi” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë “Universiteti I Arteve.”

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Universiteti i Arteve në Tiranë (UART) gëzon një rol te vecantw në sistemin arsimor shqiptar, si i vetmi institucion në vend që ofron programe të specializuara në fushën e koreografisë. Kjo pozitë e veçantë e bën UART-in qendër kombëtare për identifikimin, zhvillimin dhe promovimin e talenteve të reja në artin e kërcimit dhe koreografisë. Përmes një kurrikule të dizajnuar në mënyrë të balancuar ndërmjet komponentëve teorikë dhe atyre praktikë, si dhe nëpërmjet stafit akademik me përvojë dhe ekspertizë të lartë artistike.
2. Programi mbështetet nga një staf akademik i kualifikuar, me përgatitje të lartë profesionale dhe përvojë të gjerë në fushën e koreografisë dhe arteve skenike. Shumë prej pedagogëve janë artistë aktivë, të njohur në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke sjellë në auditore jo vetëm njohuri teorike, por edhe përvojë konkrete nga praktika artistike bashkëkohore. Kjo përbën një aset të rëndësishëm për institucionin, pasi garanton cilësinë e mësimdhënies dhe rrit nivelin e formimit profesional të studentëve. Përfshirja e stafit në aktivitete kërkimore, projekte artistike dhe bashkëpunime ndërkombëtare kontribuon gjithashtu në pasurimin e përvojës studentore dhe në lidhjen e programit me zhvillimet aktuale në fushën e artit dhe edukimit artistik.

Pika të dobta:

1. Një nga sfidat kryesore të identifikuara në programin e Koreografisë është mungesa e infrastrukturës së specializuar dhe e përshtatshme për zhvillimin optimal të lëndëve praktike dhe profesionale. Megjithëse aktualisht janë në funksion disa hapësira, ato rezultojnë të pamjaftueshme për të përmbushur nevojat e studentëve dhe të kurrikulës, sidomos në aspektin e praktikave artistike që kërkojnë ambiente të mëdha, të përshtatura dhe me pajisje profesionale.
Kjo situatë ndikon në cilësinë e përvojës mësimore dhe kufizon potencialin për zhvillimin e plotë të aftësive praktike të studentëve, si dhe në përgatitjen e tyre efektive për tregun e punës. Nevoja për investime në infrastrukturë është e domosdoshme për të garantuar një mjedis të standardizuar arsimor dhe për të mbështetur rritjen e cilësisë akademike dhe artistike të programit. (Standardi IV 2, kriteri 3)
2. Një sfidë e rëndësishme e identifikuar në program është mungesa e mundësive të mjaftueshme për mobilitet akademik të stafit dhe studentëve. Kjo kufizon shkëmbimin e përvojave, njohurive dhe praktikave më të mira ndërkombëtare, që janë thelbësore për avancimin profesional dhe zhvillimin personal.
Pjesëmarrja e kufizuar në programe ndërkombëtare si Erasmus dhe projekte të tjera shkëmbimi, ndikon negativisht në zgjerimin e horizontit akademik dhe artistik, si dhe në forcimin e bashkëpunimeve ndër-institucionale. Kjo mungesë ndikon në nivelin e zhvillimit të kapaciteteve dhe integrimin e programit në rrjetet akademike dhe artistike globale. (Standardi III 5, kriteri 5)

Rekomandime:

1. GVJ rekomandon përmirësimin e kushteve të infrastrukturës për zhvillimin e lëndëve praktike dhe profesionale në programin e Koreografisë. Megjithëse aktualisht departamenti disponon dy hapësira funksionale, nga diskutimet me studentët është evidentuar nevoja për përmirësimin dhe zgjerimin e ambienteve të dedikuara. Infrastruktura e përshtatshme dhe e specializuar është thelbësore për garantimin e një përvojë të plotë mësimore dhe për realizimin cilësor të praktikës profesionale, duke ndikuar drejtpërdrejt në përgatitjen e studentëve për tregun e punës.



2. Rekomandohet që institucioni dhe departamenti të stimulojnë aktivisht pjesëmarrjen e studentëve në projekte shkencore në të gjitha nivelet, me qëllim rritjen e angazhimit të tyre dhe përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor dhe zhvillimit profesional. Po ashtu, rekomandohet të intensifikohen përpjekjet për promovimin dhe lehtësimin e mobilitetit akademik të studentëve, duke shfrytëzuar më mirë mundësitë që ofrojnë programet ndërkombëtare si Erasmus, për të zgjeruar përvojën ndërkombëtare dhe për të avancuar nivelin e arsimit dhe bashkëpunimit ndërinstitucional.

Evaluation's conclusions for the first cycle study program Bachelor "Choreography" provided by the Higher Education Institution "University of Arts"

Strengths and affirmations

1. UART is the only institution in Albania offering specialized programs in choreography. This makes it the national center for identifying, developing, and promoting new talents in the art of dance and choreography. Through a curriculum balanced between theory and practice, as well as an academic staff with high expertise, UART provides a suitable environment for the professional and artistic training of students.
2. The program is supported by a staff with high professional preparation and extensive experience in choreography and performing arts. The faculty members are active artists recognized nationally and internationally, bringing theoretical knowledge and practical experience to teaching. This staff ensures the quality of education and raises the professional level of students. Their involvement in research, artistic projects, and international collaborations enriches the student experience and connects the program with global developments in the field of art.

Weaknesses

1. The program faces a lack of adequate infrastructure for the optimal development of practical and professional courses. The current spaces are insufficient for the needs of students and the curriculum, especially for artistic practices that require large spaces and professional equipment. This negatively impacts on the quality of learning and the development of practical skills, limiting students' preparation for the labor market. Urgent investments in infrastructure are necessary to raise the academic and artistic quality.
2. There is a lack of sufficient opportunities for academic mobility for staff and students, limiting the international exchange of experiences and knowledge. Limited participation in programs such as Erasmus and exchange projects affects the broadening of academic and artistic horizons and the strengthening of inter-institutional collaborations. This obstacle affects capacity development and the integration of the program into global academic and artistic networks.

Recommendation


1. *The GVJ recommends improving the infrastructure conditions for the implementation of practical and professional courses in the Choreography program. Although the department currently has two functional spaces, discussions with students have highlighted the need for further improvement and expansion of dedicated facilities. Adequate and specialized infrastructure is essential to ensure a comprehensive learning experience and to enable the qualitative implementation of professional practice, directly impacting the students' preparation for the labor market.*
2. *It is recommended that the institution and the department actively promote student participation in research projects at all levels, with the aim of increasing their engagement and enhancing the quality of the teaching process and professional development. Furthermore, efforts should be intensified to promote and facilitate*

academic mobility for students, by making better use of opportunities offered by international programs such as Erasmus, in order to broaden their international experience and advance the level of education and inter-institutional cooperation.

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al



Shkalla e përbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT VLERËSIMIT	E	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
		Nuk përbushen	Përbushen pjesërisht	Përbushen kryesisht	Përbushen plotësisht
I. OFRIMI,I PROGRAMIT TË STUDIMIT	TË				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR					X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT					X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT					X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE					X
VI. SIGURIMI CILËSISË I PROGRAMIT SË STUDIMIT TË BACHELOR					X
VLERËSIMI TËRËSOR					X

